

PËRMBAJTJA

Lajme	2
Milazim Krasniqi: Viti 2008 – koha e re e Kosovës....	2-3
Sead Ujkani: Pakoja e re fiskale shqetëson qytetarët.....	4-5
Vehbi Miftari: Beteja për imazh	5
Intervistë me Adem Demaçin.....	6-8
Abdurrahim Maxhunaj: Shpresë e hidhur në një realitet të ri	8
Gëzim Qerimi: 591 studentë përfitues të bursave të UP-së	9-10
Florentina Lata: Varësia nga helmi vetëvrasës ma çorientoi jetën.....	10-11
Avni Avdiu: Maqedonia, mësuësja e Serbisë ...	12-13
Ajni Sinani: Holokausti në Gaza	14-15
Florije Ademi: Mitrovicasit kërkojnë ndihmën e pushtetin qendror	16-17
Osmon Bojaxhiu: Edhe goranët mësojnë shqip	18-19
Demir Reshiti: Reflektime ndërkombëtare për Kosovën.....	20-21
Muhamed Jusufi – Kajolli: Të pakënaqurit me zgjedhjen e Ebu Bekrit r.a.	22-24
Driton Morina: Figurë e ndritur dhe shembull në rajonin e Drenicës	25
Mexhide Demolli & Arbnora Avdiu: Harrohen familjet e invalidëve të vdekur të UÇK-së	26-27
Nazmi Maliqi: Roli i shoqërisë civile në kontrollin dhe mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë	28
Besim Muhadri: Gruaja së cilës serbët ia shuan tërë familjen	29-30
Genta Hoxha: Shkencëtari i parë i vërtetë	30-31
Ditë lind Reshiti: Galaxy – dallëndyshja e parë e sistemit paralel shëndetësor në Kosovë	32-33
Flamur Maloku: Vepra e mërzisë	34-35
Botime të reja.....	35
Poezi	36
Mesazhi i “reperëve” të Kosovës	37
Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Morthi	38-39
Fjalëkryqi	40



6 Intervistë me Adem Demaçin



10 Varësia nga helmi vetëvrasës...



14 Holokausti në Gaza



28 Roli i shoqërisë civile në...



32 Galaxy dallëndyshja e parë



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 26
19 janar - 19 shkurt 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redjtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com
Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Prishtinë

20 dhjetor 2008

Gjeneral Lejtnant Sulejman Selimi emërohet komandant i FSK-së

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka dekretuar Gjeneral Lejtnant Sulejman Selimin, Komandant të Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Bazuar në kompetencat që më janë dhënë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të Ligjit për FSK-në dhe bazuar në rekomandimin e Kryeministrit të datës 19.12.2008, shpall këtë dekret për emërimin e Gjeneral Lejtnant Sulejman Selimi Komandant të Forcës së Sigurisë së Kosovës" - thuhet në vendimin e presidentit Sejdiu. Selimi do të jetë në krye të 2.500 trupave të FSK-së. Selimi ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa prej marsit 2006 është në krye të Trupave Mbrotjtëse të Kosovës.



Preshevë

26 dhjetor 2008

Në Luginën e Preshevës arrestohen 10 ish-pjesëtarë të UÇK-së

Policia e Serbisë ka arrestuar 10 pjesëtarë të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të arrestuar janë: Agush Memishi, Nazif Hasani, Ahmet Hasani, Faton Hajdari, Samet Hajdari, Kamber Sahiti, Burim Fazliu, Sulejman Sadiku, Ferat Hajdari dhe Fatmir Sahiti.


Sipas mediave serbe, ky aksion është ndërmarrë në bazë të kallëzimit penal për krime lufte kundër popullsisë civile në Gjilan.

Arrestimet janë bërë në fshatrat Norçë, Rahovicë dhe Miratoc si dhe në rrugën e Gjilanit për rreth autostradës Preshevë-Gjilan.

Këto arrestime kanë shkakuar shqetësim të shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe mënyra e arrestimit të tyre ka ndjellë frikë dhe ka bërë që shumë nxënës të mos shkojnë në shkollë.

Prishtinë

26 dhjetor 2008

Besim Bokshi, zgjidhet kryetar i ASHAK

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ka zgjedhur Kryesinë e Akademisë, ndërsa kryetar është zgjedhur akademik Besim Bokshi. Akademik Hivzi Islami është zgjedhur nënkryetar, ndërsa akademik Engjëll Berisha, sekretar i përgjithshëm. Kryetar i deritashëm ishte akademik Rexhep Ismajli.

Në njoftimin nga ASHAK-ja, po ashtu, thuhet se Kuvendi i Akademisë verifikoi zgjedhjen e akademik Mehmet Krajës si Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, akademik Pajazit Nushit si Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Latif Susurit si Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe të akademik Tahir Emrës si Sekretar i Seksionit të Arteve.

Viti 200



Milazim KRASNIQI

Viti 2008 do të mbetet për jetë të jetëve viti më i rëndësishëm në historinë e shtetit të pavarur të Kosovës, i cili më 17 shkurt u bë realiteti i konfirmuar në hartën e planetit tonë. Nga ky vit fillon numërimi i kohës së re të Kosovës. Fatet e njerëzve, fatet e kombeve dhe të shteteve janë të fshehta, nuk mund ta parashikohen. Por, çfarëdo që të ndodhë me ne si njerëz, me ne si komb shqiptar dhe me Kosovën, do ta ketë vulën e një historie që ka arritur një shkallë vetërealizimi, me krijimin e një shteti të ri në zemër të Evropës.

Për ne që e kemi jetuar gëzimin e 17 shkurtit 2008, asgjë nuk do të jetë më njësoj, sepse me sytë tanë dhe me zemrat tona e kemi parë dhe e kemi përjetuar lumturinë. Ëmbëlsia e acarit të asaj dite ka mbetur e ngjitur përjetësisht në bebëzat tona dhe në puls të tonë. Ne e kemi jetuar ëndrrën tonë, jemi bërë njerëz të lirë. Por, do të ishte skajshmërisht egoiste, nëse do të kënaqeshim me atë që kemi arritur, duke ia faturuar vetes krejt suksesin. Abraham Linkoln, më 16 nëntor 1863, ka thënë këto fjalë që vlejnë sot për ne më shumë se për këdo tjetër: "Na takon ne të gjallëve t'i përkushtohemi punës së papërfunduar të atyre që kanë luftuar këtu, dhe që kanë përparuar kaq shumë. Na takon neve që jemi këtu t'i përkushtohemi detyrës së madhe që na pret përpara, që nga këta të vdekur të nderuar, të ecim me devotshmëri për atë kauzë për të cilën ata dhanë masën e fundit të devocionit, që ne që jemi këtu të marrim vendimin që këta të vdekur të mos kenë vdekur më kot, se ky komb, nën Perëndinë të ketë një rilindje lirie dhe se qeveria e njerëzve, nga njerëzit, për njerëzit, të mos humbasë nga faqja e dheut."

Edhe Kosova e pavarur, si ajo Amerikë e ribashkuar e Linkolnit, e ka një besë të lidhur me të gjithë ata që dhanë jetën për pavarësinë e saj dhe atë besë duhet ta mbajë deri në fund. Janë breza të tërë shqiptarësh të shkruar nga zjarret e luftërave, që kanë vënë eshtrat dhe gjakun

8 - koha e re e Kosovës

Në vitet në vijim, neve fillimisht na duhet arritja e paqes me veten dhe e harmonisë me Krijuesin. Vetëm ashtu bëhemi të fortë, për ta mundur të keqen e sedimentuar brenda vetes dhe për t'i përballuar me sukses presionet e provokacionet e armiqve.

e tyre në themelet e këtij shteti. Pa bëmat e tyre, ne thjesht nuk do të kishim as kujtesë, nuk do të dinim të vërtetën për veten tonë dhe për të drejtat tona. Kosova e pavarur është Dardania e rilindësve shqiptarë, e nxjerrë nga errësitat e harresës, përjetësisht vezulluese, si një gravurë e flakëruar me ar. Pa ato ëndrra rilindësish, zor se do të formësohej ideja e madhe kombëtare, e cila arriti ta mbajë në këmbë këtë komb edhe përballë stuhive më të forta asgjësuese. Kosova e pavarur është edhe Shqipëria e Epërme e atyre burrave si Hasan Prishtina, që shkrinë gjithë çka patën, për emrin e saj të bekuar. Kosova e pavarur është edhe "republika e shtatë", edhe "autonomia e plotë" edhe "njësia e barabartë federale-konfederale", edhe republika e pavarur dhe sovranë. Gjithë ai evolucion drejt pavarësisht të plotë nga okupatori barbar serb, i përfutur nga vuajtjet dhe nga gjaku i mijëra shqiptarëve, është pjesë e asaj besëlidhjeje sublime, që është lidhur dhe nuk duhet të thyhet kurrë. Kushdo që e thyen besën e Kosovës, rrezikon të jetë i goditur nga nëma e saj, si nga nëma e nënës.

Kjo vlen më së shumti për ata burra e për ato gra, që e kanë marrë mandatin ta drejtojnë drejt të ardhmes më të mirë këtë shtet të ri. Për aq sa mund ta arrijë të kuptojë mendja njerëzore, e ardhmja jonë do të jetë pakrahasimisht më e mirë se sa e kaluara nën okupimin e egër të fqinjit tonë verior. Por, e ardhmja kurrë nuk është e siguruar, nëse nuk punohet drejt e mirë. Një

vend që është pavarësuar vetëm para dhjetë muajsh, dhe që ka trashëguar plagë të panumërta, është i brishtë dhe i lëndueshëm. Më së shumti mund të jetë i lëndueshëm nga njerëzit plëngprishës, kur ata janë të veshur me pushtete abuzive. Nëse politikanët nuk punojnë me devocion e me ndershmeri, atëherë entuziazmit ia zë vendin letargjia, vullnetit ia zë vendin plogështia, zhvillimit ia zë vendin ngecja dhe harmonisë ia zë vendin përçarja.


Edhe pse gjatë kësaj kohe nuk kanë munguar përpjekjet për t'i dhënë të ardhmes drejtimin e duhur, janë vënë re edhe prirje shumë të frikshme në gjirin e të ashtuquajturës elitë politike dhe ekonomike. Babëzia e jo pak personave dhe grupimeve, i ka bërë ata të jenë "më të barabartë se të tjerët", si në metaforën e romanit të Orvellit, "Ferma e kafshëve". Njerëzit që para nëntë vjetësh kanë ardhur në Prishtinë pa një dyshe në xhep, ndërsa sot janë bërë pasanikë, janë kërcënim për demokracinë e vendit dhe për liritë e qytetarëve të tij. Ata po tregojnë që janë të pangopshëm dhe të paskrupullt. Gjithkujt i ka mjaftuar të shihen gjatë këtyre muajve shtëpitë luksoze të disave prej tyre në emisione televizive, për t'u shqetësuar se sa "më të barabartë se të tjerët" janë bërë ata në shtetin e ri. Korrupsioni, prostitucioni, kontrabanda, trafikimi, reketi, shantazhimi, janë fjalët-çelës, që e shpjegojnë prejardhjen e pasurive të këtyre pasanikëve të rinj, të cilët kanë ambicie që shtetin tonë të ri ta shndërrojnë në çiflig. Prandaj, qeveria duhet ta vendosë lart në agjendën e vet luftën kundër këtij kërcënimi, që rri pe-

zull mbi kokën e shtetit tonë. Por si?

Tomas Xhefersoni, në vitin 1801, e kuptonte kështu përgjegjësinë e drejtuesit të vendit të vet: "Dhe Fuqia e të Përjetshmit, i cili rregullon fatin e universit, të na këshillojë si të jetë më mirë, dhe të na drejtojë drejt paqes dhe prosperitetit." Edhe drejtuesit e shtetit tonë duhet t'i drejtohen Të Përjetshmit, nëse duan të jenë të drejtë e të fortë. Është e sigurt se një vend që nuk udhëhiqet nga drejtues që e kanë Zotin në mendje, nuk i gëzon kurrë plotësisht as frutat e lirisë e të pavarësisë. Por, nuk duhet të shmangim nga mendja se drejtuesit janë produkt i vetë popullit. Nëse ata janë mizorë, atëherë populli duhet ta shikojë veten në pasqyrë. Dhe duhet të provojë ta heqë nga vetja të keqen.

Kur qe bërë Shqipëria shtet, Faik Konica pati thënë se tash që u bë Shqipëria, duhet të bëheshin edhe shqiptarët. Në rastin tonë, meqë shqiptarët janë të bërë, formula duhet të adoptohet me realitetin që e ka lënë prapa robëria e egër, çmoralizimi i tejzgjatur nga terrori komunist dhe periudha e tranzicionit korruptiv: tash që u bë Kosova, duhet të bëhen edhe vlerat që do ta mbajnë në këmbë dhe do ta bëjnë të fortë. Në vitet në vijim, neve fillimisht na duhet arritja e paqes me veten dhe e harmonisë me Krijuesin. Vetëm ashtu bëhemi të fortë, për ta mundur të keqen e sedimentuar brenda vetes dhe për t'i përballuar me sukses presionet e provokacionet e armiqve.

Vetëm ashtu liria dhe pavarëtimin tonë
sia e fitojnë kup-
e plotë në shtetin
të ri. ■



Pas hyrjes në fuqi të reformave të reja fiskale

Pakoja e re fiskale shqetëson



Sead UJKANI

Ky ndryshim nuk është mirëpritur nga qytetarët e vendit dhe është vlerësuar si hap i ngutshëm dhe element që i kontribuon rëndimit të mëtutjeshëm të krizës ekonomike në vend, meqë TVSH-ja ndikon drejtpërdrejt në ata si konsumatorë

Në muajin dhjetor të vitit 2008, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë miratuar projektligjet përkatëse në lidhje me reformat e reja fiskale.

Në përgjithësi, ligjet e miratuara parashohin ndryshime në elementet e politikës fiskale në vend, si në poshtë:

Tatimin në të ardhurat e korporatave, i cili zvogëlohet për 10% në krahasim me udhëzimin administrative paraprak;

Tatimin mbi vlerën e shtuar, i cili rritet për 1% dhe tani aplikohet norma prej 16%;

Tatimin në të ardhurat individuale.

Hamza: Kjo pako e politikave fiskale, e bën Kosovën vendin më atraktiv në rajon.

Duke folur rreth miratimit të ligjeve të reja, Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave, Bedri Hamza ka theksuar: “vendet e rajonit kanë vepruar edhe më herët për uljen e tatimit mbi fitimin e korporatave. Me këtë ulje të normave të

tatimit të fitimit të korporatave, Kosova barazohet me vendet e rajonit. Natyrisht, një investitor i jashtëm, pyetja e parë që bën për të investuar kapitalin e tij është se cilat janë obligimet e tij fiskale”.

Ndërsa sa i përket normës së TVSH-së, përkatësisht rritjes së saj për 1 për qind,

si dhe ndryshimeve në tatimin mbi të ardhurat individuale, zëvendësministri Hamza ka thënë: “edhe pse kemi një ngritje prej një për qind, prapë është norma më e ultë në rajon. Ndërsa ngarkesat mbi të ardhurat individuale janë më të vogla në krahasim me vendet në rajon, prandaj, në përgjithësi, kjo pako e politikave fiskale, e bën Kosovën vendin më atraktiv sa i përket obligimeve fiskale në rajon”.

Marrë në përgjithësi, me gjithë benefitet e mundshme që rrjedhin nga kjo paketë e reformave fiskale për komunitetin e biznesit në përgjithësi, krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për investimet e huaja dhe përparësive të tjera, këto ndryshime, me theks të veçantë ngritja e normës së TVSH-së, është kundërshtuar fuqimisht nga opozita, ku gjatë votimit në Kuvend të kësaj pakoje të re fiskale, 30 deputetë votuan kundër. Ky ndryshim nuk është mirëpritur nga qytetarët e vendit dhe është vlerësuar si hap i ngutshëm dhe element që i kontribuon rëndimit të mëtutjeshëm të krizës ekonomike në vend, meqë TVSH-ja ndikon drejtpërdrejt në ata si konsumatorë.

Shkalla e tatimit në të ardhura personale

Sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-115 për tatimin në të ardhurat personale, për secilën periudhë tatimore, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve në vijim:

1. për të ardhurat e tatueshme nëntëqindgjashtëdhjetë (960) euro ose më pak, zero për qind (0%);
2. për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqindgjashtëdhjetë (960) euro deri në tremijë (3. 000) euro, katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqindgjashtëdhjetë (960) euro;
3. për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë (3. 000) euro deri në pesëmijekatërqind (5. 400) euro, tetëdhjetenjë pikë gjashtë (81. 6) euro plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë (3. 000) euro; dhe,
4. për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijekatërqind (5. 400) euro, dyqindeshtatëdhjetetë pikë gjashtë (273. 6) euro plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijekatërqind (5. 400) euro.



qytetarët

Lidhur më rritjen e normës së TVSH-së dhe efektet e mundshme të saj, deputeti, Driton Tali, ka theksuar se TVSH-ja e prek në mënyrë direkte konsumatorin. "E dimë se në Kosovë kemi varfëri, kemi një papunësi të madhe mbi 45 për qind, varfëria ekstreme është 18-20 për qind dhe kjo TVSH e rritur i prek në mënyrë direkte ata, por në mënyrë indirekte edhe ndërmarrjet, sepse do të ulet konsumi" - ka theksuar Tali.

Tregtarët kanë filluar ngritjen e çmimeve të produkteve

Në të vërtetë, rezervat e shprehura në lidhje me rritjen e normës së TVSH-së dhe frika e qytetarëve të vendit në lidhje më ngritjen e çmimeve ka qenë shumë reale, meqë tani kanë filluar të shihen efektet e para në këtë drejtim. Tregtarët, duke marrë si justifikim këtë ndryshim të tatimit mbi vlerën e shtuar, kanë filluar ngritjen e çmimeve të produkteve. Kjo lëvizje e çmimeve është vërejtur sidomos në produktet e mishit dhe të perimeve.

Gjithashtu, duke marrë parasysh faktin që edhe KEK-u ka paralajmëruar ngritjen e tarifave të energjisë dhe ndikimin që do të ketë ky shtrenjtim i rrymës në tregun kosovar (një arsye tjetër për rritjen e çmimeve të produkteve nga tregtarët), si dhe nëse merret parasysh edhe efekti eventual i krizës financiare globale në vendit tonë, atëherë mund të përfundojmë për negativitetin e këtyre veprimeve, të cilat si të tilla po ndikojnë direkt në xhepat e qytetarëve të vendit tonë.

Ndryshimet përkatëse tashmë kanë hyrë në fuqi. Efektet e para kanë filluar të shihen. Mbesim me shpresë që përfitimet nga këto reforma do jenë shumë më të mëdha se sa është planifikuar dhe, në këtë drejtim, këto ndryshime me gjithë aspektet negative të tyre të lartcekura të shkojnë, në përgjithësi, në dobi të prosperitetit afatgjatë të vendit dhe rritjes së standardit të jetesës në Republikën e Kosovës.

Edhe pse nuk fshihet fakti se rezervat për një gjë të tillë janë të mëdha, në prapëseprapë vlerësojmë fillimisht aspektet pozitive të tyre në përgjithësi dhe mbajmë timonin e optimizimit për një të ardhme më të mirë!

Beteja për imazh

EULEX-i duhet të bëhet i dukshëm. Ky është vullneti i qytetarit të Kosovës, imazhvlërësuesit të parë dhe të vetëm real të funksionimit të misionit të ri.

Vehbi MIFTARI

Republika sovraane e Kosovës tashmë ka miratuar kushtetutën moderne të saj, ka themeluar institucionet e pavarura dhe demokratike, ka ofruar legjislacion të harmonizuar me BE-në dhe ka ftuar një mision të saj për këshillim dhe monitorim në dy fusha: atë të drejtësisë dhe të sigurisë. Përveç kësaj, ka zgjeruar partneritetin me demokracitë evropiane dhe me atë amerikane. Këto janë njëkohësisht edhe mundësi të cilat shteti i ri i ka për të ofruar shembullin e funksionimit të demokracisë.

Por, ngjarjet e fundit në Mitrovicë dëshmuar, megjithatë, mungesën e ligjit dhe të rendit në pjesën veriore të shtetit të Kosovës. Pse ndodh kështu? Për shkak të relacioneve pothuajse të rrënuara etnike? Për shkak të ndikimit politik nga Beogradi? Apo, për shkak të tranzicionit UNMIK-EULEX? Mbase! Por, sikur dëshmuar edhe përfundimet nga takimi i krerëve të institucioneve të republikës me përfaqësuesit e sigurisë, vendosmëria, preventiva dhe koordinimi, si dhe krijimi i mekanizmave efikas për qytetarin dhe jo për përkatësinë, për lirinë e tij dhe jo për "të drejtën" e tij për të thyer rendin, janë çelësi për veriun.



Le të kujtojmë tani një aksiomë: funksionimi i demokracisë, i ndërlidhur me zinxhirin e përdorimit të mekanizmave ligjorë e kushtetues për të garantuar të drejtën e qytetarit të vendit, mund të jetë i plotë nëse vullneti për të respektuar lirinë individuale dhe kolektive vihet në peshojë me gatishmërinë për t'i mbrojtur këto të drejta në interes të të gjithë qytetarëve të vendit.

UNMIK-un e ka përcjellë, në vazhdimësi, një molepsje e qytetarëve të Kosovës nga frika e pasigurisë për integritetin territorial të shtetit të ri, si dhe për mungesën e vullnetit për të krijuar rend dhe ligj për të gjithë qytetarët e vendit.

A po vazhdon loja?

Pra, a mund të pajtohet me këtë imazh për veten e tij misioni i Bashkimit Evropian, EULEX? Mendoj se jo. A është koha që imazhi të ndërtohet tani? Mendoj se po. Por, si të krijohet ai? Mbi të gjitha, duke e kërkuar me ngulm profilin e një misioni veprues, i cili është ftuar nga institucionet e shtetit sovran të Kosovës për të ndihmuar qeverisjen në dy fusha sensitive dhe i cili, duke qenë se është misioni i bashkësisë së aspiruar evropiane, përmes respektimit të mekanizmave ligjorë do të ndihmojë në krijimin e një realiteti në të cilin do të mbisundojnë ligjshmëria dhe parimet e vlerat morale, natyrisht duke i respektuar liritë individuale dhe ato kolektive.

Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për një mision funksional të BE-së, madje ky synim nuk ndërlidhet aspak vetëm me veriun, megjithëse rastisi që aty të fillonte testi i vërtetë për të. Koordinimi me institucionet e republikës sovraane është i domosdoshëm, për të përcjellë vullnetin qytetar për ligjshmëri të aplikuar si normë. Takimi i krerëve të institucioneve me përfaqësuesit e sigurisë shkoj edhe më tutje: ai rritet mungesën e preventivës, që nënkupton lodhjen nga "prania e padukshme". EULEX-i duhet të bëhet i dukshëm. Ky është vullneti i qytetarit të Kosovës, imazhvlërësuesit të parë dhe të vetëm real të funksionimit të misionit të ri.

Intervistë me simbolin e rezistencës kombëtare Adem Demaçin

Për të parën herë në histor

- Çdo dimër, vij në Kosovë që ta shijoj dimrin e vërtetë me borë e cegëm;
- Historia e popullit tonë është vërtetë farë më vete dhe krejtësisht e pashembullt në botë;
- Mësim si kinezët, punë si gjermanët a japonezët, seriozitet si izraelitët!;
- Jam për hapjen e të gjitha dosjeve të komunizmit;
- Ata që po mundohen për të krijuar identitetin kosovar do të mbeten me gishta në gojë!

Intervistoi: Demir RESHITI

Nëse lufta për liri shënon shkallën më të lartë të emancipimit kulturor të individit dhe të popullit, atëherë mund të thuhet me gojën plot se Adem Demaçi është artikulli më i kulluar dhe më i fuqishëm i aspiratave liridashëse të popullit tonë.

Ku jeton aktualisht Adem Demaçi, me çka merret, si i vlerëson zh-

villimet politike në Kosovën e pavarur, çka mendon për EULEX-in, për Albin Kurtin, për dosjet e komunizmit, për tendencat e krijimit të identitetit kosovar etj., do të mësoni në intervistën ekskluzive që e realizuam për revistën tonë.

Çdo dimër, vi në Kosovë që ta shijoj dimrin e vërtetë me borë e cegëm

PAQJA: Keni lëvizur shpesh në relacionin Prishtinë-Sarandë dhe anasjelltas. Do të ishte me interes për lexuesin ta dijtë se ku gjendet sot Adem Demaçi dhe me çka merret?

Demaçi: Që nga Shmitri e këndejtë të vitit 2008 gjendem në Kosovë. Në Sarandë e bukur ka pranverë të vërtetë, ka verë të vërtetë dhe ka vjeshtë të vërtetë, por nuk ka dimër të vërtetë. Atje nuk bie borë dhe nuk bën ngricë. Atje tërë vitin trungjet e pemëve e të drunjve janë të blertë. Dhe temperatura shumë rrallë zbret nën dhjetë shkallë të Celsiusit. Meqë unë ndër shumë gjëra që ka kjo bota janë dua vetëm gjërat e vërteta, atëherë, për çdo dimër, vi në Ko-

sovë që ta shijoj dimrin e vërtetë me borë e cegëm.

PAQJA: Viteve të fundit i jeni përkushtuar më tepër letërsisë. Cilat janë librat më të reja që i keni publikuar dhe çfarë po shkruani aktualisht?

Demaçi: Në Dibrën e Madhe e në Sarandë, gjatë viteve 2006-2007 kam shkruar romanet "HELI E MIMOZA", "DASHURIA KUANTIKE E FILANIT", "ALB PROMETEU" dhe pjesën e dytë të trilogjisë nga ditët e kryengritjes sonë çlirimtare, "NËPËR TYM E FLAKË", romanin "NËNA SHEGË E PESË GO-CAT", ndërsa gjatë viteve 2007-2008 i kam botuar. Tani jam duke punuar në pjesën e tretë të kësaj trilogjie "SHKRUMNAJA Ç. 99".


PAQJA: Edhe pse nuk jeni të angazhuar në ndonjë subjekt politik, ju në vazhdimësi keni përcjellë zhvillimet politike. Cili është vlerësimi i juaj për zhvillimet në Kosovë pas pavarësisë?

Demaçi: Tani kemi hyrë në zhvillimin e procesit nga shpallja jonë e pavarësisë më 17 shkurt 2008 i cili po kalon e do të kalojë nëpër shumë vështirësi, dhimbje e të papritura deri te njohja e kësaj pavarësie nga shumica e botës së lirë e demokratike. Ky proces nuk do të zgjasë as tepër gjatë as fort shkurt...

Historia e popullit tonë është vërtetë farë më vete dhe krejtësisht e pashembullt në botë

PAQJA: U bë afro një vit që kur Kosova shpalli pavarësinë, por ende nuk po arrin ta funksionalizojë shtetin. Si e shihni ju këtë ecuri? Si duhet të veprhet tutje?

Demaçi: Historia e popullit tonë është vërtetë farë më vete dhe krejtësisht e pashembullt në botë: jemi popull më i moçëm në Evropë, por njëkohësisht jemi edhe popull më i ri në kontinentin tonë; Jemi



i vonesa jonë po shpaguhet

populli më i fortë e më i qëndrueshëm në Europë, por edhe populli më zemërbardhë e më mendjlehtë në kontinentin tonë. Jemi popull i copëtuar në gjashtë pjesë, por njëkohësisht jemi edhe populli më liridashës në kontinentin tonë e i cili nuk u pajtua asnjë sekondë me ndarjen që na u imponua nga grabitqarët rreth e rrotull. Edhe pse ende gjendemi të zhytur deri në shokë në pusin politik e ekonomik, jemi populli më optimist i kontinentit, sepse vetëm para dhjetë vjetësh, për mëse dy mijë vjet ishim të zhytur në pusin politik e ekonomik deri në fyt. Jemi popull prej të cilit po kërkohet që të bëjmë një shtet sipas rezultatës së interesave politikë të Europës e Amerikës të cilat synojnë që me çdo kusht ta marrin me të mirë Serbinë qoftë edhe në dëm të Kosovës. Me një fjalë latine jemi rast – sui generis – që në shqipet mund të thuhet –shah më vete – dhe prandaj edhe ne duhet ta gjejmë a ta zbulojmë formulën që do të na e bëjë të mundur që, si thoni Ju, ta funksionalizojmë këtë shtet i cili përkah novatorizmat e futurizmit e veta nuk ka shoq në botën tonë. Kjo do të na kushtojë fort shtrenjtë, por liria nuk ka çmim. Kur ta gjejmë formulën edhe do ta zbatojmë.

Mësim si kinezët, punë si gjermanët a japonezët, seriozitet si izraelitët!

PAQJA: *Pas ardhjes së EULEX-it në Kosovë, kemi një situatë kur Kosova udhëhiqet nga tri formacione të ndryshme me kompetenca jo shumë të qartësuara: UNMIK-un i cili po vazhdon të jetë prezent; EULEX-in i cili do të mbaj qëndrim neutral ndaj statusit, dhe institucioneve vendore të cilat deri më tani nuk kanë arritur ta shtrijnë funksionin e tyre në mbarë Kosovën. Cili është mendimi i juaj për këtë "konglomerat" institucionesh. Sa do të jenë në gjendje ato që ta shtrijnë ndikimin e tyre në tërë territorin e Kosovës?*

Demaçi: Prej këtyre tri komponentëve që ju numruat, me kalimin e kohës duhet të bien dy. Veprimi i këtyre tri komponentëve mbi Kosovën e martirizuar përbën një proces fort të ndërlikuar. Mirëpo, kjo është shkolla jonë politike, ekonomike e shoqërore të cilën

Adem Demaçi është i lindur më 26 shkurt 1936, në Prishtinë. Për shkak të angazhimit dhe veprimtarisë së tij në kauzën kombëtare, Adem Demaçi vuajti 28 vjet me radhë në burgjet e Jugosllavisë. Ai quhet edhe Nelson Mandela i Evropës.

Adem Demaçi udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (KMDLNJ), nga 1990 deri 1995. Në vitin 1991 u nderua nga Parlamenti Evropian me Çmimin Saharov.

Më 1993, Klubi i Rektorëve Universitarë në Madrid i dha Çmimin Special për Paqe, kundër racizmit, ksenofobisë, për qëndrim paqësor e tolerant dhe për përpjekje për të ndërtuar një të ardhme të mbështetur në të drejtat e njeriut...

Ndërkaq, më 14 dhjetor 1995, Adem Demaçit iu dorëzua Çmimi për të Drejtat e Njeriut i Universitetit të Oslos.

Gjatë periudhës 1998/1999, ka qenë zëdhënës politik i UÇK-së.

Në vitin 2005-2007 ka qenë Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Janë proverbiale fjalët e tij pas daljes nga burgu: "Që nga 21 prilli i këtij viti ndodhem në burgun më të madh në botë, që e njeh historia e njerëzimit - në burgun e Kosovës, ku më se dy milionë shqiptarë, nga regjimi hegjemonist-shovinist-terrorist, janë zhveshur nga të gjitha liritë dhe të drejtat më elementare njerëzore e kombëtare".

duhet ta kryejmë nëse duam që të bëhemi komb e që t'ia kalojmë së pari vetes e pastaj edhe krejt botës. Formula është fare e thjeshtë, por aspak e lehtë për t'u zbatuar prej nesh: MËSIM, MËSIM DITË E NATË – SI KINEZËT! PUNË, PUNË NATË E DITË SI GJERMANËT A JAPONEZËT! Dhe SERIOZITET E SERIOZITET SI IZRAELITËT!

PAQJA: *Sondazhet e bëra nga medime të ndryshme, e nxjerrin Albin Kurtin si njëri ndër personalitetet kryesore të vitit. Lëvizja që e drejton ai, pothuajse ka ngelur e vetmja opozitë reale në Kosovë. A mendoni se ka ardhur koha që Albini të hyjë në politikë?*

Demaçi: Ashtu si ka ditur Albin Kurti të punojë e veprojë deri më tash ashtu ka për të ditur të punojë e veprojë edhe tash e tutje.

Jam për hapjen e të gjitha dosjeve të komunizmit

PAQJA: *Këto ditë është ngritur debati mbi dosjet e komunizmit. Keni kërkuar edhe ju hapjen e tyre, por duam të dimë si duhet të trajtohen ata njerëz që janë të përfshirë në to?*

Demaçi: Unë jam që të hapen të gjitha dosjet, megjithëse dosjet janë në Beograd. Mund të qëllonjë edhe në Kroaci e në Slloveni, ndoshta edhe në Maqedoni. Tani, meqë Kroacia dhe Sllovenia kanë ndryshuar shumë, mund të ndodhë që të na japin dosjet.

Ata njerëz një dënim duhet ta marrin për atë vasalitet dhe bashkëpunim me okupatorin, e ky do të ishte dënimi më i madh i mundshëm. Dënimet e tjera të natyrave të tjera penale për këto gjëra nuk i shoh të arsyeshme, sepse do të krijohet një situatë e pamundur! Ku të gjenden sot dëshmitarët, njerëzit etj.

PAQJA: *Jeni njëri nga ata që keni vuajtur më së shumti nga sistemi ish-komunist. Mendoni se kjo që po deklaroni ju për dosjet mund të kuptohet si hakmarrje?*

Demaçi: Nuk jam për kurrfarë hakmarrjesh, meqë fajtorët kryesorë si Ali Shukriu, Kolë Shiroka, e disa të tjerë si Sinan Hasani që më shumë ka qenë një qyqan pa vlerë, sesa që ka pasur ndonjë ndikim, edhe pse ishte në poste të larta, biologjikisht kanë vdekur. Për ata që është dashur të marrin masa drastike kundër



tyre (që të mund të kënaqen, sepse atyre u kanë humbur baba, nëna, vëllai e të tjerë, me nënshkrimin e atyre që kanë vdekur), ajo kohë më nuk kthehet, ata njerëz më nuk ringjallen.

Kurse, këtyre që kanë mbetur gjallë (e që sot janë në pozita vendimmarrëse dhe ende përzihen në politikë, e në gjyqësi, sikur të ishin patriotë të vërtetë, ndërsa dihet që kanë bashkëpunuar me okupatorin), nuk duhet t'iu lihet vend ku merren vendime, sidomos aty ku është pushteti dhe ku luhet me fatin e këtij populli.

Ata që po mundohen për të krijuar identitetin kosovar do të mbeten me gishta në gojë!

PAQJA: Si i shpjegoni tendencat gjithnjë e më të hapura për krijimin e një identitet të ri, identitetit kosovar. Sa mund të kenë sukses këto përpjekje dhe sa janë të rrezikshme?

Demaçi: Për të parën herë në histori vonesa jonë po shpaguehet: jemi më të përgatiturit që të marrim pjesë në krijimin e identitetit evropian dhe në këtë mënyrë do të barazohemi me të gjithë popujt tjerë evropianë të cilët gjithashtu hynë në procesin e ndryshimit të identitetit të tyre lokal për të marrë një identitet kontinental. Ata që po mundohen për të krijuar identitetin kosovar do të mbeten me gishta në gojë!

PAQJA: Dhe në fund, cili do të ishte mesazhi i juaj për lexuesit e revistës PAQJA?

Demaçi: Kryet lart e mendjen poshtë! Shpirtin veprues e zemrën e qetë! Duart me kallo e ndërgjegjen e pastër! ■

Veprat letrare të Adem Demaçit

"Gjarpinjte e gjakut" (roman i ribotuar disa herë), 1958; "Gjarpijt e gjakut dhe novela të tjera" (zgjedhje), Nju-Jork, 1983; "Kur Zoti harron" (vëllim me tregime), 1990; "Libër për Vet Mohimin" (roman i ribotuar disa herë), 1994; "La metamorfosi di Vet Mohim" (përkthyer nga Nermin Vlora Falaski), Romë, 1995; "Tung, vargu im", 2002; "Heli dhe Mimoza", 2006; "Dashuria kuantike e Filanit", 2007; "Alb Prometeu", 2008; "Nëpër tym e flakë", 2008; "Nëna Shegë e pesë gocat", 2008.

Shpresë e hidhur në një realitet të ri

Abdurrahim MAXHUNAJ

Në Kosovën e pasluftës, korrupsioni mori përmasa të mëdha, duke e radhitur atë në vendin e parë në listën e shteteve të korruptuara. Varfëria u përhap me një shpejtësi të madhe dhe përfshiu kategori të ndryshme, madje i përfshiu edhe ata që janë në marrëdhënie pune. Në këto kategori hynë mësimdhënësit, punëtorët shëndetësorë, pensionistët...

Ta kesh mbi supë një detyrë me përgjegjësi të lartë siç është ajo e mësimdhënësve dhe mos të mundësh t'i përballosh shpenzimet që jeta në Kosovë t'i imponon është shumë paradoksale. Edhe pse pas nëntë vitesh qeveria mori vendim për rritjen e pagave, kjo vetëm sa e zbuti gjendjen e tyre sociale, por assesi nuk e zgjidhi atë.

Në anën tjetër një kategori edhe më e anashkaluar është ajo e punëtorëve shëndetësorë. Ata ende vazhdojnë të mbahen me premtime nga qeveria për rritjen e pagave, vetëm sa për t'i evituar grevat e tyre. Rasti më i freskët është ai kur qeveria mori vendim për rritjen e pagave prej 44 euro, mirëpo kaluan tre muaj nga marrëveshja me BSPK-në dhe punëtorët shëndetësorë ende nuk i kanë parë ato mjete.

Edhe pensionistët e shtetit më të ri në botë gjenden në situatë të vështirë. Ata derdhen djersë të madhe duke punuar vite të tëra. Kurse tani ata përballen me varfëri dhe pensioni i tyre nuk u del as për medikamente e lere më për gjëra të tjera. Me kontributin e tyre ata ndihmuan në ndërtimin e shumë objekteve të rëndësishme. Pensionet e tyre mund të quhen ndihmë sociale dhe në asnjë mënyrë pension. Shumica nga ta janë duke kaluar në një mjerim të paimagjineshëm për ta.

Sigurisht, se këto kategori të rëndësishme shoqërore nuk e merituan një trajtim të tillë, sepse ata me vite punuan dhe kontribuan për formimin e shtetit të Kosovës.

Pa asnjë dyshim se këto kategori duhet të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme, dhe kjo përgjegjësi u takon drejtpërdrejt institucioneve shtetërore, konkretisht qeverisë së Kosovës. ■



Universiteti i Prishtinës ka ndarë bursa për studentët e shkëlqyer

591 studentë përfitues të bursave të UP-së

Për vitin akademik 2008 -2009, në Universitetin e Prishtinës, bursën universitare kanë arritur ta fitojnë vetëm 591 studentë apo 1.47 për qind e studentëve.



Gëzim QERIMI

Universiteti i Prishtinës e ka vazhduar praktikën e shpërblimit të studenteve shembullorë. Për vitin akademik 2008 -2009, bursën universitare kanë arritur ta fitojnë 591 studentë apo 1.47 % e studentëve të gjithëmbarsëm.

Në bazë të Statutit të UP-së ku përcaktohen kushtet dhe kriteret për krijimin dhe funksionimin e skemës për dhënien e bursave studentëve më të mirë, të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës, bursat universitare ndahen për studentët e studimeve themelore (Bachelor), studimeve pasdiplomike (master dhe doktoratë) dhe studentët e huaj. Burimet financiare për financimin e këtyre bursave sigurohen nga participimi i studentëve për studime (tarifat e studimit dhe pagesat e tjera administrative, pagesat e studentëve për shërbime komerciale), donacionet, dhuratat dhe ndihmat, kontratat me organet vendore, ndërkombëtare, publike dhe private për mësimdhënie, kërkime shkencore, punë artistike dhe konsulta, si dhe të hyra të tjera në përputhje me ligjin në fuqi.

Kriteret për ndarjen e bursave

Për fitimin e bursës universitare studentët në studimet themelore (Bachelor) dhe studimet pasdiplomike (Master) duhet t'i plotësojnë këto kushte: Të jenë studentë të vitit të dytë e më lart, të mos kenë vit të përsëritur të studimeve, të kenë notë mesatare gjatë studimeve më

së paku 9.00 dhe të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përfundimisht me afatin e provimeve të shtatorit.

Përjashtim për notën mesatare 9.00 Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës ka bërë të disa fakultete ku bursa mund të arrihet edhe me notë më të ulët mesatare, por jo më pak se tetë(8), ndërsa në fakultetin e Arteve kusht është që studentët ta kenë notën mesatare mbi 9,5.

Sa do të jetë lartësia e bursës këtë vit?

Numrin dhe lartësinë e bursës universitare e përcakton Këshilli Drejtues i Universitetit, për çdo vit akademik.

kanë arritur ta fitojnë vetëm 591 studentë apo 1.47 për qind e studentëve. Nga kjo del se kriteret e vlerësimit në Universitetin e vetëm publik janë shumë të vështira, ose pjesa më e madhe e studentëve të UP-së (98.53 për qind) mësojnë vetëm sa për ta marrë një notë kaluese dhe për t'i kryer studimet, por nuk studiojnë që një ditë të jenë shkencëtarë të këtij vendi.

Gruda: Së paku 6 orë mësim efektiv në ditë për të qenë student i shkëlqyer

Se si arrin një student deri te përfitimi i titullit student i shkëlqyeshëm i UP-së, tregon Leutrim Gruda, njëri nga studentët përfitues të bursës universitare për vitin akademik 2008-2009. Leutrimi, nga qyteti i Drenasit, është student i vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, drejtimi automatik. Ai është i vetmi student përfitues i bursës universitare në këtë departament me notën mesatare 9,4 (në këtë fakultet për ta përfituar bursën mjafton nota mesatare 8,0). Ai

rrëfen se, për të pasur sukses në studimet në këtë fakultet, minimumi duhen gjashtë orë mësim efektiv në ditë. Leutrimi përmend edhe vështirësitë me të cilat përballen studentët gjatë studimeve, të cilat mund të jenë pengesë për suksesin e tyre. Karakteristikë tjetër e studentit Leutrim Gruda është se ai, në testin e maturës, kishte arritur suksesin me të mirë nga të gjithë maturantët e Republikës së Kosovës. Leutrimi, përveç studimeve, është i angazhuar në mënyrë aktive edhe në jetën studentore dhe është anëtar i kryesisë qendrore të organizatës 'Paqja Studentore'. Studenti Gru-

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Nr. 3178
Prishtinë, më 25. 12. 2008.

Komisioni për ndarjen e bursave i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24. 12. 2008 mori

Vendim

Mbi ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2008/09

Për vitin akademik 2008/09 bursa universitare ia ndahet këtyre studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës, në

FAKULTETIN E INXHIJERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti-Dega-Drejtimi	Viti i regjistrimit në Fakultet	Viti i studimeve	Nota mesatare	Kontingjenti i bursave	Nr i ligjes së rryftimit	Ditëlindja	Niveli i studimeve
1	Leutrim Emir Gruda	Automatika	2007	II	9.40	150190000067771	1174940408	14.07.1989	Bachelor
2	Orion Fari Goka	Electromera Industriale	2007	II	8.00	150190100796210	1172795927	22.12.1987	Bachelor
3	Aleksi Zvezd Horica	Kompjuterike	2007	II	8.80	1140140533000739	1173119973	22.06.1989	Bachelor
4	Orion Ali Jemshir	Kompjuterike	2007	II	9.20	150190000097073	1172952395	09.03.1990	Bachelor
5	Tilka Hyari Ajvazi	Kompjuterike	2007	II	8.50	1110274400000193	2129510117	05.07.1987	Bachelor
6	Korab Salih Rrokoti	Kompjuterike	2007	II	8.70	1700190102911730	1174078666	15.07.1989	Bachelor
7	Fajza Genci Begu	Kompjuterike	2007	II	8.50	1506001002725845	2172537967	14.06.1989	Bachelor
8	Admir Jafari Hala	Kompjuterike	2007	II	8.10	1501900000974611	1219966220025	12.12.1988	Bachelor
9	Artida Sadullin Ruzhici	Telekomunikacion	2007	II	8.30	1507001002900875	1173360698	24.06.1987	Bachelor
10	Admir Gëzim Kurbanov	Telekomunikacion	2007	II	8.60	1140134425000108	1173189520	12.04.1989	Bachelor
11	Ulinda Besim Kurbanov	Telekomunikacion	2007	II	8.00	1140153717300135	1173189520	30.11.1988	Bachelor
12	Vlora Musti Fariz	Telekomunikacion	2007	II	8.00	1501901008410008	1172963028	02.12.1988	Bachelor
13	Klona Buzdri Ahmeti	Telekomunikacion	2007	II	8.80	1501900000081817	1174411132	04.07.1987	Bachelor
14	Klona Buzdri Shalizi	Telekomunikacion	2007	II	8.10	1501900000081817	1172921912	04.10.1987	Bachelor

Vitin e kaluar studentët kanë përfituar nga 800 euro, ndërsa për këtë vit Këshilli Drejtues i Universitetit ende nuk e ka përcaktuar shumë. Ka mundësi që sivjet shuma të jetë më e lartë se 800 euro për faktin se numri i studenteve bursistë sivjet është më i vogël në krahasim me vitin e kaluar për 200 e më tepër.

Kërkesat për ndarjen e bursës universitare i ka shqyrtuar dhe vendosur komisioni i formuar nga ana e Këshillit Drejtues. Ky Komisioni përbëhet prej 5 anëtarësh, por ky komision ende nuk ka dhënë informacione rreth lartësisë së bursës.

Për vitin akademik 2008 -2009, në Universitetin e Prishtinës, bursën universitare

da për gjitha të arriturat e tij falënderon Allahun, pastaj i është edhe shumë mirënjohës dhe falënderues familjes së tij për mbështetjen e vazhdueshme që ka pasur nga ta. Shëmbëlltyrën e këtij studenti duhet ta ndjekin edhe studentët e tjerë, se vetëm me kapacitetet e tyre shteti i Kosovës mund të jetë konkurrent në tregun evropian.

Bursa edhe për hulumtime shkencore apo trajnime

Universiteti i Prishtinës ndan bursa edhe për hulumtime shkencore apo trajnime. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP, që vijon studimet e doktoratës jashtë vendit, që e ka marrë paraprakisht pëlqimin e Këshillit të fakultetit, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës mund të marrë vendim t'i ndahet ndihma materiale mujore prej 300-500 €, në kohëzgjatje më së shumti 1 vit. Gjithashtu, personelit

akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës që vijon studimet jashtë vendit me bashkëfinancim, Këshilli Drejtues mund t'ua lejojë gjysmën e shumës së mësipërme (150-250 €) në muaj.

Çmimi "Student i dalluar"

Universiteti i Prishtinës, për çdo vit akademik, me rastin e ditës së Universitetit, ndan edhe çmimin "Student i dalluar". Çmimi "Student i dalluar" u takon studentëve të vitit të fundit të studimeve që kanë notë mesatare 10 dhe që nuk kanë vit të përsëritur gjatë studimeve. Në mungesë të tyre mund t'iu ndahet edhe studentëve të vitit të fundit të studimeve me notë mesatare gjatë studimeve jo më pak se 9.00, më së shumti katër studentë për çdo njësi akademike (fakultet). Për këtë çmim, fakultetet i dërgojnë propozimet e tyre të arsyetuara me shkrim.

Fondacioni "Fehmi Fetahu" ndau bursa për 15 studentë

Ditë më parë, Fondacioni "Fehmi Fetahu" ndau bursa për 15 studentë nga Kosova. Përfitues të këtyre bursave kanë qenë studentë të universiteteve të Republikës së Kosovës të cilët nuk kanë kushte të mira ekonomike për shkollim. Vlera e bursave është 1200 euro për secilin, ndërkaq përzgjedhja e kandidatëve është bërë me konkurs.

Në ceremoninë e ndarjes së bursave ishin të pranishëm edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj, ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z Besim Beqaj, studentë dhe qytetarë të ftuar.

Fehmi Fetahu, kryetar i fondacionit, me këtë rast tha se ndihet i lumtur që ka rast t'iu ndihmojë sadopak studentëve kosovarë për krijimin e kushteve më të mira për shkollim. Ky është viti i parë që ndajmë bursa dhe do të vazhdojmë edhe në të ardhmen, sigurisht me një numër më të madh studentësh.

Rrëfimi i një prishtinasi, ish-përdorues i drogës

Varësia nga helmi

"...Pothuajse të gjithë shokët e mi, me të cilët kemi marrë drogë së bashku, kanë vdekur. Unë i kam humbur 20 vjetët më të mira të rinisë time. Tash jam mbi 30 vjeçar dhe po mendojem ta kompensoj kohën e humbur" - shprehet Gj. S. nga Prishtina, njeriu që ka arritur ta mposhtë varësinë nga pluhuri i bardhë dhe tani i ndihmon edhe të tjerët për ta flakur këtë ves vdekjeprurës.



Florentina LATA

Dita fillonte me një qëllim. Ajo zhvillohej sipas këtij qëllimi dhe nata e gjente të shtrirë për tokë, të struktur në një qoshe të lagjes së tij apo diku në periferi të qytetit. Për 20 vite me radhë, e njëjta dëshirë, e njëjta mënyrë e jetesës, i njëjti qëllim. "Drogë, drogë dhe vetëm drogë" - ishte mendja, ndjenja dhe dëshira e një të riu prishtinasi. Lufta e vetme për të, në jetë, përplot 20 vite ishte se si ta siguronte "ushqimin" e tij të preferuar – drogën.

Pranë shokët, mbi tavolinë qëndronin fletëzat e imëta të heroinës, kurse në mendjen e Gj. S.-së nga Prishtina, sillejt rrotull dëshira për ta konsumuar atë. Ishte vetëm 16 vjeçar në atë kohë dhe me insistimin e shokëve, kishte provuar për herë të parë në jetën e tij heroinën.

Mirëpo "prova" e tij nuk kishte përfunduar me kaq. Ky doli të ishte fillimi i një çorientimi total dhe kthimi në një jetë të tmerrshme, me plot mundime, vuajtje dhe ankthe. Gj. S. rrëfen vitet e tij të dhëna pas drogës, të cilat i konsideron të humbura dhe për të cilat sot ndien urrejtje.

"E luta një shok me ma siguru do marihanë por meqë ai nuk kish mujt me gjetë marihanë sepse ne vitet e 80-ta nuk kishte shumë konsumues të drogës kishte arritur me ma siguru do heroin dhe po ma bjen. Shkova në WC dhe e mora një vilm në hund mirëpo kur dola e kisha atë idenë se krejt po më shikojnë mua dhe se po e din se çka kom bo. Pas disa minutave më vinte të vjell dhe ndihesha si në gjumë".

Ditët kishin filluar të ndryshonin për Gj. S. Shkolla, familja dhe shoqëria për të tashmë kishin kaluar në planin e dytë të interesave të tij. E vetmja gjë për të cilën luftonte ai ishte sigurimi i "mallit", pavarësisht çmimit tepër të lartë, sidomos për standardin e jetesës në atë kohë në Kosovë. Mirëpo, Gj. S.-në nuk e "kënaqte" më heroina, ngase "oreksi" i tij për lloje të tjera të drogës ishte rritur dukshëm.



mi vetëvrasës ma çorientoi jetën

“Kam pas kushtet e mira dhe krejt paret që i kisha në dorë blejsa drogë me to. Dhe kur ja nisa me u bo i varur prej saj jeta ime filloj me ndryshu se çdo ditë ishte rutinë. Zgjohesha në mëngjes dhe vetëm mendoja se si ta siguroja heroinën. Dhe kështu vazhdova një kohë ta gjatë mirëpo edhe kjo filloi me e humb efektin dhe vazhdova me marr kokainë. Kokaina më jepte energji, më dispononte, dhe isha në gjendje te qeshja dhe vallëzoja gjithë natën. Pastaj vazhdova me krak, acid dhe deri sa kalova ne shpirc”.

Nga përdorues droge në ligjërues kundër drogës

Konsumi i tepruar dhe i të gjitha llojeve të drogës, për Gj. S.-në kishte filluar të bëhej një rutinë e zakonshme. Mirëpo, ai çdoherë vuante nga lodhjet e mëdha fizike, psikike dhe financiare, të cilat ia shkaktonte droga.

Duke e parë rrezikun që i kanosej, ai filloj të kthejë mendjen nga një botë dhe jetë tjetër, pa drogë. Për ta arritur këtë, ai kurrsesi nuk e kishte të lehtë por, pavarësisht nga vështirësitë, ai nuk u dorëzua asnjëherë.

“Mas një kohe nuk ndieja më kënaqësi por kisha dhimbje, nervozë, depresion dhe kërkua ndihmë në qendrat të cilat më ndi-

hmuam me u largu prej drogës për një kohë. Se me e lënë drogën është lehtë por me nejt pa drogë është vështirë. E vetmja mënyrë për me e lënë është me e burgos dhe me qenë vigjilent tërë kohën duke e bindur vetën se nuk guxon më me pi. Se dikur i sheh pasojat. Pothuajse të gjithë shokët e mi, me të cilët kemi marr drogë së bashku, kanë vdekur. Unë i kam humbur 20 vjetët më të mira të rinisë time, tash jam mbi 30 vjeçar dhe po mundohem ta kompensoj kohën e humbur” - shprehet Gj. S.

I vetëdijshëm për gabimin që ka bërë dhe për vitet e tij të çmuara të cilat i humbi pas drogës, e vetmja gjë që ai dëshiron sot, është t’ia kthejë buzëqeshjen

96 për qind e përdoruesve të drogës janë meshkuj

Nga të dhënat statistikore të siguruar në Entin e Statistikës si dhe në Shërbimin Policor të Kosovës, del se 95 për qind e përdoruesve të drogës, në Kosovë, janë me përkatësi etnike shqiptare, 4 për qind janë serbë dhe 1 për qind të tjerë. Sa i përket strukturës gjinore të përdoruesve të drogës, 96 për qind e tyre janë meshkuj dhe vetëm 4 për qind janë femra.

jetës dhe t’i harrojë sa më parë vitet e humbura. Gj. S. ka arritur të largohet nga droga me ndihmën e familjes dhe rehabilitimeve që ka bërë. Tani ai është ligjërues në një qendër rehabilituese dhe ju ndihmon të rinjve që të vetëdijesohen për pasojat e drogës.

Gj. S. sot jep një milion arsye për të rinjtë e tjerë, duke u bërë thirrje që mos ta provojnë asnjëherë në jetë, “helmin vetëvrasës”, siç e quan ai.

Muçaj: Ka shumë faktorë që e shtyn një të ri të merr drogë

Psikologja Dafina Muçaj thotë se ka shumë faktorë që e shtyn një të ri të

Marihuana më e përdorura

Shikuar sistematikisht, nga viti 2001 deri në vitin 2007, del se 46 për qind e drogës se konfiskuar ka qenë e llojit marihuanë. Pas saj radhitet heroina me gjithsej 28 për qind. Kokaina 3 për qind, 16 për qind bimë të kanabisit dhe 7 për qind droga të tjera.

marrë drogë, si, shoqëria, papunësia, kurioziteti, etj. “Shoqëria ka ndikim të madh sepse është ajo që në shumicën e rasteve i nxit të rinjtë që ta provojnë një herë dhe pastaj ata vazhdojnë vetë, sepse fillojnë të bëhen të varur prej saj” - thekson Muçaj duke shtuar se personat që veç janë të varur nga droga përbalën me pasojat të mëdha. Se sa është në gjendje një narkoman të largohet nga droga, Muçaj mendon se kjo varet edhe nga karakteri i përdoruesit. “Varësia nga heroina ka pasojat të mëdha si në aspektin shëndetësor, ashtu edhe atë social, sepse ai i humb të gjitha si familjen dhe shoqërinë dhe i vetmi send në jetë për të është heroina. Edhe në krizat e lënies ai e ka shumë vështirë sepse një problem shumë i vogël e kthen në gjendjen e mëparshme” - vlerëson kjo psikologe, duke shtuar se “kjo varet edhe nga karakteri i përdoruesit se sa ai është në gjendje të rezistojë”.

Ndërkaq, Safet Blakaj, drejtor i organizatës joqeveritare ‘Labyrinth’ e cila merret kryesisht me trajnimin dhe rehabilitimin e viktimeve të substancave narkotike, thotë se ka rritje të numrit të atyre që janë të varur nga droga. “Gjatë viteve të fundit, në qendrën tonë, çdo ditë paraqiten 11 raste të reja ku 9 për qind prej tyre janë femra. Edhe pse në qendrën tonë vijnë ata të cilët e kanë kaluar një stazh të drogës, po shihet se ka rënie të moshës dhe mesatarja është 18 vjeç”. Ai thotë se përdoruesit e drogës janë kryesisht njerëz të moshës se re, por ka edhe prej atyre që i takojnë një gjenerate më të vjetër. ■



Korrespondencë nga Shkupi

Maqedonia, mësuesja e



Avni AVDIU

Ishin pushtetarët komunistë maqedonas ata që para viteve të 90 - ta filluan eksperimentet represive ndaj shqiptarëve, duke i dhënë leksione Beogradit se si duhet vepruar. Duke rrënuar dhunshëm muret, duke mbyllur shkollat shqipe, duke burgosur padrejtësisht shqiptarët dhe duke i torturuar ata vazhdimisht, IRJM - së u bë model i Millosheviqit, për të filluar ai fushatën e tij në Kosovë. Pas shkëputjes së saj nga federata jugosllave, IRJM - së bëri ndryshimet kushtetuese, me të cilat i hoqi të gjitha të drejtat e garantuara më parë për shqiptarët. Ndryshime kushtetuese kishte bërë edhe Millosheviqi, duke suprimuar autonominë e '74-tës me çka Kosovën e shkriu edhe më tepër brenda Serbisë.

Edhe pse trumbetohej se Maqedonia u bë vend demokratik, prapëseprapë reprezaljet ndaj shqiptarëve nuk kishin të ndalur. Ndodhën rastet e Bit Pazarit, Radolishtës, Gostivarit, Reçicës së Vogël e të tjera raste që dëshmonin vendosmërinë e Shkupit për të folur me shqiptarët vetëm me gjuhën e hekurit. Euforia shtetformuese sllavomaqedonase kishte arritur ekstazën me pranimin e pavarësisë së saj nga shumë shtete të rajonit. Agonia e shqiptarëve sa vinte e shtoej. Atë e ndihmuan edhe shumë pseudopatriotë partiakë që nëpër mitingje premtin e hidhnin pas shpine sapo uleshin nëpër kolltukë. Intensifikimi i dhunës dhe gjendja e padurueshme, më në fund, shpërthyen me luftën, që ka mund të evitohej. Lufta ishte jo vetëm rezultat i represionit sllavomaqedonas ndaj shqiptarëve, por pa mëdyshje edhe rezultat i hezitimit të politikanëve shqiptarë të kyçur nëpër institucione për ta ngritur zërin në artikullimin më kategorik të kërkesave të popullit. Kolltukofagët shqiptarë asnjëherë nuk u kanosën seriozisht me lëshimin e institucioneve,

e lëre më t'i lëshonin ato. Përndryshe sikur të ndodhte kjo, Shkupin do ta përfshinte kriza qeveritare, sepse ishte i kushtëzuar nga bashkësia ndërkombëtare me pjesëmarrjen e shqiptarëve në institucione.

Dhe ashtu siç nuk mund të harrohet lufta në Kosovë, ashtu nuk mund të harrohet edhe lufta në Maqedoni. Kërdinë që kanë bërë bombarduesit e marrë nga Ukraina, "spektakli" i granatimeve mbi shtëpitë e banuara me popullatë, pësimet e fëmijëve, grave e pleqve, pastaj sjelljet çnjerëzore në Bllacë ndaj kosovarëve të dëbuar, nxitimi për ta gllabëruar pjesën e Kosovës (Debëllde - Viti) me nënshkrimin e marrëveshjes me Serbinë etj; të gjitha këto janë kaptina më tragjike në historinë e Maqedonisë. Ajo do të reflektojë gjithnjë mbi brezat që vijnë pas.

Viti 2008- vit i mbrapshtë për shqiptarët e Maqedonisë

Maqedonia me Greqinë është në krizë për emrin, me Serbinë në krizë për fenë, me Bullgarinë në krizë për identitetin. Po me shqiptarët vallë në çfarë krize ndodhet Shkupi zyrtar?

Me shqiptarët sllavomaqedonasit, nëse kanë sadopak mendje të logjikojnë e kanë vetëm një krizë, e ajo është kriza morale. Sjellja dhe politika e tyre ndaj shqiptarëve, duhet t'i skuqë pak në fytyrë.

Vitin që lamë pas, shqiptarët e Maqedonisë e patën vit të mbrapshtë. Të vetmin ngushëllim mund ta kenë pasur se vëllezërit e tyre përtej kufirit shënuan shumë hapa përpara. Shqipëria mori ftësën për anëtarësim në NATO, Kosova shpalli pavarësinë dhe u pranua nga më se 50 vende si shtet i pavarur.

Për Maqedoninë jo vetëm se u harua anëtarësimi në NATO, por është në pikëpyetje edhe procesi tjetër kryesor, ai i marrjes së datës për nisjen e negociatave për anëtarësim në Unionin Evropian.

Shqiptarët e Maqedonisë, siç po shihen punët, BDI-ja nuk do t'i integrojë as në NATO, e as në BE, por në VMRO-DPMNE.

Diskriminimi dhe nënçmimi ndaj shqiptarëve ka arritur kulmin

Nëpër kuluare është folur se Gruevski i ka marrë partner në bashkëqeverisje, sa për t'ua humbur fytyrën plotësisht, si revansh ndaj luftës së 2001 - shit dhe humbjes së atëhershme të pushtetit. Hyrja në koalicion pa kurrfarë kushtesh dhe ngjarjet që pasuan e konfirmojnë këtë.

S'mbahet mend të ketë qenë popullata shqiptare më e zemëruar pas 2001 - shit sesa tani. Diskriminimi dhe nënçmimi ndaj shqiptarëve ka arritur kulmin dhe për të qenë neveria më e madhe kjo bëhet me bekimin e partisë, e cila thuhet se doli nga ish-strukturat e luftës. Çuditërisht, ata që më zëshëm deklarorin se pas konfliktit të 2001-shit ua kthyen dinjitetin dhe krenarinë shqiptarëve në Maqedoni, sot, ata të njëjtit, të konvertuar në heshtakë dhe servilë janë bashkëpjesëmarrës në poshtërimin e tyre.

Kjo qeveri përpiloi dhe miratoi ligjin për natalitetin, ligj që jo vetëm se shkel të drejtat ndërkombëtare, por edhe ato njerëzore. Ligji u siguron nënave maqedonase që vendosin të lindin sa më shumë fëmijë aq më shumë para, jo vetëm



e Serbisë

sa janë duke i rritur fëmijët, por edhe në pleqëri, duke u garantuar pensione të majme. Kjo qeveri u siguroi 'brantelave' (maqedonasve që luftuan kundër shqiptarëve më 2001 - shin) beneficione të mjaftueshme, gjersa akoma mbeten të anashkaluar invalidët shqiptarë të luftës. Kjo qeveri pakësoi dukshëm buxhetin e Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe ua shtoi buxhetin universiteteve maqedonase. Kjo qeveri diskriminoi edhe studentët shqiptarë në dhënien e bursave: nga gjithsej 1360 bursa vetëm 30 janë që u janë ndarë studentëve shqiptarë. Kjo qeveri dita-ditës po i përjashton shqiptarët nga puna (së fundi 47 shqiptarë janë dëbuar nga fondi pensional, 15 nga konvikti shtetëror etj), të cilët zëvendësohen shumica me maqedonas dhe pak me aktivistë të partisë shqiptare në pushtet. Pra largimi dhe pushimi i shqiptarëve nga puna brenda institucioneve shtetërore, po ashtu, është mjaft i madh.

Siç pretendonte dikur PDSH-ja ta arsyetonte krimin në Brodec, tani BDI-ja pretendon t'i arsyetojë krimet në Sopot e gjetiu

Populata shqiptare është hedhur në zgrrip të ekzistencës, ndërsa ajo

maqedonase pasurohet gjithnjë e më shumë. S'mbahet mend ndonjëherë nënat e motrat shqiptare të kenë zgjatur rrugëve duart e lypësisë, kurse tash kjo po ndodh me të madhe. Edhe pse shkollimi i mesëm është bërë i obliguar, kjo qeveri vazhdon t'u shkaktojë problem shqiptarëve për të penguar shkollimin e tyre (p.sh: problem me regjistrimin e nxënësve në Shkup, problem me lokalet në Kumanovë, Idrizovë etj). Kjo qeveri ka cunguar me ligj përdorimin e gjuhës dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Dhe për ta arritur kulminacionin në vend të akuzave të mëparshme për 'nacionalizëm', tani i akuzon shqiptarët për terrorizëm, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i stigmatizojë si njerëz destruktivë edhe në arenën ndërkom-bëtare. Vetëm në këtë mënyrë, mund t'i përlligjë botërisht fushatat e bastisjeve kundër shqiptarëve në komunat Likovë, Kumanovë, Haraçinë, Hasanbeg, Çair, maltretimet dhe skenat poshtëruese në familjet shqiptare, trishtimin e traumat e fëmijëve dhe arrestimet arbitrare në pikë të natës. Dëmin dhe poshtërimin po e ndiejnë thellë familjet shqiptare, të cilave nën pretekstin e 'investigimit' po u nëpërkëmbet dinjiteti që nga mëngjesi i hershëm e deri natën vonë. Familjarët s'mund t'i shohin të arrestuarit, ndërsa të paraburgosurit mbahen në qeli nën torturë të lëmerishme, e vetëm që t'u imponohet pra-

nimi i fajit të pabërë (për ta pranuar veprën që kurrë s'e kanë bërë). Dhe pas gjithë kësaj, del lideri i partisë shqiptare në pushtet BDI-së, Ali Ahmeti dhe i akuzon mediet shqiptare se kinse po i zmadhuakan këto raste, se po i rritkan numrat dhe po i hiperbolizuan. Ai pohoi gjithashtu se kriminelët nuk do t'i vërë nën mbrojtje. Mirëpo tash kur veçmë flet nga fotelja e butë është shumë e paqartë se si iu shndërruan ish-bashkëluftëtarët tani në kriminelë, ... apo a mund të llogaritet kriminel një i sëmurë mental, të cilit i është drejtuar tyta e automatikut, për asgjë tjetër veçse për argëtim, sepse gjetet e tij i kanë kënaqur 'specialcat' e Alfave?! Siç pretendonte dikur PDSH-ja ta arsyetonte krimin në Brodec, tani BDI-ja pretendon t'i arsyetojë krimet në Sopot e gjetiu. Me pak qeverisje e me shumë servilizëm e vardisje BDI-ja del e ekzaltuar dhe deklarohet për funksionim të shkëlqyeshëm të koalicionit qeveritar. Me miopi politike flet se si nuk po pranua të dalë nga qeveria për shkak se po dashka t'i mbrojë votat e shqiptarëve që kanë votuar për këtë parti. Në realitet krejt kjo bëhet për inat të ndonjë partie shqiptare që eventualisht do të bëhej pjesë e qeverisë.

Nëse PDSH-ja ra në nivel të ulët me hyrjen në koalicion më 2006 -n me VMRO-DPMNE, atëherë në çfarë dërxhe ka rënë tani BDI-ja, 'partia e dalë nga lufta', duke pranuar këtë status brenda koalicionit qeverisës?! Në qoftë se ajo mori numrin më të madh të votave, d.m.th, është më e madhe, atëherë le ta dijë se sa më i madh që je, aq faj më të madh ke, nëse nuk i lëviz gjërat përpara...

Një gjë dihet. Shqiptarët në Maqedoni për momentin janë të dënuar historikisht të kenë udhëheqje politike mjerane dhe çështë më e keqja bile as nuk kanë alternativë dhe zgjedhje më të mirë, sepse secila kastë politike që vjen dëshmohet më e zeze se tjetra. Ndërkaq pas arrestimeve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së në Maqedoni, pasuan menjëherë edhe arrestimet e xhandarmerisë serbe po ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së, në Luginën e Preshevës.

Kush mund ta dijë në të ardhmen se çfarë planifikon Maqedonia ta mësojë Serbinë për të eksperimentuar diçka tjetër me shqiptarët?!....



Holokausti në Gaza

"Ai i cili mbyllet në një njeri të pafajshëm është sikur ta ketë mbytur tërë njerëzimin, ndërsa ai i cili e shpëton, është sikur ta ketë shpëtuar tërë njerëzimin". (Kuran 5:32)

"Ne duke mos arritur që drejtësisë t'i japim fuqi, fuqinë e kemi shndërruar në drejtësi." (Blaise Pascal)



Ajni SINANI

Sipërfaqja e Rripit të Gazës është 363 km². Në terma gjeografikë, ajo përfaqëson thuhetse 2 për qind të territorit të përgjithshëm palestinez. Ka 1.5 milion banorë dhe 1 milionë refugjatë, që Izraeli i përzuri me qëllim që të sillte kolonët e vet. Gaza është një nga vendet me popullsinë më të dendur në botë. Kufizohet me Egjiptin në një gjatësi prej 11 km, me Izraelin 51 km, dhe ka 40 km vijë bregdetare.

Gaza ka kohë që është bërë një burg i hapur i mbushur plot me njerëz të dëshpëruar. Në zgjedhjet e para të lira në botën arabe, në vitin 2006, Fatahu i udhëhequr nga Mahmud Abasi, që kishte mbështetjen e Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u mposht nga Hamasi. Si rrjedhim, u vendos një bllokadë ndëshkuese mbi Gazën. Në vitin 2006, Izraeli filloi sulmet "anti-terroriste" dhe bastisjet në Gaza, në përpjekje për të rrëzuar Hamasin. Palestinezët iu përgjigjën me lëshim raketash.

Izraeli në vend që të hapte vendkalimet me Gazën dhe të vazhdonte pro-

cesin paqësor edhe në Bregun Perëndimor, ai, në vazhdimësi, ka përforcuar rrethimin e tij vdekjeprurës duke ia ndërprerë asaj furnizimin me ujë dhe energji elektrike dhe duke organizuar atentate dhe vrasje.

Si pasojë e kësaj, sipas vlerësimeve të Kombeve të Bashkuara, pjesa më e madhe e banorëve të Gazës ishin në një gjendje të mjerueshme. Shtatëdhjetë për qind e fëmijëve palestinezë vuanin nga të ushqyerit keq. Institucionet mjekësore ishin pa personel dhe ilaçe të mjaftueshme.

Në qershor të vitit 2008, u arrit një armëpushim. Gjatë gjashtë muajve, Hamasi kishte respektuar ndërprerjen e zjarrit. Por populli i uritur i Gazës vazhdoi të qëndrojë i rrethuar më shumë se 18 muaj, i burgosur në burgun më të madh në botë, nga toka, ajri dhe deti. Ai gjendej i mbyllur si në kafaz. Bllokada ishte një dhunim i madh i ligjit ndërkombëtar dhe Konventës së Gjenevës, por Perëndimi heshti.

Me një politikë të tillë Izraeli i kishte detyruar banorët e Gazës të zgjidhnin, sikurse shprehen ata, mes zhdukjes së ngadalshme dhe asaj të shpejtë. Hamasi, duke parë se Izraeli nuk po e largonte rrethimin, nuk pranoi të shtynte armëpushimin dhe filloi lëshimin e raket-

ave në drejtim të Izraelit. Këto raketa, sipas banorëve të Gazës, ishin vetëm një klithmë dhe protestë ndaj botës, për largimin e rrethimit dhe hapjen e vendkalimeve.

Izraeli fillon ofensivën

Armëpushimi skadoi në prag të zgjedhjeve izraelite. Partia Likud e Netanjahut, sipas sondazheve, ishte në krye. Përmes sulmit ndaj Gazës, Partia e Punës e Barakut dhe Kadima e Cipi Livnit, po përpiqen të provojnë se janë më të fortë sesa Likudi. Sipas analistëve arabë, sulmet e rënda mbi Gazën ishin për të frikësuar fqinjët arabë dhe për të përmirësuar imazhin e forcës izraelite, pas dështimit të turpshëm më 2006 në Liban. Me ofensivën në Gazë, Izraeli gjithashtu ka dashur që t'ia bëjë me dije Administratës së Re të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të ketë kujdes dhe të mos ulet në bisedime me aktorët e linjës së ashpër në Lindjen e Mesme.

Izraeli ka thënë se qëllimi i luftës është të asgjësojë raketat e Hamasit. Ndërkaq, Ephraim Halevy, ish shef i agjencisë së shërbimit Mossad, ka deklaruar për shtypin izraelit se qeveria izraelite ka pasur rastin të mënjanojë sulmet me raketa qysh herët me largimin e sanksioneve ndaj Gazës. Por Izraeli, sipas tij, ka një interes më të gjerë: të sigurojë që Fatahu, dhe jo Hamasi të jetë dominues në territoret palestineze.

Edhe Hamasi ka deklaruar se, ndonëse nga Bregu Perëndimor nuk është lëshuar asnjë rakete, Izraeli gjatë vitit 2008 ka mbytur 50 njerëz dhe ka plagosur me qindra të tjerë, duke vazhduar pa u lodhur ekspansionizmin e vet. Prijësit e Hamasit thonë se ajo që po ndodh me Gazën sot, ka ndodhur edhe më herët me Jaser Arafatin. Kur ai refuzoi t'u nënshtrohej urdhrave të Izraelit, u burgos në selinë e tij në Ramallah, i rrethuar me tanke, për dy vjet. Kur e panë se nuk patën sukses ta thyejnë vendosmërinë e tij, e mbytën duke e helmuar.



Pushtimi i qyteteve

Ministrja e punëve të jashtme Izraelite, Cipi Livi ka deklaruar se Izraeli mbron "vlerat" e "botës së lirë", kurse zëdhënësi i ushtrisë çifute në kanalën televiziv El Xhezire ka deklaruar vazhdimisht se kemi një ushtri që i respekton vlerat etike të luftës më shumë se cilado ushtri në botë!

Për palestinezët është i gjatë vargu i krimeve izraelite – nga Deir Jassini në vitin 1948, deri më sot në Gazë. Arsyetimet ndryshojnë, ndërsa realiteti gjithnjë mbetet i njëjtë: okupimi kolonial, shtypja dhe padrejtësia e pafund.

Me luftën e tij shfarosëse ndaj Gazës, me bombardime nga ajri, toka dhe deti, Izraeli ka shkelur të gjitha konventat dhe rregullat e ligjit ndërkombëtar. Ai nuk ka kursyer asgjë. Ka shkatërruar ndërtesat e qeverisë, shtëpitë e banorëve të thjeshtë, xhamitë, spitalet, shkollat, tregjet dhe ka vrarë fëmijë, gra e pleq. Civilët duhet të vuajnë - thotë Izraeli - sepse Hamasi frikacak fshihet mbas tyre. Ndërkaq, ka qenë i çuditshëm deklarimi i habitshëm i shumicës së liderëve perëndimorë, se Izraeli po bën gjithçka që është e mundur për të evituar viktimat në radhët e civileve!

Komisioni Parlamentar i BE ka kërkuar nga Izraeli që të respektojë rregullat njerëzore dhe ndërkombëtare dhe të lirojë të gjitha ndihmat humanitare që vijnë nga shtetet e ndryshme për popullin e Gazës. Komisionerja e Lartë e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay, ka bërë thirrje për kryerjen e një hetimi të pavarur mbi çdo shkelje të ligjit ndërkombëtar, gjatë konfliktit në Gazë. Duke folur për BBC-në, zëvendës shefja e Zyrës së OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare, Allegra Pacheco ka thënë: "Ne kemi marrë njoftime nga dëshmitarë okularë se ditën e diel, 100 vetë u evakuuan nga shtëpitë e tyre dhe u çuan në lagjen Setun në jug të Gazës." "Një ditë më vonë, kjo ndërtesë u bombardua dhe të paktën 30 vdiqën, sipas këtyre dëshmitarëve okularë, shumë të tjerë u plagosën." "Ambulan-

cat nuk u lejuan në këtë zonë deri ditën e djeshme, kur u evakuuan të plagosur të tjerë dhe u gjetën disa kufoma" - tha zonja Pacheco.

Numri i viktimave ka tejkaluar shifrën prej 900 të vrarë, më shumë se 50% e të cilëve janë fëmijë, gra e pleq. Ndërkaq, Çekia si kryesuese e BE ka deklaruar më herët se Izraeli këtë ofensivë e ka filluar për qëllime mbrojtëse!

Protesta masive anekënd botës kundër sulmeve izraelite

Pamjet e kasaphanës të shfaqura përmes medieve botërore kanë shkaktu-

zhdukë vetveten... historia do t'iu gjykojë sepse e keni njollësuar humanitetin".

Reagimet me gjysmë zemër nga ana e regjimeve arabe në lidhje me Luftën në Rripin e Gazës kanë zmadhuar hendekun ndërmjet popullsisë dhe regjimeve. Gjithnjë e më shumë protesta dhe mallkime drejtohen jo më kundër Izraelit dhe SHBA, por kundër qeverive të tyre. Atë që ka thënë një gazetar kuvajtian, e mendojnë shumë njerëz në botën arabe: "Holokausti në Gaza tregon fytyrën e shëmtuar të disa qeverive arabe, të cilat kanë humbur edhe pjesën më të fundit të dinjitetit."

Nuk ka munguar as roli i dijetarëve. Jusuf El Kardavi ka ftuar që "Dita e xhuma të jetë ditë e zemërimit". Në këtë thirrje thuhet: "Të gjithë imamët janë të ftuar që në hutben e xhumasë të bëjnë thirrje për ndihmë për Gazën dhe të falin namazin në mungesë për shpirtrat e dëshmorëve".

Sipas palestinezëve, në këtë ofensivë Izraeli do të përjetojë të njëjtën disfatë sikurse e kishte pësuar në Liban në qershor të vitit 2006. Halid Mesh'al, drejtuesi i byrosë politike të Hamasit ka thënë: "Neve kurrë nuk do të na thyejë rrethimi dhe bombardimi dhe kurrë nuk do t'i nënshtrohemi okupimit".

Inciativa

Këshilli i Sigurimit ka kërkuar ndër të tjera, që Izraeli të tërhiqet krejtësisht nga Rripi i Gazës. Në rezolutën e aprovuar në Nju-Jork dënohet çdo "formë e dhunës kundër civilëve", si dhe çdo "lloj terrorizmi". Egjipti ka filluar një iniciativë me përkrahjen e Turqisë. Hamasi këmbëngul se ndërprerja e sulmit me raketa duhet të kushtëzohet jo vetëm me ndërprerjen e zjarrit, por edhe me largimin e forcave izraelite, ngritjen e rrethimit dhe hapjen e vendkalimeve.

Çdo ditë që kalon lufta e padrejtë dhe e pabarabartë merr jetë të pafajshme. Lusim Allahun e Plotfuqishëm që të gjithë të rënë palestinezë t'i shpërblejë me xhennet dhe që ky holokaust palestinez të përfundojë sa më shpejt. ■



ar dëshpërim dhe zemërim duke shkaktuar protesta masive anekënd botës. Sloganet kanë qenë të shumta, por që të gjitha ato kanë përcjellë mesazhin se kjo krahurë duhet të ndalet sa më shpejt, sepse ajo çfarë po ndodh në Gazë është një turp, humbje nderi dhe poshtërim. Ndërkaq qeveritë e shteteve të fuqishme kanë mbyllur sytë para krimeve të kësaj lufte të pakuptimtë.

Kryeministri turk ka qenë shumë i ashpër në kritikën e tij që i ka drejtuar qeverisë izraelite, me rastin e sulmit më 27 dhjetor. Ai ka thënë: "Izraeli po sillt në mënyrë johumane dhe me këtë do ta

Veriu i Kosovës jashtë kompetencave të institucioneve

Mitrovicasit kërkojnë ndi



Florije ADEMI

Ura e Ibrit që e ndan Mitrovicën në dysh, vazhdon ta kryejë “misionin” e saj edhe pas pavarësisht të vendit. Dy hyrjet e urës mbikëqyren nga policët e Kosovës, ana e jugut nga shqiptarët e ajo e veriut nga policët serb të Kosovës, ndërkaq tërë veriu i saj vazhdon të jetë jashtë kompetencave të institucioneve vendore.

Ndonëse viti 2008, nga strukturat komunale, vlerësohet si viti më i begatshëm për shkak të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe aprovimit të kushtetutës së saj, mitrovicasit flasin për një gjendje edhe më të keqe se që ka qenë vitin paraprak.

“Këtë vit u ba veç ma keq se që ka qenë. Tash e kemi kufirin në derë të shtëpisë” - thotë Alush Alushi nga Suhadolli, familja e të cilit numëron katër të vrarë gjatë luftës në Kosovë, duke e shprehur zhgënjimin e tij ndaj strukturave udhëheqëse lokale dhe qendrore.

Përparimet nën hijen e dështimeve

Derisa muajit e fundit janë realizuar dhe janë në realizim e sipër disa projekte në veri të Mitrovicës, në fshatrat dhe në lagjet veriore: “Lagjen e doktorëve” dhe “Kroin e Vitakut”, mungesa e funksionit të institucioneve të Kosovës në veri të vendit pas trazirave të përgjakshme të marsit, bënë që “hapësirat e bardha” të shihen fare pak.

“Unë nuk shoh ndonjë ndryshim të madh për të mirë që ka ndodh gjatë këtij viti, me ndërrimin e pushtetit. Përveç asfaltimit të disa rrugëve në sfera të tjera nuk shoh ndryshime” - thotë Afërdita Sylja nga shoqëria civile.

Në anën tjetër, shton ajo, gjendja është keqësuar shumë për shkak të mosfunksionimit të organeve të drejtësisë në objektet e tyre në veri të Mitrovicës dhe pikave doganore në kufirin Kosovë-Serbi.

Ndryshe, zyrtarë të policisë thonë se vetëm në nëntëmujorin e parë të vitit

Serbia ka forcuar strukturat e saj në veri, të cilat UNMIK-u as që kishte provuar t'i ndalonte. Banorët e lagjes së Boshnjakëve pas incidenteve të njëpasnjëshme, si sulme, provokime, dëmtime të pronave të tyre, kërkojnë t'u ofrohet siguri nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës



që lamë pas, policia në bashkëveprim me institucionet e tjera ka iniciuar 176 raste të kontrabandës ose tregtisë së palejujshme, ku fenomeni më i shfaqur i kontrabandës është paraqitur me derivate, ndërsa policia së bashku me njësitë antikontabandë të doganave ka sekuestruar mbi 97693 litra derivate.

“Sa i përket rasteve të kontrabandës të derivate, policia ka shënuar edhe raste në të cilat ka identifikuar sasi të derivate të cilat i ka dorëzuar drejtpërdrejt në terminalin doganor duke mos iniciuar raste në polici. Kjo sasi e derivateve duhet të arrijë deri në mbi 50.000 litra” - thotë zëdhënësi rajonal i policisë së Kosovës, Besim Hoti.

Ende, në shumë pika afër Ibrit, funksionojnë pompat që shesin derivate të kontrabanduara. Gjatë gjithë kësaj kohe Serbia i ka forcuar strukturat e saj në veri, të cilat UNMIK-u as që kishte provuar t'i ndalonte. Kjo i ka shkaktuar humbje të mëdha buxhetit të Kosovës.

Gallucci, ujësjellësi i Suhadollit, Ali Kadriu...

Një nga ngjarjet që për disa muaj rresht shkaktoi bujë në qarqet politike dhe mediale gjatë këtij viti në Mitrovicë, ishte edhe çështja “Gallucci”. Qëndrimi i

tij kritik ndaj autoriteteve ndërkombëtare dhe vendore për mbrojtjen e organeve të drejtësisë në veri, por dhe puna e tij e njëanshme në këtë rajon, reflektoj me ngrirjen e raporteve ndërmjet tij dhe kryetarit të komunës, Bajram Rexhepit, dhe me protesta të grave, të cilat vlerësohet se patën ndikim të madh në largimin e tij nga ky rajon.

Gjatë këtij viti ndodhën edhe dy çështje të tjera në veri të Mitrovicës që u përcollën me incidente ndëretnike dhe kundërshtime të shumta.

Ndonëse Komuna e Mitrovicës kishte filluar ndërtimin e një ujësjellësi në Suhadoll, që do të furnizonte me ujë të pijshëm banorët e Gushavcit dhe Vinarcit, serbët lokalë në Suhadoll penguan realizimin e këtij projekti.

Ata arritën të pengojnë këtë projekt, por jo edhe ta ndalin Ali Kadriun nga lagja veriore “Kroi i Vitakut”, që ta fillojë meremetimin e shtëpisë së tij.

Serbët e kundërshtuan kthimin e tij, ndërsa policia e UNMIK-ut shumë herë nuk e lejoi atë që të futet në oborrin e tij, me pretekst se po provokonte situatën. Megjithatë, ai nuk ka hequr dorë nga meremetimi dhe kthimi në shtëpitë e tij.

Ai tashmë ia ka vendosur kullës së tij, siç e quan ai, dyert dhe dritaret e reja dhe

Ndihmën e pushtetit qendror

së shpejti pritet të përfundojë meremetimi dhe të kthehet aty për të jetuar.

Përveç, këmbëngulësisë së tij për kthimin në pronën e vet, që pa dyshim se konsiderohet një hap shumë pozitiv që u çel rrugë edhe familjeve të tjera për t'u kthyer në shtëpitë e tyre atje, vlen të përmendet edhe rindërtimi i tetë shtëpive në "Lagjen e Doktorëve", po ashtu në veri të Mitrovicës, e cila u bë me ndihmën e komunës së Mitrovicës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Incidentet ndëretnike

Vitin 2008 Mitrovica e përmbylli me incidente ndëretnike që ndodhen në mbrëmjen e 30 dhjetorit, me ç'rast një serb është therur me thikë, një shqiptar është plagosur me armë zjarri, ndërkaq tre zjarrfikës dhe një gazetar kanë pësuar lëndime nga dy shpërthime që ndodhën në veriun e Mitrovicës, njëri nga të cilët në "Lagjen e boshnjakëve" të banuar me popullatë të përzier.

Banorët e kësaj lagje pas incidenteve të njëpasnjëshme, si sulme, provokime, dëmtime të pronave të tyre, kërkojnë t'u ofrohet siguri nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës, ndërkaq, në pronat e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës, në vendin e quajtur "Vojni Remont", të vendosen Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Organizata joqeveritare "Bregu i veriut", përmes një shkresë, u thotë krerëve të institucioneve më të larta vendore se thënia 'çlirim i Kosovës' nuk vlen ende

Yakovleff: Zjarrit do t'i përgjigjemi me zjarr

"Nuk ka invazion të shqiptarëve në veri dhe tanket shqiptare nuk janë duke i sulmuar serbët. Nëse ndonjë person kërkon të shkojë në shtëpinë e tij, për mua ky nuk është provokim. Ushtarët e kanë të qartë se nëse dikush hap zjarr do t'i përgjigjen me zjarr" - ka theksuar komandanti i Njesisë së Task Forcës Shumëkombëshe të Veriut, gjenerali Yakovleff.

për pjesën veriore të saj e sidomos për banorët e pjesës veriore të Mitrovicës. Ata kërkojnë që Qeveria e Kosovës ta marrë kontrollin dhe të garantojë siguri në tërë territorin e saj dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike, fetare, etj.

Ndërkaq, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi ka kërkuar nga strukturat e sigurisë që t'i identifikojnë sa më parë personat që janë duke i bërë këto incidente, duke vlerësuar se identifikimi dhe arrestimi i tyre do të ishte mesazh i mirë për të gjithë keqbërësit, në të kundërtën ata do të trimërohen për të vazhduar me probleme.

Afërdita Mikullovc, nga Policia Ra-

jonale e Kosovës, pohon se për të gjitha rastet që kanë ndodhur ditë më parë në veri, hetimet janë duke vazhduar dhe janë identifikuar disa të dyshimtë, të cilët kryejnë veprime kriminale.


Ndërkaq, komandanti i Njesisë së Task Forcës Shumëkombëshe të Veriut, gjenerali Yakovleff, ka kërcënuar me përdorimin e forcës, ndaj çdo dhune që paraqitet, duke thënë se "ata që bëjnë dhunë ndaj qytetit dhe qytetarëve le të provojnë tek ushtarët e mi dhe le të shohin se si do të ndahen".

Gjenerali Yakovleff ka vlerësuar se incidentet e fundit kanë tensionuar situatën, e cila ditëve të fundit është përmirësuar, por në çdo rast të dhunës që paraqitet, KFOR-i do të ndërhyjë me brutalitet.

"Nuk ka invazion të shqiptarëve në veri dhe tanket shqiptare nuk janë duke i sulmuar serbët. Nëse ndonjë person kërkon të shkojë në shtëpinë e tij, për mua ky nuk është provokim. Ushtarët e kanë të qartë se nëse dikush hap zjarr do t'i përgjigjen me zjarr" - ka theksuar Yakovleff.

Duke konsideruar se grupet që kanë shkaktuar dhunë në veri, janë të njohura shumë mirë për policinë, ai ka kërkuar nga policia dhe organet e gjyqësisë të jenë më efikase dhe t'ua tregojnë keqbërësve vendin.

Ndryshe veriu i Mitrovicës mbetet arenë e incidenteve ndëretnike, si pasojë e mosfunksionimit të rendit dhe ligjit në këtë pjesë të qytetit dhe në tërë veriun e Kosovës së Pavarur. ■



Në vitin 2000, me nismën e një grupi të prindërve të fshatit Restelicë, në koordinim me disa aktivistë shqiptarë, u hap paralelja e parë shqipe në Gorë, përkatësisht në fshatin Restelicë. Në gjeneratën e parë mësimet i filluan 14 nxënës (12 djem dhe 2 vajza). Paralelja në gjuhën shqipe tani ka 80 nxënës të cilët mësojnë me planprogramin e Kosovës. Këtë vit shkollor, mësimin në gjuhën shqipe e kanë filluar 18 nxënës

Osmon BOJAXHIU

Restelica është fshati më i madh në komunën e Sharrit. Ky fshat i ka rreth 1000 shtëpi dhe është i vetmi nga 17 fshatrat e krahinës së Gorës i cili ka festuar më 17 shkurt shpalljen e pavarësisë. Që nga viti 2000, në këtë fshat punon një paralele me nxënës në gjuhën shqipe, krahas atyre në gjuhën boshnjake dhe serbe.

Komuna e Sharrit përbëhet nga 36 fshatra prej të cilave 19 i përkasin krahinës së Opojës dhe janë të banuara 100 për qind me shqiptarë, ndërsa 17 i përkasin krahinës së Gorës ku jetojnë goranët, një pjesë e të cilëve tash së fundi po e quajnë vetën boshnjakë. Gjuha e tyre është përzierje e maqedonishtes, serbishtes dhe shqipes, por nuk ka alfabet dhe nuk shkruhet.

Reportazh nga fshati Restelicë i komunës së Sharrit

Edhe goranët

Historiku i paraleles në gjuhën shqipe

Në vitin 2000, me nismën e një grupi të prindërve të fshatit Restelicë, në koordinim me disa aktivistë shqiptarë, u hap paralelja e parë shqipe në Gorë, përkatësisht në fshatin Restelicë. Në gjeneratën e parë mësimet i filluan 14 nxënës (12 djem dhe 2 vajza).

Në vitin shkollor 2001-2002 përsëri u paraqitën 12 nxënës që t'i ndjekin mësimet në Gjuhën Shqipe, mirëpo drejtori i atëhershëm Jonuz Kale, i cili punonte me planprogram të Serbisë e fshehu këtë kërkesë. Mirëpo prindërit e këtyre nxënësve ishin këmbëngulës që fëmijët të mësonin në gjuhën shqipe, dhe arsimtari punoi me ta në klasë të kombinuar.

Edhe në vitin 2002-03 po i njëjti drejtor shkolle deshi ta pengojë regjistrimin e nxënësve për ta vazhduar mësimin në gjuhën shqipe, mirëpo këtë dredhi e kuptuan fare mirë prindërit, të cilët në marrëveshje me dy mësuesit shqiptarë, Emri Rexhepi dhe Zaim Skeraj, regjistruan 12 nxënës në klasën e parë.

Në të njëjtën mënyrë, drejtori Kale veproi edhe në vitin 2003-04 duke arritur që të fshihte numrin e nxënësve që dëshironin të mësonin në gjuhën shqipe dhe ky numër u reduktua vetëm në dy,

të cilët mësimin e vazhduan në klasë të kombinuar.

Derisa numri i nxënësve po rritej në Restelicë, njëkohësisht po rritej edhe numri i arsimtarëve shqiptarë. Ky numër tani ka arritur në shtatë, të cilët edhe pse në kushte mjaft të vështira, falë sakrificës dhe vullnetit të madh për punë, kanë arritur që t'i mbulojnë nevojat e kësaj paraleleje në gjuhën shqipe, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Paralelja në gjuhën shqipe tani i ka 80 nxënës të cilët mësojnë me planprogramin e Kosovës. Këtë vit shkollor, mësimin në gjuhën shqipe e kanë filluar 18 nxënës.

Emri Rexhepi, njëri ndër arsimtarët e parë të shkollës shqipe në Restelicë, thekson se vullneti i prindërve që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën shqipe është shumë i madh. Sipas tij, ky numër do të ishte edhe më i madh sikur të mos ndërhynte Serbia, e cila po i stimulon mësuesit goranë me paga të majme me qëllim që ta çrregullojnë mbarëvajtjen e mësimin në këtë shkollë. Z. Rexhepi shton se raportet mes të arsimtarëve shqiptarë dhe atyre goranë janë relativisht të mira, edhe pse pjesa dërmuese e mësuesve goranë nuk punojnë me planprogramin e Kosovës, por me planprogramin e Serbisë, nga e cila i marrin 800 euro pagë mujore.

Sipas z. Rexhepi, një problem tjetër në këtë paralele është mungesa e transportit për mësuesit shqiptarë, të cilët mbajnë mësim në këtë paralele dhe kushtet e jashtëzakonshme në të cilat punohet aty.

Ndërsa mësuesi tjetër shqiptar, Hamidyn Bojaxhiu, mendon se paralelja shqipe në këtë shkollë është e diskriminuar.

Nxënësit që i ndjekin mësimet në gjuhën shqipe e ndiejnë vetën më të privilegjuar dhe më të lumtur se bashkëmoshatarët e tyre që mësojnë serbisht.

Adis Bale dhe Rexhep Xhinxho, nxënës të klasës së pestë, pyetjes sonë se si ndjeheni që po mësoni në gjuhën shqipe, u përgjigjen njëzëri: "Ne jemi shqiptarë prandaj mësojmë shqip"! Të njëjtin mendim me ta e ndajnë edhe shumë



Adis Bale dhe Rexhep Xhinxho: "Ne jemi shqiptarë prandaj mësojmë shqip!"

mësojnë shqip

nxënës të tjerë të komunitetit goran, të cilët ndjekin mësimin në gjuhën shqipe në këtë shkollë.

Beogradi i paguan arsimtarët nga 800 euro për të punuar me planprogramin e Serbisë

Në shkollën e Restelicës, 40 arsimtarë të komunitetit goran nuk punojnë më planprogramin e Kosovës, por me planprogramin e Serbisë, nga e cila edhe i marrin pagat prej 800 euro në muaj.

Këto investime që i bën Serbia në Kosovë për paralelet që mësojnë në gjuhën serbe, nga informacionet që kemi, nuk janë fonde të qeverisë së Serbisë, por janë donacione botërore që jepen për serbët e Kosovës me kushte të rënda ekonomike, e që Serbia ua ndan mësuesve dhe punëtorëve të tjerë, duke i stimuluar ata që të punojnë sipas planeve të tyre dhe të krijojnë parregullsi në Kosovë.

Në Shkollën e Restelicës janë dy drejtorë: Hamza Sullta, drejtor i goranëve që punon sipas planit të Serbisë dhe Zevxhan Qufta që punon sipas planit të Kosovës, por që përkrah dhe mbështet planin e Serbisë dhe pikërisht këtu qëndron problemi, sepse në të njëjtin ambient shkollor janë dy drejtorë dhe japin mësim 40 arsimtarë pa kontrata të Kosovës, e që marrin paga nga Serbia dhe që i japin llogari Serbisë dhe 20 arsimtarë me kontrata të Kosovës, 7 prej të cilëve shqiptarë që punojnë me plan të Kosovës.

Të gjithë qarkullimin e të hollave dhe arkivit shkollor e bën familja Demireviç nga Gllloboçica, në krye me kryefamiljarin Bejdin Demireviç, i cili sipas disa informatave merr pagën mujore mbi 5000 euro. Denisi, i biri i Bejdinit është i lajmëruar në Beograd si sekretar i Shkollës së Restelicës, po ashtu edhe bashkëshortja e Denisit është e lajmëruar në Beograd si sekretare e shkollës së Krushës në Gorë.

Hamza Sullta, drejtor i paraleles serbe të gjitha informatat ia dërgon Denis Demireviçit, i cili të gjithë arkivin shkollor e shpie në Beograd. Por mbetet enigmë se kush është përkrahës, apo

kush e lejon të punojë në këtë mënyrë Demireviçin?!

Nga e gjithë kjo, ata që e pësojnë më së shumti janë nxënësit, arsimtarët e të cilëve nuk e shikojnë mësimin por pagat e majme.

Një çështje tjetër mjaft e ndjeshme është se shpenzimet për nxehjen e shkollës dhe shpenzimet e tjera të nevojshme mbulohen nga drejtorja për Arsim e komunës së Sharrit, përkatësisht Ministria e Arsimit të Kosovës, ndërkohë që paratë për inventarin e kësaj shkolle dhe për lëndët djegëse (120 m 3 dru, 60 tonelata qymyr) të cilat i dërgon Beogradi, nuk shfrytëzohen për këtë destinacion, por ato përfundojnë në xhepat e drejtorit të goranëve dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Papërgjegjësia e drejtorit dhe e arsimtarëve që paguhen nga Beogradi nuk përfundon me kaq. Në këtë shkollë nuk ka rend dhe qetësi. Shkolla është shndërruar në një kaos të vërtet. Orët e mësimin nuk mund të mbahen me rregull, nga zhurma që krijojnë nxënësit që mësojnë me planprogramin e Serbisë, të cilët vazhdimisht i hapin dyert e sallave dhe i provokojnë arsimtarët shqiptarë, ndërsa drejtori legal nuk mund të marrë masa ndaj nxënësve që mësojnë me planprograme të Serbisë, sepse "drejtori" i

këtyre të fundit, bashkë me 40 arsimtarë, krahas parave që marrin nga Serbia, marrin edhe detyra për të krijuar kaos e anarki në këtë shkollë. E njëjta gjë ndodh pothuajse në të gjitha shkollat tjera të trevës së Gorës.

Historiku i shkollës

Shkolla fillore e fshatit Restelicë të Gorës së Sharrit, fillimisht ishte paralele e ndarë e Shkollës fillore "5 tetori" të fshatit Krushe të po kësaj komune. Hapja e objektit të ri shkollor është bërë më 22 dhjetor të vitit 1974, me ç'rast shkolla u parësua dhe mori emrin "22 dhjetori".

Atëbotë, shkolla kishte rreth 1200 nxënës, me të cilët punonin 28 arsimtarë që vinin nga vise të ndryshme të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Në këtë kohë, kjo shkollë ishte ndër shkollat më të mira dhe më rezultative në rajon. Aty, si në gjithë shkollat e tjera të Gorës, mësohej edhe gjuha shqipe si lëndë deri në vitet e 90-ta.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, numri i nxënësve pësoi rënie të vazhdueshme si pasojë e shkuarjes në mërgim të familjarëve të këtij fshati, të cilët i merrnin me vete edhe fëmijët e tyre. Vetëm në vitin shkollor 2005-2006, shkollën e braktisën 136 nxënës.

Që nga paslufta e këndej, dëshira e nxënësve për të ikur në Itali, e në vende të tjera evropiane, sa vjen e rritet dhe si pasojë e kësaj, të rrallë janë ata që i vazhdojnë mësimet në shkollën e mesme.

Shkolla tani e mban emrin "Restelica" dhe ka rreth 640 nxënës duke përfshirë edhe ata parashkollorë. ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

UNMIK-u paralajmëron bised

Demir RESHITI

Mikronezia, shtet federal me disa ishuj në Oqeani, është shteti i vetëm që e ka njohur Republikën e Kosovës gjatë muajit dhjetor. Me këtë, numri i përgjithshëm i vendeve që e kanë njohur pavarësinë e vendit tonë ka mbërritur në 53.

Shefat e diplomacive të vendeve anëtare të NATO-s janë takuar në Bruksel për të diskutuar mënyrat për dislokimin e misionit EULEX në Kosovë. Ata kanë vlerësuar se “vendosja e EULEX-it është hap përpara jo vetëm për Kosovën por edhe gjithë Ballkanin Perëndimor”.

Ndërkohë, Misioni i OKB-së në Kosovë ka paralajmëruar një raund të ri bisedimesh teknike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për pjesën e parë të vitit 2009. Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit dhjetor 2008.

(3 dhjetor) NATO do të mbetet në Kosovë në bazë të rezolutës 1244

Bruksel - Prania e fuqishme e NATO-s do të mbetet në Kosovë në bazë të rezolutës 1244. ‘NATO do të vazhdojë të punojë me autoritetet dhe do të bashkëpunojë dhe ndihmojë institucionet ndërkombëtare në Kosovë për zhvillimin e një Kosove stabile, multietnike dhe paqësore’ - theksohet në komunikatën e Aleancës Veriatlantike, në përfundimin e takimit të jashtëm që u mbajt në Bruksel.



(5 dhjetor) Fried: EULEX-i nuk është neutral ndaj statusit

Washington - ‘Janë të pabaza të gjitha spekulimet se shtrirja e EULEX-

it do të jetë hyrje në ndarjen e heshtur të Kosovës’ - ka deklaruar ndihmëssekretari amerikan i Shtetit Daniel Fried. “Kosova do të mbetet një e tërë. Misioni EULEX në të vërtetë nuk është neutral ndaj statusit. Ai në, një masë të madhe, do të forcojë integritetin territorial të Kosovës”, ka thënë Fried.



(6 dhjetor) Mikronezia ka njohur Republikën e Kosovës

Palikir-Mikronezia, shtet federal me disa ishuj në Oqeani, ka njohur Republikën e Kosovës. Numri i përgjithshëm që e kanë njohur pavarësinë e vendit tonë tani ka mbërritur në 53 vende.

(9 dhjetor) Kouchner: Shtrirja e EULEX-it në të mirë të gjithë rajonit

Bruksel - Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian, në takimin e tyre në Bruksel, kanë diskutuar edhe për Kosovën. Ata konsiderojnë se shtrirja e misionit, deri më tani më të madh në historinë e BE-së, është në të mirën e gjithë rajonit. “Vendosja e EULEX-it është hap përpara jo vetëm për Kosovën por edhe gjithë Ballkanin Perëndimor” - ka deklaruar shefi i diplomacisë franceze, Bernard Kouchner, në përfundim të takimit ministror.

(10 dhjetor) McCromack: SHBA mbështet EULEX-in dhe integritetin territorial të Kosovës

Nju Jork - Qeveria amerikane ka përsëritur shtrirjen e EULEX-it në gjithë Kosovën, duke ritheksuar edhe njëherë mbështetjen për integritetin territorial të saj. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës mirëpresin shtrirjen më 9 dhjetor, në gjithë Kosovën, të Misionit të Rendit dhe Ligjit në Kosovë (EULEX)” - thuhej në

komtesën e dhënë nga zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Sean McCromack.



(11 dhjetor) Ischinger: EULEX-i hap përpara

Bruksel - Ish ndërmjetësi i BE-së në bisedimet shitesë për statusin e Kosovës, ambasadori Wolfgang Ischinger, ka deklaruar se misioni evropian për drejtësi dhe polici do të punojë mbi bazën e udhëzimeve dhe të mandatit nga BE-ja.

(12 dhjetor) Zannier: UNMIK-u edhe më tutje do të mbetet në Kosovë

Bruksel - “UNMIK-u edhe më tutje do të mbetet në Kosovë dhe do të vazhdojë të kryejë një rol të rëndësishëm politik, ndërsa prej nesh pritët edhe paraqitja e raporteve tremujore për situatën në terren. Aq më parë, ngase komuniteti ndërkombëtar edhe më shumë është i ndarë rreth statusit të Kosovës dhe se edhe më tej është në fuqi rezoluta 1244” - ka deklaruar shefi i UNMIK-ut Zannier.


Nju Jork - ‘NATO i jep mbështetje të plotë shtrirjes së EULEX-it në tërë territorin e Kosovës dhe kërkon nga të gjithë që të bashkëpunojnë me këtë mision’ - ka thënë zëdhënësi i NATO-s, James Athurai. Ai ka konfirmuar se edhe për një kohë, nuk do të ketë zvogëlim të numrit të pjesëtarëve të KFOR-it në Kosovë.

(13 dhjetor) Petersen: Pavarësisht nga 6 pikat, BE nuk mund të jetë neutrale ndaj statusit të Kosovës

Washington - Ish-shefi i UNMIK-ut Soren Jessen-Petersen, ka deklaruar se misioni i EULEX-it e afron Kosovën me Bashkimin Evropian. Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, Petersen është shprehur se prania e EULEX-it edhe në

Limet të reja Prishtinë-Beograd

veri të Kosovës do të ndihmojë zyrtarët e BE-së të vëzhgojnë sjelljen e Serbisë në përshtatje me marrëveshjen.



George Bush

(18 dhjetor) Bush: KFOR-i do të bashkëpunojë me EULEX-in

Uashington - "KFOR-i bashkëpunon me UNMIK-un dhe tani do ta bëjë të njëjtën gjë me misionin EULEX". Kështu shkruhet në një raport të presidentit amerikan Bush, drejtuar Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit. Bush, një pjesë të veçantë, ia ka kushtuar rolin të KFOR-it në Kosovë. Raporti trajton luftën kundër terrorizmit, si dhe misionin paqeruajtës në Kosovë, ndërsa pasqyron aktivitetin e ushtrisë amerikane në botë.

(19 dhjetor) Kubish: Sllovakia nuk e sheh të nevojshme ta njohë Kosovën

Bratislavë - Shefi i diplomacisë së Sllovakisë, Jan Kubish, ka deklaruar se vendi i tij nuk e sheh të nevojshme ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe se ky veprim nuk ka lidhje me qëndrimin e Rusisë.



Turqia

(22 dhjetor) Turqia premton lobim për Kosovën në KS dhe Konferencën Islamike

Ankara - Nga fillimi i vitit 2009, Turqia do të jetë anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe dëshiron që gjatë kësaj periudhe, edhe Kosova të anëtarësohet në Kombet e Bashkuara. Kështu deklaroi sot kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit turk, Murat Mercan, pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Skender Hysenin.

(23 dhjetor) NATO e shqetësuar me tërheqjen e mundshme të Çekisë

Pragë - 'Mundësia që Çekia të tërheq trupat e veta nga Kosova, për shkak të obstrukcioneve të opozitës, e cila kundërshton të mbështesë misionet ushtarake jashtë vendit, ka shqetësuar NATO-n dhe KFOR-in' - kanë bërë të ditur mediat çeke.

(24 dhjetor) Terral: Raportet Kosovë-Serbi duhet të normalizohen

Beograd - 'Bashkimi Evropian pret normalizimin e marrëdhënieve në mes të vendeve të Ballkanit' - ka deklaruar për mediat serbe ambasadori francez në Beograd, Jean Francois Terral. "Nuk mund të paramendojmë që Serbia dhe Kosova të vazhdojnë përparimin me konflikt të përhershëm. E kemi EULEX-in dhe ky mision është vendosur nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara si (faktor) i rëndësishëm për zvogëlimin e tensioneve dhe normalizimin e raporteve në rajon" - ka thënë Terral.



Dimitry Medvedev

(25 dhjetor) Medvedev: Rusia nuk e ka ndryshuar qëndrimin për Kosovën

Moskë - Presidenti Dmitry Medve-

dev ka deklaruar se Rusia nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj lidhur me Kosovën. "Qëndrimi i Rusisë për çështjen e Kosovës ka mbetur i pandryshuar" - ka thënë Medvedev, pas takimit me kryetarin e Serbisë, Boris Tadiq, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve për energji ndërmjet dy vendeve.

(26 dhjetor) Tadiq: Nëse dështon EULEX-i do të intervenojmë në OKB

Beograd - Në rast se misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë nuk do ta kryejë punën e vet në fushën e sundimit të ligjit, autoritetet në Beograd do të intervenojnë në Kombet e Bashkuara, ka deklaruar presidenti i Serbisë, Boris Tadiq. Duke theksuar se Serbia do të përcjellë punën e EULEX-it, Tadiq ka thënë se Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka obliguar misionin e BE-së për bashkëpunim me organet shtetërore të Serbisë.

(29 dhjetor) UNMIK-u paralajmëron bisedime teknike mes Prishtinës e Beogradit

Prishtinë - Misioni i OKB së në Kosovë paralajmëron një raund të ri bisedimesh teknike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, për pjesën e parë të vitit 2009. Zëdhënësi i UNMIK ut, Rasel Giki, thotë se bisedimet për çështje teknike sipas të gjitha gjasave do të zhvillohen nga ekspertë të të dyja palëve, përfshirë edhe pjesëmarrjen e ndërkombëtarëve. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës shprehet e vendosur të zhvillojë dialog me Serbinë vetëm në cilësinë e shteteve sovraane.

(30 dhjetor) Shvarcenberg: Duhet shumë kohë derisa Kosova të hyjë në BE

Pragë - Shefi i diplomacisë çeke, Karel Shvarcenberg, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian "nuk është çështje e ditës së nesërme". "Duhet të jetë e qartë se derisa Kosova të hyjë në BE do të kalojë edhe shumë kohë" - ka thënë Shvarcenberg, vendi i të cilit prej 1 janarit kryeson presidencën e radhës së Bashkimit Evropian. ■

Histori Islame (26)

Të pakënaqurit me zgjedhjet

Ai i cili filloi grindjen-*fitnen* ishte Ebu Sufjani. Në ditën e parë, ose të dytën, sipas përshkuesve të ngjarjes, Ebu Sufjani ishte njëri prej atyre që nuk e pranoi Ebu Bekrin r.a. për Kalif të muslimanëve. Në kohën kur besimtarët po ia jepnin besën Ebu Bekrit r.a, Ebu Sufjani me një grup tjetër shkuan drejt Alisë r.a.. Zëri tij buçiste: - A pajtoheni o familja e Abdul Menafit që postin e Kalifit ta marrë njeriu që nuk i takon këtij trangu? Derisa po përfundonte fjalinë ia zgjati dorën Aliut r.a. dhe i tha: -Ja tek e ke besën time o Ali! Unë vetëm ty të njoh për Kalif...



**Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI**

Ditën kur Ebu Bekri r.a. doli para masës, në xhaminë e Pejgamberit dhe kërkoi t'i jepej besa, si shenjë pëlqimi dhe miratimi për kandidaturën e tij për Kalif, disa nga historianët e mëvonshëm të bazuar në transmetimet e hadithologëve dhe ndodhive të përshkruara të kësaj dite, përmbajnë në vete kontradikta të vogla. Por kur kthehemi në kohë dhe iu referohemi ngjarjeve të mëvonshme, ka të ngjarë se kemi të bëjmë me një realitet.

Shumë besimtarë sahabët-shokët e Pejgamberit s.a.v.s., i shikojnë si mbinjerëz, thuajse ata kanë jetuar të vëllazëruar dhe me një harmoni të plotë ndërmjet vete, ose si të pagabueshëm me cilësi të melekëve. Jo, ata ishin si të gjithë ne, jetonin me të gjitha cilësitë e njeriut të sotëm. Ishte shumë e natyrshme që Ebu Bekri të kishte kundërkandidat, por ja që askush nuk u paraqit ditën e nesërme.

Ajo se çfarë ka ndodhur në realitet ditën e nesërme është e qartë për shumicën e studiuesve. Për të qenë më të saktë në analizën tonë mund të themi se, Muhammedi s.a.v.s. vdiq ditën e hënë, ndërsa varrimi tij është bërë të mërkurën. Me të drejtë këtu shtrohet pyetja: cila ishte arsyeja e vonimit të varrimit? Sipas të gjithë përshkuesve të ngjarjes, thuhet se ditën e nesërme, pasi Pejgamberi s.a.v.s. ndërroi jetë, besimtarët filluan t'ia falin xhenazen dhe njëkohësisht edhe ia jepnin besën Ebu Bekrit. Kjo procedurë mori tërë këtë kohë, e asgjë prej gjëje tjetër nuk kishte ndodhur. Ishte vargu i madh, ndërsa dhoma në të cilën ishte shtrirë trupi i paspirit i Muhammedit s.a.v.s.

ishte shumë e vogël. Falja e xhenazes nuk ishte me xhemat, por secili njeri ia falte në vete. Secili besimtar kishte dëshirë t'ia falte xhenazen, duke filluar nga familja e tij e ngushtë e deri tek, gratë besimtare, fëmijët dhe robërit besimtarë.

Pozicioni i Alisë (Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij)

Me gjithë pikëllimin e besimtarëve për ndërrimin e jetës së Pejgamberit të tyre, gjatë këtij procesi të përshëndetjes me të, është debatuar për të ardhmen e tyre pa pejgamberin s.a.v.s. Ajo që më së shumti është debatuar ndër besimtarët ishte qëndrimi i Aliut (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*). Të bazuar në të dhënat e Imam Hambelit, Alia tërë kohën deri në varrimin e Muhammedit s.a.v.s., ka qenë në prani të Ebu Bekrit r.a. dhe nuk ka munguar në asnjë namaz me xhemat. Momenti i shtrirjes së dorës nga Alia r.a. nuk është përshkruar, por thotë se kjo ka ndodhur ditën e parë ose të dytën.

Ndërsa Taberiu, i cili na sjell debatin midis Alisë dhe Ebu Bekrit r.a., edhe ky nuk e precizon kohën e dhënies së besës. Shkak i debatit ishte: Fatimja, e bija e Muhammedit s.a.v.s., së bashku me Abasin shkuan tek Ebu Bekri dhe kërkuan prej tij që t'ia ndajnë trashëgiminë që u takonte. Ebu Bekri ju përgjigj: "Kam dëgjuar Muhammedin s.a.v.s. duke thënë: nuk lemë trashëgimi, atë që kemi lënë pas, është sadaka, ndërsa familja e Muhammedit do të ushqehet nga kjo pasuri". Fatimeja r.a. u hidhërua tej mase dhe nuk i foli Ebu Bekrit deri sa vdiq, gjashtë muaj pas pejgamberit s.a.v.s. Për ta stabilizuar situatën, Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*), mbledhi krerët e beni Hashimit dhe kërkoi që Ebu Bekri r.a. t'i shkonte në takim. Omeri e këshilloi të mos shkonte vetëm sepse ftesa theksonte se Omeri është i papëlqyer në takim, ndërsa Ebu Bekri nuk e dëgjoi.

Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*) hapi debatin duke falënderuar Allahun e Lartmadhëruar dhe pastaj shtoi duke i thënë: ky takim nuk ka për qëllim të thyejmë besën tonë, e as të të urrejmë për mirësitë që t'i ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar, por me thënë të vërtetën ne kemi menduar se kemi të drejtën e trashëgimisë dhe ia përkujtoi afërsinë e tij me Muhammedin s.a.v.s. Atij ia përkujtoi edhe dashurinë ndaj Pejgamberit s.a.v.s. derisa Ebu Bekri r.a. qau me zë. Pasi përfundoi Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*), Ebu Bekri r.a. tha: "...Ju e dini fare mirë se pasuria nuk më hyn fare në punë. Ajo na shërben vetëm për ta përdorur në vende sa për të nevojshme, por jua them të vërtetën se e kam dëgjuar Muhammedin s.a.v.s. të ketë thënë ashtu siç i thashë Fatimes r.a., prandaj kërkoi mbrojtjen time nga Allahu i Lartmadhëruar që të mos më ketë lënë kujtesa e ta shkatërroj veten. Çdo kujtim që kam nga Muhammedi s.a.v.s. do ta zbatoj ashtu siç ka thënë ai". Atëherë Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*) pasi kërkoi ndjesë i tha: -Tanimi jonë për besën është në mbremje.



Edhjen e Ebu Bekrit r.a.

Këtë ngjarje e solla këtu sa për të treguar se Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*), ia kishte dhënë besën Ebu Bekrit r.a. më përpara, mbase këtu ishte ridhënia e besës pas këtij keqkuptimi. Njëkohësisht e solla për të treguar se marrëdhëniet e tij me të ishin shumë të mira dhe shumë normale. Këtë e vërteton edhe historiani shiit al Jakubi, por edhe ky dyshon në dhënien e besës. Ai thotë se besa i është dhënë dyzetë ditë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s., ose pas vdekjes së Fatimes. 'Pas dyzetë ditësh ia ka dhënë besën' - mbase ka pasur për qëllim ridhënien e besës.

Të pakënaqurit sipas burimeve shiite dhe sunite

Por kush ishin ata që nuk pajtoheshin me këtë përzgjedhje? Historianët, në esencë, nuk duhet të anojnë nga ndonjë parti ose klan. Ata duhet t'i përshkruajnë ngjarjet ashtu siç kishin ndodhur, ose ashtu siç iu janë përshkruar prej atyre që ishin prezent. Për këtë arsye, sikur sunitët ashtu edhe shiitët, burimet bazë të historisë i kanë të thuajse të njëjta, por interpretuesit dinë që t'i ndryshojnë ato sipas këndvështrimeve të tyre. Ajo që tek muslimanët shkaktoi përçarjen e madhe ishin "thëniet e Muhammedit s.a.v.s." dhe për këtë arsye secili musliman duhet të jetë shumë preciz kur të dëgjojë se kush dhe nga vjen informacioni.

Përshkruarit e haditheve të fjalëve të Muhammedit s.a.v.s. kanë thënë se Muhammedi s.a.v.s. kur erdhi nga Miraxhi, paska informuar Alinë (*Alla-*

hu e fisnikëroftë fytyrën e tij) se ai ishte "zgjedhuri" i Krijuesit të botëve për Kalif pas vdekjes së tij. Hadithe të kësaj natyre kemi shumë, por a janë të sakta? Allahu i Lartmadhëruar e di më së miri. Mendja e njeriut besimtar, nëse vazhdimisht dëgjon interpretime të thënieve të Muhammedit s.a.v.s., edhe sikur ato të mos janë të vërteta, nga frika se mos po bën mëkat, i nënshtrohet atyre dhe në të shumtën e rasteve bën ashtu siç bëjnë të tjerët dhe nuk merret me to, pra mbetet indiferent.

Por nëse të gjitha ato thënie ishin të sakta dhe nuk ndodhi ashtu siç paska thënë Muhammedi s.a.v.s., atëherë kemi të bëjmë me një Krijues i cili nuk e "mban premtimin", nuk është i aftë ose nuk ka fuqinë e duhur për ta "realizuar" atë që ka dëshiruar. Askush nuk mund ta ndryshojë Vullnetin e Allahut të Lartmadhëruar dhe për këtë nuk kemi kurrfarë dyshimi. Sikur t'i kishte thënë Muhammedi s.a.v.s. ato thënie që përshkruhen në librat rreth Miraxhit, a mund të mendohet se besimtarët të ishin aq injorantë që ta pranonin Ebu Bekrin për Kalif!? Po sikur të ishin të vërteta a mund të mendohet se Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*), do t'ia kishte dhënë besën Ebu Bekrit r.a.?

Ai i cili filloi grindjen-*fitnen* ishte Ebu Sufjani. Në ditën e parë, ose të dytën, sipas përshkruarësve të ngjarjes, Ebu Sufjani ishte njëri prej atyre që nuk e pranoi Ebu Bekrin r.a. për Kalif të muslimanëve. Në kohën kur besimtarët po ia jepnin besën Ebu Bekrit r.a., Ebu Sufjani me një grup tjetër shkuan drejt Alisë r.a. Zëri tij buçiste: -A pajtoheni o familja e Abdul Menafit që postin e Kalifit ta marrë njeriu që nuk i takon këtij trangu? Derisa po përfundonte fjalinë, ia zgjati dorën Aliut r.a. dhe i tha: -Ja tek e ke besën time o Ali! Unë vetëm ty të njoh për Kalif. Kështu veproi edhe Halid bin Seid. Ndërsa Alia r.a., kërkoi prej tyre që të jenë të përmbajtur dhe të mos e lakmojnë postin.

Në një version tjetër thuhet se Ebu Sufjani buçiste me zë të lartë: -Unë jam duke parë prush, që nuk do ta shuajë askush përveç gjakut! O familja e Abdul

Menafit! Me çka do t'ju udhëheqë Ebu Bekri? Ku janë meritoret? Ku janë heronjtë sikur Alia e Abasi? O babai i Ebu Hasanit (Ali)! Ma jep dorën që të ta jap besën. Alia e refuzoi një gjë të tillë. Në atë moment citoi një poezi.

Nuk mund të qëndrojnë përballë fundosjes së dëshiruar

Me përjashtim të heronjve të gjallë dhe që duan

Kjo për ata që po zhyten janë shtiza që i kundërvihen

Për këtë askush nuk e trimëron e as nuk e qan

Pastaj Alia r.a. i tha: "Ajo çfarë po kërkon ti është përçarje. Po shoh se akoma je prej atyre që ia do të keqen Islamit. Ne nuk kemi nevojë për këshillat e tua."

Burimet shiite

I bazuar në burimet shiite, si duket në këtë rritje të tensionit, turmat janë shpërndarë. Ndërsa pak më vonë Ebu Bekri dhe Omeri u informuan se një turmë njerëzish shkuan tek shtëpia e Aliut r.a. dhe Fatimes në shenjë mbështetjeje. Ebu Bekri dhe Omeri shkuan tek Alia (*Allahu qoftë i kënaqur me ta*) ndërsa ai doli në derë me shpatë në dorë. Thirri Omerin në dyluftim, nuk vonoi dhe Alisë r.a. iu thye shpata dhe kështu hynë në shtëpi. Fatimja kërkoi prej tyre të dalin menjëherë nga shtëpia se përndryshe do ta zbulonte kokën. Turma u shpërnda.

Personalitetet më të njohura që anuan që Alia r.a. të bëhej Kalif ishin: Abas ibn Abdul Mutalib, Fadël bin Abas, Zubejr bin Avam bin As, Halid bin Sead, Mikdad bin Amër, Selman Faresij, Ebu Dherre el Gafari, Amar bin Jasir, Beraë bin Azib Ebi bin Keab etj.

Kur dëgjoji Ebu Bekri për këta personalitete të shquara se nuk pajtohen me të, shkoi tek Omeri r.e., Ubejdi dhe Murgire bin Shoube dhe kërkoi mendimin e tyre. Ata i thanë se duhej të bisedohej me Abasin. Kështu të gjithë shkuan tek ai atë mbrëmje dhe fjalën e mori Ebu Bekri i cili me një elokuencë dhe mençuri të lartë arsyetoi kandidaturën e tij dhe



besën që ia dhanë shumica e muslimanëve. Ndërsa Omerin r.a., në këtë transmetim, e paraqesin si shumë të vrazhdët: “Me që ra fjala, ne nuk kemi ardhur tek ju se kemi ndonjë nevojë, por nga inati që të tjerët mos të flasin gënjeshtër dhe të intrigojnë në adresën tonë. Prandaj keni kujdes në vendimmarrjen tuaj se mos po përçahemi”.

Ndërsa Abasi ua ktheu: “Është e vërtetë se Muhammedi s.a.v.s. i la të lirë besimtarët që të zgjedhin përfaqësuesin e tyre me drejtësi. Nëse bazoheni tek familja e tij, ju e rrëmbyet atë, po nëse bazoheni tek besimi ne jemi njëri ndër ta, asnjëherë nuk i jemi shmangur urdhëresave. Masa e gjerë e besimtarëve ju zgjodhi juve dhe, ju i përgjigjeni atyre, ndërsa neve nuk na mohohet e drejta të kundërshtojmë, prandaj nuk kishe pse të vije tek ne, nga frika e intrigave që mund të sjellin përçarje në mesin tonë... Pas gjithë kësaj sa u tha më sipër, thuhet se pas dyzet ditëve ose gjashtë muajve Alia ia dha besën Ebu Bekrit!” (Historia e Jakubit 2/126)

Kur kërkuan prej Aliut që t’ia jepte besën Ebu Bekrit r.a. ai tha: -Unë isha më meritor për këtë post. Nuk ua jap besën kur ju duhej të ma jepnit mua atë. E morët këtë post nga ensarët me argumentin se ishit më të afërt me Muhammedin s.a.v.s. Kështu ju po e merrni postin me forcë nga Ehlul Bejt sepse ne jemi më të afërt. Omeri r.a. i tha: -Ti nuk je lënë anash deri në betim. Alia i tha atij: Mjel të mjelurat që të përforcojnë ty, mbështete t’i atë sot, që të ta kthejë ai ty nesër. Pastaj vazhdoi: -Vallahi o Omer, nuk i pranoj fjalët e tua dhe nuk ia jap besën”. Ebu Bekri ia ktheu: -Edhe nëse nuk më jep besën, unë nuk kam pse të të urrej. Ndërsa Ebu Ubejde ibn Xherrah i tha Aliut: -O djali i axhës, ti je i ri, ndërsa këta janë të moshuarit e kombit. Po ashtu ti nuk e ke përvojën dhe

diturinë e tyre. Unë shoh se Ebu Bekri është më i fuqishëm se ti në këtë post, dhe shpresoj se është më meritor se ti, dorëzoja Ebu Bekrit këtë post. Nëse do të kesh jetë, ky post do të të takojë, dhe do ta meritoje me të drejtë, sikur në respekt, në fe, në dituri dhe njohuri nga e kaluara nga familja dhe duke qenë se je dhëndri. Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*) iu përgjigj: O populli muhaxhir! Mos e nxirrni fuqinë e Muhammedit tek arabët nga shtëpia e tij në shtëpitë tuaja. Mos e shtyni qëndrimin e familjes së tij dhe të drejtën tek njerëzit. Ju betohem o muhaxhirë, ne jemi më meritorët se të gjithë të tjerët. I takoj Ehlul Bejt, ndërsa ne jemi më meritorët për këtë post nga ju. Ne jemi ata që lexojmë Librin e Allahut, jemi të ditur për këtë fe të Allahut, të ditur mbi veprën e Muhammedit, ndërsa kjo është fuqi sa për ta ruajtur baraspeshën e cila do të mbronte lëvizjet e këqija që do të përpiqen t’i marrin. Vallahi ne kemi lajthitur, e mos i ndiqni thashethemet se do të humbisni rrugën e Allahut, përqendrohuni nga e vërteta nga larg”. (*Ibid*)

Mbase këtu qëndron edhe Urtësia e Allahut të Lartmadhëruar që nuk i dha pasardhës nga gjinia mashkullore të përzgjedhurit të Tij. Kur’ani është udhërrëfyes, por asnjëherë nuk paraqitet se privilegjon ndokënd para të tjerëve. Që të kuptojnë muslimanët më saktë mesazhin e Allahut të Lartmadhëruar, duhet ta jetësojnë çdo gjë, dhe prej tyre të nxjerrin mësim. Zgjedhja e Kalifit në atë kohë ishte shumë e vështirë, por modestia dhe besimi i sinqertë bëri që shokët e tij të merreshin me Kalifin e ardhshëm derisa ende trupi tij i pashpirt ishte i shtrirë në shtëpinë e tij.

Alia r.a. ishte djali i Muhammedit s.a.v.s. Ndërsa Ebu Sufjani ishte kush-ëri i tij gjithash-

tu. Ndërsa Ebu Bekri ishte akoma më larg nga trangu familjar i Muhammedit s.a.v.s., por gjithsesi ishte kurejshit. Zgjedhja e Ebu Bekrit r.a. për Kalif, evitoi hë për hë ambiciet dhe grindjet e mundshme brenda familjes së Abdulmenafit.

Nga kjo sa thamë më sipër, mësojmë se historianët (shiitë) kanë sjellë argument pakënaqësie të Aliut r.a., por nuk kanë thënë se ishte e drejta e tij për kalif, si rezultat i paracaktimit të Allahut të Lartmadhëruar në Miraxh. Po edhe sikur të kishte ndodhur ky debat pakënaqësie, mendoj se do të ishte shumë normale. Nëse disa historianë kanë sjellë argumentin se Ebu Bekri është mbrojtur përpara ensarëve me idenë e të qenit kurejshit, atëherë më afër këtij posti do të kishte qenë Alia r.a.. Por ajo se ç’ka argumentuar Ebu Bekri r.a. në Sekife me fjalën kurejshit, nuk nënkuptonte se ishte më i afërt me Muhammedin s.a.v.s., por për shkak se kurejshitët ishin më të njohur në Gadishullin Arabik dhe se Qabeja frekuentohet prej tyre me shekuj dhe gëzonin më shumë respekt. Këtë e vërteton vazhdimi i fjalisë kur ai ju tha ensarëve se ata kishin probleme me të kaluarën e tyre dhe sikur të përsëriteshin ato, do të pësonin katastrofë. Por ajo që e bën më të fortë argumentin tonë është se Alia (*Allahu e fisnikëroftë fytyrën e tij*), ishte shumë besimtar, dhe nuhatës i shkëlqyer i intrigave dhe qëllimeve të Ebu Sufjanit, i cili mendonte që posti të kalonte në vija fisnore dhe kështu i gjithë mundi i besimtarëve të shkonte huq me vdekjen e Muhammedit s.a.v.s. Ai e dinte fare mirë se Islami nuk i përkiste arabëve e askujt tjetër në vija nacionaliste, por ishte mesazh për mbarë qenien njerëzore. ■



Në përkujtim të imanit të ndjerë Mulla Jakup Hajrizi

Figurë e ndritur dhe shembull në rajonin e Drenicës

"E kush është më fjalëmirë se ai që thërret për tek Allahu, vepron punë të mira dhe thotë unë jam prej muslimanëve." [Sureja al-Fussilat: 33]

"Dhe thirr (prediko) në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe predikim të mirë." [Sureja al-Nahl: 125]

Driton MORINA

Rajoni i Drenicës në muajin e fundit të vitit 2008 humbi djaloshin dhe aktivistin më të dashur dhe më të dalluar të këtyre trojeve, Jakup Hajrizin. Mulla Jakupi ka ndërruar jetë më 17 dhjetor 2008 në Mynhen të Gjermanisë, ku ishte transferuar urgjentisht nga spitali i Prishtinës.

I lindur më 14.08. 1981 në fshatin Shtrubullojë të Drenasit, Mulla Jakup Hajrizi ishte fëmija i dytë në familje, i cili që i vogël kishte pasion për dije dhe veprimtari. Meqë rridhte nga një familje me traditë të pastër islame nga stërgjyshërit e tij që aq shumë i çmoi, Jakupi pas përfundimit të shkollës fillore në vendlindje mësyu medresenë e mesme Alaudin të Prishtinës, të cilën e përfundoi me sukses të shkëlqyer ndërmjet viteve 1996-2000. Pas përfundimit të medresesë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, të cilës mezi i shpëtoi, Mulla Jakupi kishte dëshirë të flaktë të studionte në botën arabe, ashtu që ta përvetësonte gjuhën e Kur'anit famëlartë dhe ta kuptonte Sheriatin në origjinal. Kështu Allahu i Plotfuqishëm ia mundësoi edhe këtë gjë, andaj në periudhën 2000-2004 Jakupi kaloi në Siri, ku e mësoi gjuhën arabe dhe ndoqi studimet universitare për 3 vite radhazi në lëminë e Sheriatit në Degën e Universitetit Al Az'har në Damask të Sirisë, për të vazhduar vitit e fundit të fakultetit në Kajro të Egjiptit.

Pas përfundimit të studimeve në vitin 2005, Jakupi i ndjerë u kthye në vendlindje ku e priti një vazhdë e gjatë aktivitetesh. Me hapjen e Xhamisë së re në Zabel të Ulët, Jakupi vendoset aty si imam për të dhënë kontributin e tij të jashtëzakonshëm. Ai jo vetëm që ishte një hoxhë dhe ligjërues i shkëlqyer, por

ishite edhe një aktivist i palodhshëm me nxënësit dhe rininë. Ai krahas fakultetit të Sheriatit, që veç e kishte përfunduar me sukses, u regjistrua në Kosovë edhe në Fakultetin e Filologjisë - dega Gjuhë Angleze ku vijonte vitin e dytë të studimeve.

Jakupi ishte njeri mjaft komunikues dhe shumë i afërt me masën. Respektonte dhe ishte i respektuar nga çdokush, gjithnjë me buzëqeshje në fytyrë priste secilin njeri. Madje Allahu i kishte dhënë aftësi dhe butësi të



atillë saqë edhe ata që nuk ia donin të mirën ia kishin lakmi. Ai brenda një kohe të shkurtër arriti që t'i kishte rreth vetes rreth 200-250 nxënës, kryesisht të moshës së re. Ishte aq i matur saqë shpeshherë kolegët e tij, edhe pse me të moshuar se, ai i këshillonte: "Djema kjo është dynja. Mos të na mashtrojë dynjaja nga qëllimet fisnike që kemi për hir të Allahut. Vallahi nëse jemi të sinqertë me Allahun padyshim Ai do të na i hapë rrugët e mirësisë dhe begatisë."

Jakupi i ndjerë ashtu siç ishte i

mirë, i dashur dhe i mrekullueshëm, ashtu edhe shkoi. Gjatë sëmundjes së tij, me të cilën e sprovoi Allahu, ai u tregua shumë burrë dhe musliman i vendosur. Ai pothuajse theu te gjitha rekordet mjekësore me durimin që tregoi, madje shpesh edhe mjekët dhe kirurgët habiteshin me qëndrimin e tij dhe fjalët e ëmbla dhe mbresëlënëse që fliste ndërsa mjekohej. Ashtu siç ishte i dashur dhe i sinqertë, ashtu edhe ndërroi jetë. Mjafton të theksohet se fjalët e tij të fundit ishin sureja el Ihlaskaptina e sinqeritetit dhe dëshmia e shehadetit.

Jakupi vetë shfaqti durim të jashtëzakonshëm dhe gjithherë porosiste për durim. Prandaj, edhe prania e mijëra besimtarëve që morën pjesë në varrimin e tij dëshmonte se sa ishte i dashur. Lotët e mëshirës, dhembshurisë dhe përmallimit shiheshin në sytë e secilit besimtar dhe besimtare në ditën e varrimit. Kjo bëri që pikërisht njëri nga kolegët e tij t'u drejtohet të pranishmëve duke i lutur ata që të kenë durim. "Sa e donit Jakupin dhe u donte ai juve dëshmon edhe prania juaj sot këtu, por në emër të kolegëve dhe shoqërisë së tij u kisha lutur që për hir të Allahut të keni durim dhe ta konsideroni te Allahu shpërblimin për durimin që bëni. Kështu, padyshim, çojmë në vend edhe porositë dhe amanetet e çmuara që na i përcolli ky vëlla i bekuar gjatë gjithë jetës së tij, e cila, edhe pse e shkurtër, që shumë e begatshme. Andaj duke lutur Allahun që hoxhën tonë ta bëjë prej banorëve të Firdeusit të lartë dhe duke lutur të Lartmadhërismin që edhe juve t'iu shpërblejë për praninë tuaj ju përsëritës të gjithëve dhe ju falënderoj për kontributin tuaj gjatë sëmundjes, në veçanti rininë e nderuar që Jakupi e çmoi dhe e deshi shumë, në emër të shoqërisë, kolegëve dhe familjes së Jakupit" - u shpreh ai. ■

Kur nuk zbatohet Ligji për kategoritë e dala nga lufta....

Harrohen familjet e invalidi

Ligji i cili mbron të drejtat e kategorive të dala nga lufta, përfshirë këtu edhe familjet e invalidëve të UÇK-së, nuk është duke u zbatuar për të gjithë pjesëtarët që hyjnë në këto kategori. Janë dhjetëra raste kur invalidët e luftës kanë vdekur dhe familjet e tyre nuk gëzojnë asnjë përkujdesje institucionale.

Kjo ka bërë që shoqata e invalidëve të Luftës së UÇK-së të shprehë pakënaqësi, bashkë me ata të cilët privohen nga kjo e drejtë.

Mexhide DEMOLLI & Arbnora AVDIU

Familja dhjetanëtarëshe e Selim Mërnicsës nga Vushtrria, invalid i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që nga vdekja e tij para tetë vitesh, jeton pa asnjë përkujdesje institucionale. Kjo vjen për faktin se familjet e invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, të cilët kanë humbur jetën pas luftës në rrethana të ndryshme, nuk janë përfshirë në projektligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve e veteranëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Si pasojë e kësaj, këto familje kanë mbetur në mëshirën e fatit.

Plagët e marra në luftë dhe sëmundja e kancerit, sipas Bekim Mërnicsës, ishin shkaktarët e vdekjes së babait të tij. “Asnjë lehtësim apo ndihmë nga askush nuk e kemi pasur në kohën kur babi gjendej në spital, bile më shumë e kanë ndihmuar mjekët privatë, kur është dashtë të sigurojmë terapinë, sesa mjekët në spital, përkundër faktit se ishte një invalid i luftës” - thotë ai. Të ardhurat e vetme me të cilat mbijeton kjo familje janë nga puna e herëpashërshme e Bekimit si punëtor në ndërtime. Mosndarjen e një pensioni nga ana e Qeverisë së Kosovës, ai e cilëson si trup për qeveritarët, të cilët sipas tij e kanë rregulluar jetën e tyre dhe nuk interesohen për askënd tjetër. “Pensionin e prindit do ta cilësoja më shumë si

respekt ndaj veprës së tij, sesa nevojë familjare, përkundër asaj që jetojmë në kushte mjaft të vështira. Problemi është po harrojnë se dikush e ka dhënë jetën për këtë vend, prandaj edhe qeveritarët nuk mendojnë kurrë për ne”. Bekimi thotë se deri më tani kanë tentuar që të sigurojnë pensionin e prindit por ende nuk kanë arritur. “Jam i zhgënjyer se deri më tani na kanë dhënë vetëm fjalë dhe asgjë konkrete”.

Shurdha: Parlamentarët, kur ju konvenon për vete, brenda një jave nxjerrin ligje

Në listat e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, (SHIL) ekzistojnë së paku edhe dhjetë familje të cilat janë në një situatë të tillë.

Fadil Shurdha, që ushtron detyrën e kryetarit të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, thotë se në listat që posedon kjo shoqatë, ekzistojnë rreth dhjetë familje të invalidëve të cilët kanë vdekur pas luftës, dhe të cilat nuk gëzojnë asnjë beneficion.

“Tek ne janë paraqitur vetëm dhjetë familje që kanë kërkuar ndihmë, ndoshta mund të ketë edhe me shumë, por ne vetëm për këto jem në dijeni”. Sipas Shurdhës, arsyeja se pse këto familje nuk kanë asnjë mbështetje institucionale, është për shkak se familjarëve e tyre, të cilët kanë qenë invalidë të luftës, nuk u është përcaktuar shkalla e invaliditetit derisa ata ishin në jetë, kriter ky i cili është i domosdoshëm për të fituar të drejtën e pensionit.

Sipas tij, ka edhe familje të tjera të cilave iu kanë vdekur familjarët që i kanë pasur invalidë të luftës, por të cilat e gëzojnë pensionin me një zbritje prej 30 për qind.

Shoqata e Invalidëve të Luftës kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe nga Parlamenti që Ligji për kategoritë e dala nga lufta të fillojë të zbatohet edhe përkundër mangësive që ka. “Ka shumë mangësi, por së paku le të fillojë të implementohet diçka nga ai ligj”. Shurdha

Familja e Selim Mërnicsës është vetëm njëra nga shumë familje të tilla në Kosovë, të cilat nuk marrin asnjë beneficion pas vdekjes familjarëve, të cilët ishin invalidë të luftës.



Invalidëve të vdekur të UÇK-së

tha se ky projektligj ka të meta edhe sa i përket përkujdesjes së familjeve të dëshmorëve të kombit. "Nëse një dëshmor nuk ka qenë i martuar dhe nuk ka lënë fëmijë, e po ashtu edhe nëse prindërit i kanë vdekur, vëllezërit dhe motrat e tij nuk kanë asnjë të drejtë për ndonjë pension. Por nuk është vetëm tek pensioni, por edhe te respekti që u bëhet atyre vëllezërve dhe motrave".

Sipas tij, nëse do të vazhdojë të neglizhohet edhe më tutje puna sa i përket plotësimit dhe miratimit të këtij Ligji, Shoqata të cilën ai e drejton do të ndërmarrë masa të tjera, përfshirë edhe protestat. "Parlamentarët kur ju konvenon për vete, brenda një jave nxjerrin ligje, siç ishte Ligji për presidentin. Ndërsa kur është fjala për ne, bëhen vite e vite që nuk kanë arritur ta bëjnë një ligj i cili do të përkujdeset për një kategori të rëndë si kjo e invalidëve".

Fazliu: Këto familje nëse posedojnë dokumentet me diagnozat e tyre, kanë të drejtë aplikimi për pension invalidor familjar

Premtimin për realizimin e të drejtave të kësaj kategorie të shoqërisë dhe atë në një kohë të shkurtër e ka dhënë edhe ish kryetari i Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së, Faik Fazliu, i cili tashmë është këshilltar i kryeministrit dhe udhëheqës i zyrës për veteranët e luftës së UÇK-së. "Muajt e parë të këtij viti ky ligj do të dalë në Kuvendin e Kosovës me propozim-ndryshimet që janë bërë në bashkëpunim edhe me shoqatat përkatëse" - tha Fazliu. Sipas tij, disa nga këto familje, edhe pse tani për tani nuk kanë përkujdesje nga ana ligjore, Qeveria e Kosovës i ka ndihmuar me rastin e festës së Kurban Bajramit me një ndihmë simbolike. "Qeveria i ka ndihmuar rreth 180 familje të veteranëve, të cilët nuk jetojnë më, me nga 50 euro, për festën e Bajramit". Kjo shifër prej 180 familjeve, të cilët kanë humbur të afërmit e tyre, Fazliu tha se iu është ofruar nga Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. "Ndoshta mund të ketë edhe familje të tjera të veteranëve që kanë vdekur por

Projektligji i ngelur pezull

Projektligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve e veteranëve të luftës së UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, i miratuar në shkurt të vitit 2006, por i panënshkruar dhe i kthyer mbrapsht nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuar, ka mbetur në ajër.

Sipas këtij projektligji, në Nenin 9, thuhet se pas vdekjes së invalidit të UÇK-së, të drejtën në pensionin invalidor familjar e realizojnë anëtarët e familjes së tij. Mirëpo, ndonëse e caktuar me ligj, një gjë e tillë ende nuk është duke ndodhur në praktikë, të paktën tek disa familje, të cilave, për fatin e tyre të keq, familjarët invalidë që iu kanë vdekur nuk kanë arritur të hyjnë në testin për matjen e shkallës së invaliditetit.

ne i kemi ndihmuar ato familje që kanë qenë në listën që na kanë ofruar Shoqata e tyre" - shprehet ai.

Ndërkaq, sa i përket faktit se shumë familje të invalidëve të luftës, të cilët kanë vdekur dhe familja e tyre nuk gëzon asnjë lloj beneficioni për shkak të mos caktimit të shkallës së invaliditetit derisa ishin në jetë, Fazliu tha se këto familje nëse posedojnë dokumentet me diagnozat e tyre, kanë të drejtë aplikimi për pension invalidor familjar. Ai tha se Qeveria e Kosovës është duke shikuar mundësinë që në një të ardhme të afërt të përkujdeset edhe për çështjen e strehimit të kësaj kategorie, kur dihet se shumë familje të invalidëve apo veteranëve kanë probleme me strehim.

Sidoqoftë, Ligji për vlerat e luftës përmban beneficione, të cilat për familjarët e invalidëve veteranëve, familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve dhe të gjitha kategoritë e dëmtuara nga lufta, për momentin, ekzistojnë vetëm në letër. Jetësimi i ligjit që mbron këto kategori do të ishte

ringjallje e besimit në humanitet dhe përkujdesje njerëzore, e besimit në vlerat mbi të cilat është ndërtuar Kosova dhe do të ishte nderim solid për ata që dhanë shumë. ■



Roli i shoqërisë civile në kontrollin dhe mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë



Nazmi MALIQI

Në vendet me demokraci të brishtë, ekzekutojnë indikacione të partizimit të strukturave shtetërore të sigurisë, me tendencë të centralizimit dhe burokratizimit në procesin e vendimmarrjes. Në kushte të këtilla për t'ju shmangur partizimit të skajshëm nga partitë që janë në pushtet, është e nevojshme të instalohet kontrolli demokratik parlamentar me ndikim të partive opozitare parlamentare dhe sektorit civil. Kontrolli demokratik – parlamentar duhet të precizohet me norma të qarta kushtetuese dhe ligjore dhe për transparencë të qartë në vendimmarrje në strukturat e sigurisë në shtet.

Kontrolli demokratik mbi strukturat e sigurisë mbështetet në disa arsye: ngritja e kulturës së sigurisë, që qytetarët t'i pranojnë më të afërt policinë, ushtrinë, strukturat e shërbimeve sekrete të zbulimit dhe kundërzbulimit. Arsyeja tjetër është krijimi i kushteve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut ndaj qytetarëve, por edhe brenda të punësuarve nga eprorët e tyre. Detyrat e veçanta, apo të sekretit të lartë shtetëror, që mbetet pronësi e një rrethi të ngushtë e hierarkisë së dizajnuar, mund të jete mënyra më e keqe nëse i shmangen kontrollit parlamentar.

Të paktën tre aspekte të fushës së sigurisë përfaqësojnë një sfidë të vërtetë për mbikëqyrjen parlamentare: Ligjet për ruajtjen e sekretit mund të pengojnë përpjekjet për ngritjen e transparencës në fushën e sigurisë. Kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së legjislacionit për lirinë e informacionit etj. Megjithatë rregullativat ligjore për mbrojtje, për punë të brendshme, për policinë, për menaxhimin me krizat, ndjekja e informacioneve, klasifikimi i informacioneve etj, mund edhe mos të jenë pengesë për ngritjen e nivelit të kontrollit demokratik parlamentar dhe joqeveritar të strukturave të sigurisë. Pengesa më e madhe

për ngritjen e këtij niveli të kontrollit demokratik parlamentar, është partizimi tej mase i gjithë asaj, çka do të thotë shtetërore për strukturat e sigurisë. Parashtrohet një dilemë, nëse partia politike që ka shumicën parlamentare, i përvetëson këto segmente si të vetat, nëse deputetët e shumicës parlamentare janë diku bindshëm mbi 50%, dhe të njëjtit ia dorëzojnë rolin vetë mbikëqyrës qeverisë, apo nëse Qeveria e kontrollon parlamentin, atëherë, cili do të ishte sukcesi i kontrollit demokratik, apo shoqërisë civile në kontrollin dhe mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë?

Me këtë zvogëlohet mundësia që, në kuadër të sistemit, shteti të zhvillojë kulturë qytetare dhe politikë demokratike, që qytetarët t'i pranojnë reformat për rregullat demokratike për ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella në një atmosferë të liruar nga trysnitë. Në kuadër të harmonizimit të reformave

me pajtim me standardet e NATO-s dhe

BE-së, nevojitet të bëhet përkufizimi i kompetencave të strukturave të sigurisë (ushtrisë, policisë, drejtorisë për sigurinë dhe kundërzbulimit, agjencisë për zbulim, drejtorisë për menaxhim me krizë) dhe sigurim të kontrollit efikas demokratik parlamentar të sektorit të sigurisë.

Reformat në shtete ballkanike varen nga efikasiteti i sistemit të menaxhimit politik

Në shtetet ballkanike, që akoma llogariten se janë në fazë të tranzicionit, reformat, në masë të madhe, vareshin dhe akoma varen nga efikasiteti i sistemit të menaxhimit politik, që krijon problem në procesin e përshtatjes të sektorit të sigurisë. Ky problem kuptohet se ndërlikohet edhe me vendosjen e sistemit të demokracisë parlamentare edhe të

ekonomisë së tregut etj. Depolitizimi i policisë dhe ushtrisë do të thotë pamundësim formal - juridik dhe faktik i veprimtimit të partive (pa përjashtim) në kuadër të organizimit ushtarak dhe policor. Me fjalë të tjera, kjo paraqet lirim të ushtrisë dhe policisë si institucione nga çfarëdo trysnie dhe ndikimi të organizuar dhe të institucionalizuar ideologjik dhe politik. Mirëpo, shpeshherë madje edhe barazimi i këtillë i depolitizimit, në praktikë përjeton vështirësi të papritura. Efekti politik dhe depolitizimi apo departizimi i ushtrisë dhe policisë dhe strukturave të tjera të sigurisë mund të sigurojë pozicion të tillë, që këto institucione nuk do të varen nga raporti konkret ndërmjet forcave të partive politike në vend. Vetëm në këtë mënyrë strukturat e sigurisë pa frikë dhe pa tronditje më të mëdha, do ta përjetojnë ndërrimin e pushtetit pas zgjedhjeve të rregullta parlamentare; nga ana tjetër, edhe subjektet politike do të jenë të sigurta se fuqia (e strukturave të sigurisë) nuk është faktor në luftën për pushtet. Shoqërisë demokratike i nevojiten struktura të sigurisë që do të sigurojnë kushte të përgjithshme për funksionimin e rendit, pa marrë parasysh bartësit konkretë të pushtetit.

Parlamenti duhet t'i japë publikut mundësinë që të komunikojë me të për çështjet e sigurisë. Komunikimi ose dialogu i dyanshëm është i rëndësishëm sepse: - Ai siguron pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen e përhershme nga ana e qytetarit; - Rrit besimin e publikut në funksionimin e parlamentit; - Ofron një kontroll të mundshëm për keqadministrimin (për shembull, nëpërmjet avokatit të popullit).

Duke sublimuar përvojat nga demokracitë perëndimore në sferën e strukturave të sigurisë (mbrojtje dhe polici), është e evidente se këto vende me demokraci të zhvilluar parlamentare, u kushtojnë vëmendje të posaçme çështjeve për kontroll demokratik për punën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në strukturat e tjera të sigurisë, veçmas nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. ■

(Vazhdon në numrin tjetër.)

Gruaja së cilës serbët ia shuan tërë familjen

Ferdonie Qerkezi jeton e vetmuar, e mbuluar nga kujtimet dhe pesha e rëndë e dhembjes. Meqë nuk i ka mbetur askush, ka vendosur që shtëpinë e saj ta shndërrojë në muze të viktimave të luftës...

Besim MUHADRI

Për Ferdonie Qerkezën nga Gjakova, 27 marsi i vitit 1999 ishte dita më tragjike në jetën e saj, të cilën s'do ta shlyejë kurrë nga kujtesa dhe zemra e saj tashmë e vranë dhe e sakatosur përgjithmonë. Për vetëm pak minuta, sa hap dhe mbyll sytë, asaj ju zhdukën të gjithë të dashurit e saj. Këta akt makabër e bënë policët serbë, disa prej të cilëve ishin edhe "fqinj".

Brenda pak orësh u zhdukën 11 burra

"Ishte 27 marsi i vitit 1999, kur në shtëpinë tonë, përveç anëtarëve të ngushtë të familjes, ishin mbledhur edhe shumë mysafirë, që kishin menduar të strehoheshin te ne. Gjithsej 11 meshkuj, gjashtë gra, tri çika të vogla dhe fëmijë" - rrëfen Ferdonie Qerkezi, ndërsa lotët i rrjedhin nga zemra dhe shpirti. "Ishte ora 11 e ditës së 27 marsit, ditë e diel. Derisa po qëndronim, ashtu të ngjuar, kujton nënë Ferdonia, në shtëpinë tonë erdhën dy policë serbë, që shërbenin në stacionin policor të Gjakovës. Në ato çaste djali im, Artani, kishte në dorë çikën e mikut të tij. Policët hynë dhe na panë se kush dhe sa ishim brenda në shtëpi. Por nuk qëndruan shumë dhe dolën. "Mirë qenkeni dhe mos lëvizni, na thanë dhe shkuan. Nga ora 15,00 ata erdhën përsëri. Kërkuan letërnjoftimet nga të gjithë. Vetëm Edmondi i vogël 14 vjeçar nuk e kishte. Pasi i morën letërnjoftimet ata i dërguan në SUP, por u kthyen përsëri në shtëpinë tonë. "Mos frikoheni se askush s'ju nguc. Ne kemi ardhur që t'iu ruajmë" - na thoshin. Pas pak na thanë që të zbrisnim poshtë në podrum. Në vepruam ashtu si na thanë dhe zbritëm poshtë. Bashkë me ne qëndruan edhe policët. Të them të drejtën mendova se vërtet kishin ardhur për të

na ruajtur dhe fillova ta ndieja veten disi të sigurt. Halimi dhe djemtë e njihnin njërin nga policët. Ishte Dragan Raçiç, që shërbente në Gjakovë. Madje ky Dragani kur erdhi për së dyti kishte sjellë me vete një gjysmë kilogramë kafe dhe një çokollatë për fëmijët që kishim aty bashkë me mysafirët.

"Merrni fëmijët dhe gjithë çka keni dhe shkoni në Shqipëri!" - na tha polici Dragan Raçiç

Dikur policët kërkuan nga Halimi raki, por ai u tha se s'i kishte mbetur, prandaj nuk iu dha. "Atëherë na bëni nga një kafe - thanë ata. Unë dola nga dhoma dhe kur dola lëshova një ofshamë të thellë. Edhe pse m'u duk se kishin ardhur të na ruanin, në shpirt dhe zemër ndieja një të keqe të madhe.

"Pse po fshan? - më tha Dragani. "Mos u tut, ne kemi ardhë me ju rujt. Hajt shërbena ti, ia bëri djalit të tretë, Ardianit, se pse ia ke më

shumë zana t". Ndërsa "bacës Halim" i thanë që të "rehatohej" dhe të ulej në një kolltuk. "Je më i vjetër dhe pusho" - ia bënte Dragani.

Nënë Ferdonia edhe sot kujton me ankth ato momente me policët serbë, që "kishin shkuar t'i ruanin". Sipas pohimeve të saj ata aty kishin qëndruar deri në ora 18, 30. Në këtë kohë, kujton ajo, policët që "kishin shkuar

t'i ruanin", kapelat të cilat deri në atë kohë i kishin mbajtur në kokë, i kthejnë në maska. Para dymve të oborrit qëndronte një picgauer. Pastaj policët hynë brenda dhe kërkuan që të gjithë meshkujt (gjithsej 11) të dilnin në oborr. Të parin e morën Edmondin e kështu me radhë. Unë vetëm shikoja këtë skenë dhe isha mpirë e tëra e nuk dija se ç'po ndodhte. Ne grave na thanë të qëndronim brenda. Pas pak erdhi ai Dragani dhe të tjerët dhe na urdhëruan që të hiqnim të gjitha stolitë që kishim dhe t'ua jepnim atyre. Morën edhe stolitë e dy nuseve të djemve të mi, të cilët para tetë muajve ishin martuar. Kërkuan edhe para dhe na i morën të gjitha që kishim. Pasi morën paratë, por edhe meshkujt, ne grave na thanë që të largoheshim nga shtëpia. "Merrni fëmijët dhe gjithë çka keni dhe shkoni në



Shqipëri!" - na tha polici Dragan Raçiç. Dhe ne dolëm sipas urdhrin të policit dhe kolegëve të tij. Nuk kishim ku të shkonim në atë kohë. Në gratë e mjera s'dinim asgjë për burrat dhe djemtë që na i morën. Atë natë jemi strehuar në banesën e profesorit Qamil Haxhjanuzi, ndërsa të nesërmen u kthyem prapë në shtëpi për të shikuar se çka kishte ndodhur. Kam parë që makina s'ishte. Atë e kishte marrë polici Dragan Raçiç, të cilit së bashku me kunatin tim, Kasimin, që po ashtu atë natë ia morën djalin, Vegimin i kemi shkuar në banesë për ta pyetur se ç' kishte ndodhur me djemtë dhe burrat tanë. Ai banonte në një banesë përballë gjyqit dhe kishte komshi serbin Vuk Mirkoviç, që ishte pronar i "Radio Kozmosit", radiostacion që punonte në Gjakovë gjatë kohës së okupimit dhe të mbylljes së mediave tona. Dragani e pranoi se kishte qenë në shtëpi dhe se e kishte marrë makinën, kinse për ta ruajtur, ndërsa me vete kishte edhe çelësat e podrumit, që deshi të m'i jepte, por "nuk mujti me i gjete". Ai edhe atëherë thoshte se kishte qenë për të na ruajtur. E pyeta për djemtë dhe burrin, por s'më tregoi asgjë. "Do të interesohem dhe do t'iu lajmëroj, më tha, por këtë punë së bëri kurrë. E si ta bënte një kriminel që vetë i kishte marrë dhe vetë i kishte vvarë dhe masakruar. I thashë se nëse dinte se ku janë, t'i merrte ca barëra e t'ia çonte Halimit. "Nuk ka nevojë se kemi mjaft barëra" - ma bëri. Edhe pse e dinte fort mirë ai më pyeti në mënyrë provokuese nëse djemtë e mi kishin shkuar në UÇK.

Dhe Ferdonie Querkezi, që nga jo ditë e deri kur varrosi eshtrat e dy djemve të saj, Artanit dhe Edmondit, nuk mori vesh asgjë për ta. Ashtu sikurse edhe shumë nëna të tjera, ajo me vite pati shpresuar se do të ishin të gjallë diku, por, ëndrra e saj kishte qenë vetëm një ëndërr e asgjë më shumë. U desh të pajtohej me fatin se edhe dy djemtë e tjerë dhe burri nuk ishin më të gjallë.

Ferdonie Querkezi tani jeton e vetmuar, e mbuluar nga kujtimet dhe pesha e rëndë e dhembjes. Meqë nuk i ka mbetur askush, ajo ka vendosur që shtëpinë e saj ta shndërrojë në muze të viktimit të luftës, gjë që ia ka dëshmuar edhe presidentit të Kosovës, me rastin e një vizite të tij në këtë familje. ■

Kur Perëndimi ishte zhytur në errësirën e mesjetës, shkencëtarët arabë ishin

Shkencëtari i parë

Nuk ka dyshim se Isak Njutoni, siç pajtohet pjesa më e madhe e botës akademike, është fizikani më i madh i të gjitha kohëve. Por pa mëdyshje një tjetër fizikan i madh ishte al-Hassan Ibn al-Haytham, i lindur më 965, në Irakun e sotëm



Genta HOXHA

Duke filluar që nga gjysma e dytë e shekullit të tetë, shkencëtarët arabë lëshuan në kalifatit Abbasid të Bagdadit, duke vazhduar vërshimin e saj deri në perëndim të Spanjës dhe deri në pjesët më të largëta të Azisë Qendrore - një periudhë që zgjati dominimin e saj për gjashtëqind vjet.

Duke marrë parasysh tekstet e shkencave të ndryshme - greke, indiane dhe persiane - dhe duke i përkthyer ato në gjuhën arabe - shkollarët e kohës kishin grumbulluar diturinë e botës dhe mbi bazën e tyre kishin vazhduar me zbulimet e tyre të reja. Shpeshherë nëpër to kishte edhe të dhëna praktike relevante islame.

Lulëzimi i shkencës arabe

Astronomia përdorej për orientimin e besimtarëve në lutjet e tyre. Matematika gjente zbatim në ndarjen e pasurisë sipas ligjeve islame të trashëgimisë. Meqë shkencëtarët arabë filluan lulëzimin e saj nën patronazhin islamo-arab, nuk ka dyshim se edhe shkencëtarët më të mëdhenj të asaj periudhe, ishin muslimanë, madje edhe arabë.

Faktori i tyre i përbashkët ishte gjuha arabe, pasi ajo atëherë ishte një gjuhë ndërkombëtare e shkencës. Por vetëm kur punimet shkencore, gjatë shekullit të dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë, filluan të përktheheshin në gjuhën latine, Perëndimi mori dijen e botës arabe.

Nuk ka dyshim se Isak Njutoni, siç pajtohet pjesa më e madhe e botës

akademike, është fizikani më i madh i të gjitha kohëve. Pa mëdyshje, ai është babai i optikës moderne. Kështu është thënë nëpër të gjitha tekstet shkollore. Njutoni ka kryer eksperimente dhe studime të rëndësishme të dritës dhe reflektimit. Ai kishte shpjeguar zërthimin e dritës në ngjyra të ylberit.

Por, edhe pse ka kaq shumë të dhëna dhe fakte bindëse për punën e Njutonit, e vërteta nuk është zbuluar në tërësi.

Fizikani i njohur Jim Khalili, i cili ka punuar për muaj të tërë në një dokumentar për punën e shkencëtarëve arabë, mendon se veprat shkencore të Njutonit janë të vendosura mbi studimet e mëhershme të një gjiganti të shkencës arabe, i cili kishte jetuar shtatë shekuj para Njutonit.

Nuk ka dyshim se një tjetër fizikan i madh kishte lindur më 965, në Irakun e sotëm, e që emri i tij ishte al-Hassan Ibn al-Haytham. Shumica e perëndimorëve nuk kanë dëgjuar kurrë për të.


Fizikani Jim Khalili, i cili pati mundësinë të mësojë më shumë për jetën e al-Haytham, ka theksuar se shkencëtari arab kishte

dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për shkencën gjatë kohës kur bota perëndimore ishte zhytur në errësirën e Mesjetës.

Baba i përdorimit të metodave moderne shkencore

Historia e shkencës ka dëshmuar se ndërmjet epokës greke dhe Renesancës evropiane nuk kishte pasur zhvillime të jashtëzakonshme shkencore.

Por nuk do të thotë se në tërë botën kishte rënë terri i plotë. Duke filluar nga shekulli i nëntë e deri në atë të trembëdhjetin, Koha e Artë kaloi në shenjë të shkencës së zhvilluar nga bota arabe. Zhvillime të



shin në vllugun e zbulimeve shkencore.

ë i vërtetë

mëdha ishin bërë në matematikë, astronomi, mjekësi, fizikë, kimi dhe filozofi.

Në mesin e shumë dijetarëve që i dha bota muslimane planetit tonë, më i madhi i të gjithëve ishte Ibn al-Haytham. Ai konsiderohet baba i përdorimit të metodave moderne shkencore.

Al-Haytham ishte i pari që duke u bazuar në historinë shkencore, bëri gërshetimin e tyre me metoda të reja dhe kryente studime të suksesshme. Kjo është një mënyrë që edhe sot gjen përdorim te studimet e shkencëtarëve të suksesshëm, - thekson fizikani modern arab, Jim Khalili.

Edhe pse vazhdimisht thuhet se metodat moderne shkencore janë vendosur nga Francis Bekoni dhe Rene Dekarti, Khalili tregon se al-Kaytham qëmoti i kishte zbatuar ato mënyra studimi. Në fakt, të arriturat shkencore të al-Haytham-it bëjnë që shumë shkencëtarë ta quajnë atë 'shkencëtarin e parë të vërtetë'.

Studimi i dritës


Ai ishte shkencëtari i parë, i cili fakti dhe argumentoi se si arrijmë t'i shohim ne objektet.

Ai për herë të parë dëshmoi, nëpërmjet eksperimentit, se teoria e emetimit, sipas së cilës sytë e njeriut lëshojnë dritën mbi objektet, ishte gabueshme. Teorinë e emetimit e kishin besuar edhe Platoni, Euklidi dhe Ptolomeu. Al-Haytham dëshmoi për herë të parë se dritat e objekteve është ajo që futet në sytë tanë. Ai, po ashtu, ishte i pari shkencëtar që përdori matematikën për ta dëshmuar këtë proces.

Pra, ai mund të quhet edhe fizikani i parë teorik. Ai ishte njeriu më meritor për zbulimin e ligjeve të refrakcionit. Ai, po ashtu, kishte kryer eksperimentet e para të dritës së objekteve, kishte studiuar hijet, ylberin dhe eklipset. Al-Haytham kishte vënë bazat e studimit të dritës së Diellit dhe difraksionit të saj në atmosferë. Ai mendonte se perimetri i atmosferës ishte rreth 100 kilometra.

Ishte shtirur se ishte një i çmendur për t'i shpëtuar dënimit!

Sikur se edhe shumë shkencëtarë të kohës moderne, edhe al-Haytham duhet të kalonte një kohë të gjatë i izoluar për



Është e pabesueshme se vetëm tani fizikanët kanë filluar të jenë falënderues ndaj shkencëtarit arab që jetoi një mijë vjet më parë.

t'i shkruar traktatet e tij shkencore, duke përfshirë edhe kryeveprën e tij në optikë.

Atij i ishte dhënë një rast i papritur, kur fatkeqësisht ishte burgosur në Egjipt, ndërmjet vitit 1011 dhe 1021, pasi kishte dështuar në përpjekjen e tij për të gjetur një zgjidhje të vërshimeve të shkaktuara nga lumi Nil. Detyra i ishte dhënë nga kalifi i Kajros.

Gjatë kohës sa ishte në Basra, Ibn al-Haytham pretendonte se vërshimet e Nilit gjatë vjeshtës, mund të ndaleshin nga ndërtimi i një sistemi të digave dhe kanaleve, duke krijuar rezervarë të ujit, të cilat do të përdorreshin gjatë muajve të thatë të verës.

Por me të arritur në Kajro, ai e kishte kuptuar se plani i tij ishte i pazbatueshëm shikuar nga perspektiva inxhinierike.

Por më mirë sesa të pranonte gabimin dhe ta rrezikonte jetën nga ndëshkimi

i mundshëm me vrasje prej kalifatit, ai ishte shtirur se ishte një i çmendur për t'i shpëtuar dënimit.

Kjo kishte bërë që ai të dënohej me një arrest shtëpiak prej dhjetë vjetësh dhe ishte liruar vetëm pas vdekjes së kalifit.

Pas kthimit të tij në Bagdad, kishte shkruar mbi njëqind vepra nga fusha e matematikës dhe fizikës.

Një shkencëtar egjiptian nga Aleksandria ka theksuar se ka një numër të madh të studimeve astronomike të al-Haytham. Ai duket se ishte njeriu që kishte ndër-tuar të ashtuquajturin mekanizëm hyjnor, duke shpjeguar orbitat e planetëve, që i kishte paraprirë punës së shkencëtarëve eventualë evropianë, si Koperniku, Galileo, Kepleri dhe Njutoni.

Është e pabesueshme se vetëm tani fizikanët kanë filluar të jenë falënderues ndaj shkencëtarit arab, që jetoi një mijë vjet më parë. ■

Poliklinika "Galaxy" ka shënuar 18 vjetorin e punës

Galaxy – dallëndysja paralele shëndet



Ditëlind RESHITI

Me një darkë solemne të shtruar në ambientit e hotelit "Victory" në Prishtinë, poliklinika "Galaxy" ka shënuar 18 vjetorin e themelimit dhe punës së suksesshme të saj. Të pranishëm në këtë përvjetor krahas shumë miqve, dashamirëve e punonjësve të kësaj poliklinike, ishin edhe përfaqësues të institucioneve, subjekteve politike, veprimtarë nga të gjitha trojet shqiptare por edhe nga Kroacia, Sllovenia, vendet Arabe, Turqia etj.

Të pranishmit i ka përshëndetur me një fjalë rasti pronari i poliklinikës, z. Abdirahim Idrizi. Duke e shprehur mirënjohjen e tij për të gjithë bashkëpunëtorët dhe miqtë që kanë kontribuar gjatë këtyre 18 viteve në mbarëvajtjen e punës në këtë poliklinikë, z. Idrizi ka theksuar se sukseset e arritura janë rezultat i punës këmbëngulëse dhe angazhimit të të gjithë punëtorëve të poliklinikës në ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore si dhe i investimeve të vazhdueshme në mjetet dhe aparaturat më bashkëkohore që ka bërë menaxhmenti i kësaj poliklinike.

Drejtoresha mjekësore e poliklinikës "Galaxy", dr. Fatime Shkodra, ka folur për rezultatet e arritura dhe synimet në të ardhmen.

Një fjalë rasti ka mbajtur edhe simboli i rezistencës kombëtare Adem Demaçi i cili i ka përkujtuar se në kohën kur ka qenë Përfaqësues i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i është lutur z. Abdirahim Idrizit, që në ambulancën në fjalë të marrë përsipër trajtimin mjekësor të luftëtarëve të plagosur. "Ai e ka pranuar lutjen time me gatishmëri e vullnet" - ka theksuar Demaçi, duke shtuar se në kryerjen e kësaj detyre në atë kohë shumë të rrezikshme, kanë marrë pjesë me vullnet e me përkushtim të madh të gjithë anëtarët e ekipit mjekësor e infermierik të 'Galaxy', duke e ruajtur fshehtësinë në mënyrë të përsosur.

Fjalë përshëndeste ka mbajtur edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, zëvendësministria e punëve të jashtme të Kosovës Vlora Çitaku, babai i dëshmorit të kombit dr. Shpëtim Robaj etj. I pranishëm në këtë përvjetor ishte edhe kryetari i kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi.

Me këtë rast është bërë edhe promovimi i monografisë së poliklinikës "Galaxy" për të cilën kanë folur Daut Demaku dhe aktori i mirënjohur Çun Lajçi. Ky i fundit e ka udhëhequr programin në mënyrë dinjitoze.

Në vazhdim, për të pranishmit është paraqitur një videodokumentar për punën e poliklinikës "Galaxy" i përgatitur nga Demir Reshiti dhe Alban Zeneli.

Për të gjithë të pranishmit nikoqiri ka shtruar një darkë të begatshme, ndërsa festa ka vazhduar deri në orët e vona të mbrëmjes nën tingujt e ëmbël të muzikës. ■



hja e parë e sistemit tësor në Kosovë

Poliklinika "Galaxy" u themelua në dhjetor të vitit 1989, në kohën kur një numër i madh i punëtorëve shëndetësorë u përjashtuan nga puna për shkak të kundërshimit të politikës së regjimit të Millosheviqit. Në atë kohë, "Galaxy" ishte shpresa e prehja e domosdoshme për popullin e Kosovës dhe nisma e sistemit paralel shëndetësor, i cili funksionoi me sukses për më shumë se dhjetë vjet.

Poliklinika "Galaxy" shërbeu si bazë e rëndësishme mjekësore, edukative e shkencore, deri në mars të vitit 1999. Mbi 150 studentë të mjekësisë, 70 nxënës të shkollës së mesme të mjekësisë dhe 22 mjekë të rinj, brenda çdo viti akademik e kryenin mësimin e tyre praktik dhe stazhin e obliguar në këtë institucion. Gjatë kësaj kohe, në Poliklinikën "Galaxy" janë përgatitur magjistratura e doktorata shkencore dhe janë mbajtur provime specialistike.

Poliklinika "Galaxy" u shkatërrua plotësisht gjatë luftës, kurse pajisjet dhe aparatura, u vodh e tëra. Me investime plotësisht private, ashtu sikurse edhe kur u themelua, "Galaxy" arriti që të rindërtohej, të pajisej me aparaturë moderne mjekësore dhe të funksionojë si institucioni më i kompletuar privat në Kosovë. Brenda kësaj periudhe, "Galaxy" ofroi shërbime mjekësore të nivelit primar dhe sekondar, ndërsa personeli mjekësor përbëhej nga mjekë dhe profesorë më eminentë të Kosovës në atë kohë. Numri i personelit mjekësor ishte nga 50 – 70, gjatë gjithë kohës.

Në kuadër të Poliklinikës "Galaxy", sot punojnë 47 punëtorë mjekësorë, 60% prej të cilëve janë mjekë të specializimeve të ndryshme.

Poliklinika "Galaxy" është duke u zhvilluar e duke u zgjeruar në veprimtarinë e vet, duke synuar standardet më të larta në shërbimet shëndetësore.



Abdirahim Idrizi është i lindur në vitin 1950 në Tetovë, nga një familje që kurrë nuk është pajtuar me regjimet antipopullore. Qysh në moshën 20 vjeçare, pra në vitin 1970, dënohet në Zagreb bashkë me dy shokë të tij nga Kosova, për veprimtari kundërrivolucionare ndaj Jugosllavisë titiste.

Abdirahimi ishte bërë halë në sy të pushtetit maqedonas. Madje, në vitin 1982 është sulmuar me qëllim likuidimi nga një inspektor shqipfolës në Maqedoni, kështu që është detyruar që kryesisht të jetojë e të punojë në Kosovë dhe Kroaci.

Në vitin 1985 përfundoi fakultetin ekonomik në Zagreb, kurse më 1993 përfundoi studimet për menaxhment biznes.

Në dhjetor të vitit 1989 themelon në Prishtinë poliklinikën "Galaxy", e cila është kapitull i veçantë jo vetëm në jetën dhe në veprimtarinë e tij, por edhe për mbarë shëndetësinë në Kosovë.

Është autor i librave: 'Ndrërimi i mendjes'; 'Libri i jetës'; 'Kënaqësitë e seksit'; dhe 'Monografia e poliklinikës "Galaxy"'. Ka të përgatitur për botim edhe dy libra: 'Menaxhmenti-biznesi familjar' dhe 'Monografi për familjen Idrizi'.



Vështrim kritik

Vepra e mërzisë




Flamur MALOKU

Në shtrirjen e mendimeve të shumta imagjinatave, karshi filozofisë së heshtur subjektive shkruhet teksti poetik “Vija e ftohtë” e poetes së re Shkurtë Kadriu. Vija e ftohtë bëhet vepër e mërzisë subjektive, *figurë personale/ pozicionim personal/sinonim i dhembjes*, e cila del nga bota e filozofisë subjektive përmes një sistemi të menduar figurativ, e që do të ndërtohet e rindërtohet në tërësinë e tekstit nëpërmjet heshtjes shpirtërore në kohë. Heshtja në diskursin metaforik bëhet ftohtësi e njeriut të dëshpëruar e të thyer shpirtërisht. Thyerja shpirtërore bëhet dhembshuri emocionale në kohën e shkrimit. Poetja nëpër rrugët e tanishme jetësore thur ngadalë vijën e ftohtë, pra vijën e heshtjes, vijë në të cilën personalizohet së bashku me dhembjen që ka në jetë. Jeta me thyerjet e saj absurde deri në ekstrem është bërë skenë e mërzisë në të përhershmen jetësore, e cila tani në shumë poezi del në variante të shumta të deklamimit e të argumentimit, variante jetësore nëpër të cilat autorja është sprovuar e lënduar vazhdimisht. Lëndimet janë të mëdha në jetë. S’ka harrim të asaj që ka bërë varrë në shpirt. Pra, shkrimi i figurshëm shënjon idenë se autorja nuk ka më forcë, ndihet e ligështuar dhe kërkon një kapërcim të kësaj gjendje, por me pamundësi vepërimi. Shkurt, mungon forca, për të dalë përtej kësaj ligështie të mërzitshme, sepse jeta është bërë skenë e mërzisë, skenë e monotonisë shpirtërore. *Shenjat e mërzisë/vetmisë/pikëllimit/dëshpërimit*, vendosen në trupin e tekstit në diskursin e mundshëm shpirtëror. Diskursi i mundshëm përcillet me përsëritje të vazhdueshme të dhembjes të të qenit njeri, me shkeljet, me turpërimet e vazhdueshme që i bëhen në jetën reale. Andaj autorja mundohet të ikë nga realja e lodhshme dhe dëshiron të futet në botën e vetvetes, botë kjo që bëhet përherë e pranishme. Edhe në këtë hyrje të vetvetes nuk ka qetësi, sepse reflektohet kudo një zhgënjim, një mospajtim sub-

Jeta me thyerjet e saj absurde deri në ekstrem është bërë skenë e mërzisë në të përhershmen jetësore, e cila tani në shumë poezi del në variante të shumta të deklamimit e të argumentimit, variante jetësore nëpër të cilat autorja është sprovuar e lënduar vazhdimisht.

jektiv. Mospajtimi del në gjuhën e figurës, ashtu lehtësisht me përplot emocione, duke e theksuar shenjën subjektive ndaj asaj që të shkakton dhembje, mërzitja jetësore:

*Diku brenda meje
Ngjyrat plastike
Lozin me errësirën
Nga pëlhurë e mugët
Mbi xhamin e thyer
Nuk shoh rrezet e ftohta
Ku nxin jeta*



Ngjyrat plastike, që kanë hyrë brenda së bashku me errësirën, shënjojnë monotoninë e mërzitshme të jetës subjektive. Jeta është bërë lodhje-vrarje shpirtërore në kohën e tanishme. Xhami i thyer në tërësinë tekstore shënjon konotacionin e thyerjes shpirtërore, pse jo edhe atë të fatit jetësor. Të menduarit subjektiv shkon dhe zgjatet. Rrugët degëzohen emocionalisht, që mbesin përherë në dhembje. Rrugët e dhembjes kanë lënë gjurmë të vrazjes-ligësishtisë. Këto gjurmë autorja i sheh kur i rikthehet pasqyrës. Pasqyra bëhet reflektim i kësaj vrazje brendore-emocionale në kohë:

*Hapi sytë koka seç mu mpi
Në rrugët që zgjateshin
Si gjethet e librit
Degëzuar me dhembjen
E pash të vrazë
Vetën në pasqyrë*

Njeriu në pasqyrë sheh vetveten. Duke e parë vetveten ai futet në botën e mendimit. Duke rikujtuar para pasqyrës, ngadalë, thur kohën e përjetimit-gëzimit-hidhërimit. Duke qëndruar pranë pasqyrës sheh gjurmët e kohës reale. Nganjëherë njeriu nuk ka forcë të përballojë pasqyrën, ndihet i ligështuar dhe ikën nga ajo që ia paraqet pasqyra. Mirëpo, autorja në këtë rast nuk largohet, rri pranë dhembjes, sheh veten të vrazë në kohë, me përplot degëzime të lodhjes-molisjes shpirtërore.

Anonimiteti ekzistencial

Gjithnjë duke i parë figurat tekstore, të cilat konotojnë përhumbjen e subjektit në kohë, koha bëhet e papërbalueshme dhe nganjëherë e shndërrojnë subjektin në një gjendje oniriste shpirtërore. Kjo gjendje subjektive pranohet. Duke u pranuar ajo edhe figurohet, çdoherë nëpërmjet semantikës diskurseve, pra thuret ajo që autorja e quan kafshim ngushëllimesh mes veti, që nis e soset mbi ndjenjën e mundimshme:

*Kafshohen ngushëllimet mes veti
Ditët gjelbëroshe hutohen
Në shikimet syhapuar
Turpshëm shtrydhen ndjenjat*

Këtu turpshëm shtrydhen ndjenjat e njeriut. Ngushëllimet në trupin-shpirtin kafshohen e thellohen në fundosjen e hutuar të jetës. Dhembja shtrihet përmes një horizonti të flakëruar, e cila çdoherë nisat nga individualja duke shkuar të metafizika shpirtërore. Njohjet e dikurshme subjektive humbasin në të trishtën kohë, qyteti bëhet i panjohur X, anonimiteti i ekzistencial. Vetëm fjalët, pse jo edhe të pakuptimita,

bëhen rrugë të vetmisë. Autorja jeton me këtë vetmi të rëndë, në anonimitetin ekzistencial e shpirtëror. Mosnjohja merr gradacion të theksuar, ndërsa fati i brishtë luan lojën e tij të vazhdueshëm, ashtu symbyllas që kthehet në natën e zezë subjektive:

*E qyteti më bëhet x
Rrugët më janë fjalë
Përdredhur me vetminë
Symbylltas luani fati
Në natën e zezë
Ëndrrat mjegullohen*

Ëndrrat mjegullohen bëhen të paqarta, duke vënë në pah ligësinë personale. E gjithë kjo realizohet kryesisht mbi zhgënjimin që figurshëm elaborohet në tekst. Nata e zezë i shkon për shtat trupit të molisur. Ndërsa dhembja subjektive vazhdon në kohë. Lotët, ashtu vjedhurazi, dalin në heshtjen plot vetmi:

*Vjedhurazi lotova
Heshtja u shkallëzua
Murkinez i vetmisë
Kurorëzoi vuajtjen*

Vetmia këtu shkon dhe bëhet figurë, zgjatet e shkallëzohet në heshtjen, për të marrë epitetin e figurshëm Murkinez, duke depërtuar gjithnjë mbi vuajtjen shpirtërore, tanimë e kurorëzuar, që ka prekur po thuajse edhe qiellin. Monotonia shihet, preket, shmangje nuk ka, thuajse jeta e subjektit ka marrë tatëpjetën. Sfida jetësore, me baticat dhe zbaticat e saj, deklamohet gjithnjë mbi fajësinë. Autorja e ka të qartë se jeta është pafajësi në esencë, mirëpo për tjetrin kjo nuk kuptohet, andaj edhe vepron në mënyrë të pakontrolluar, të pavetëdijshme, duke ia mbyllur të gjitha shtigjet e mundshme të pafajshmit deri në ekstremin e mundshëm. Nëpër këto prova të përditshme subjektive, mërzia, dhembja, bëhen të mëdha dhe pa dëshirë kacafyten ndërmjet vete në trupin-shpirtin e njeriut, duke shkaktuar traumë-çmenduri. Duke e parë këtë çmenduri të kohës bashkëkohore, ku i pafajshmi nuk vërehet fare nga turma poshtëruese, nga turma që jeton në kohën e injorancës. Autorja mundohet të këmbëngulë, duke i vënë në pah këto gjëra që e kanë kapluar jetën e njeriut të sotëm. Mbi këto gjëra, lodhja është bërë e mundimshme, mundësia për t'i shmangur është e vogël dhe forcë nuk ka. Andaj, heshtja lidhet e preket deri në atë masë, sa që poetja jetën e quan skenë e mërziisë, ku i pafajshmi bie viktimë i të fajshmit në të përhershmen jetësore. ■

U përrua libri “Çasti bën Çudira”

Nën organizimin e Shoqatës Kulturore “Zëri Ynë”, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës u përrua libri me poezi “Çasti bën Çudira”, i autorit Blerim Halili. Në këtë përrim kritikët dhe studiuesit e letërsisë e vlerësuan lart punën e bërë nga ana e poetit të ri Halili, i cili prezantohet për herë të para publikut me këtë vëllim poetik. Nga vështrimi i tij kritik, Flamur Maloku, studiues dhe kritik letrar, shpalosi përpara të pranishmëve vlerën e librit, duke theksuar se ky libër ka vlera të mëdha poetik- letrare dhe se autori ka një perspektivë të ndritshme para vetes. Libri “Çasti bën Çudira”, shtreson në formën e statusit kategorial diskursin e mundshëm figurativ. Diskursi i mundshëm figurativ, para së gjithash formon kodin llojor-tematik, në statusin personal, çdoherë me pretendim për ta kaluar kohën tash” - theksoi Maloku. Kurse poeti Rrahman Ferizi, potencoi se libri i Blerim Halilit, shpreh një gjuhë të pastër artistike, gjuhë në të cilin gërshetohen tërë ndjenjat e poetit, ndjenja këto që theksojnë kohën e vështirë.



Ndërkaq, në këtë përrim u fol edhe për aktivitetin e Shoqatës Kulturore “Zëri Ynë”, ku u tha se kjo shoqatë është e prirë t'u ndihmojë poetëve dhe shkrimtarëve të rinj, të cilët kanë nevojë për ndihmë. “Shoqata Kulturore ‘Zëri Ynë’ është shoqatë e formuar mbi vlerën e mirëfilltë etike e kulturore. Kjo shoqatë është themeluar për t'i dalë në ndihmë të gjithë atyre që kanë nevojë, në veçanti studentëve me raste të rënda sociale ekonomike” - tha nikoqirja e përrimit Nagihane Bruçi.

Në fund të përrimit, të pranishmit i përshëndeti edhe autori i librit të sapotuar Blerim Halili, i cili e falënderoi në mënyrë të veçantë drejtorin e Shoqatës Kulturore “Zëri Ynë” Muhamet Jusufin-Kajollin dhe Prof. Dr. Milazim Krasniqin për botimin e librit.

Libra të rinj

Nysret Krasniqi: “Teori dhe kritikë letrare”

Këto ditë ka dalë nga shtypi libri më përkthime “Teori dhe kritikë moderne”, i studiuesit dhe kritikut letrar Nysret Krasniqi. Autori në këtë libër kritik ka përmbledhur dhe përkthyer një numër studimesh nga studiues të huaj, ku janë përfshirë autorë si Zheneti, Barti, Todorovi, Eko, Derrida, e shumë autorë të tjerë. Sipas autorit Krasniqi këtu janë përmbledhur studime, hulumtime në fushën e filozofisë, letërsisë, gjuhësisë, të cilat pa mëdyshje mund të cilësohen gjithnjë si ‘klasik moderne’.

Botimi i librit është mundësuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës. Librin me përkthime ‘Teori dhe kritikë moderne’, e botoi Shtëpia Botuese “Rozafa”, Prishtinë dhe ka 450 faqe.



Shqipe Hasani: "Akuareli i dhembjes"



Vëllimi poetik “Akuareli i dhembjes” është libri i tretë i poetes së re, Shqipe Hasani. Kjo autore, më parë ka botuar edhe dy vëllime me poezi “Shiu i vetmisë” dhe “Qielli i varreve”. Në poezitë e librit, autorja ka poetizuar rivalen e ndrydhur e të dënuar të atdheut, me plagët që qarkullojnë edhe sot. Libri konceptohet në katër njësi ciklike: Akuareli i dhembjes, Ndoshta jam Rozafa, Ike në pranverë, Motive me atdheun. Librin “Akuareli i dhembjes” e botoi “Flomend”, Prishtinë, 2008.

Përgatiti: Esat VATOVCI

Poezi

Ditari mat mërzinë

Valmira PEÇI

AUTO-ART

Vura gur-themelin
Në Teatrin tim
Me shfaqje tjetërsimi
Dramë dashurie
Fund tragjik
Komedi
Publik i dashur
S'ka çmim
Ma flakni kohën
Mbushur aktrim
Skenave pa lidhje artistike
Trishtëhem
Midis pasqyrave të mprehta
Vetëvritem
Nëpër tatuazhe jete
Të nderuar spektatorë
Duartrokitje
Pas kaq vite pritje
Portreti im i varur
Apogje arti.

BALADË

Kur kohën matje me hapa
Nuk eca
Vrapova përgjatë si për inat
Ne gropa e puse baltë ngeca
Të kujtohet koha nektar
Nëpër gjethe përmbi bar
Ta mbolla një lule
Ta lashë një buzëqeshje
Një lot
Fytyrën ma pudros me pluhur kohe
Përplasesh syve me erën
Mbyll të gjitha portat
Hap dritaret
Më bën gojëdhënë
Kurorë lulësh
Gaz i botës
Vend vaji
Lërmë të vdes në baladë
Në përqaftimin e fundit.

HOMAZH PËR ËNDRRËN

Shigjeta preku Ëndrrën
E lashtë sa s'mbahet mend
E parë tërë jetën në kaos
Ëndërr kaçurrele
Nga Eteri merr frymën
Kreh flokët si vala
Mbi Gjean zbret sytë si gazi
E dashur zjarrmishtë
E zjarrtë dashurish
Me sy hapur shihet
Ëndrra përdore me ne
Shkëmbinjve
Moçaleve
Në Tartar na shpuri
Me mundime tanatalike
Përpëlitem
Ëndrra fle në Anima

DHOMË VISHNJAKE

Nuk di sa shekuj bëhen
Në dhomën time
Fshihem a fle
Nën qershinë e egër
Lulet e merme
Nëpër shtratin e bardhë
Ëndrrat e kuqe
Verdhohen
Nuk di sa net mijëvjeçare
Kuvendoj me librat
Fotografitë vishnje
Në muze kujtimesh
Ditari mat mërzinë
Mureve të gjelbra
Shkruan lutjet e shpirtit
Ishull vetmie
Ku prehet e plas shpirti
Varur në degë qershie
Merohet
Përballë globit blu
Dhoma e madhe
Oqean
Shkretëtirë
Pa tokë.

Mesazhi i “reperëve” të Kosovës

Drin KRYEZIU

Gjëja e parë që mund të shohim ose të imagjinojmë në një videoklip të reperëve, janë disa sekuenca porno, disa lëvizje të shfrenuara, disa femra gjysmëlakuriqe ose me të brendshme të tejdrukshme, ku qartë mund të shihen edhe organet gjenitale. Edhe pse kjo gjë nuk përkon aspak me realitetin dhe mentalitetin shqiptar në Kosovë, televizionet tona, private dhe publike, nuk hezitojnë aspak t'i emetojnë në programet e tyre, mjafton të jenë televizione të shikueshme.

Videoklipe të tilla ka edhe në mediumet e huaja, e që zakonisht emetohen pas mesnatës, kurse tek ne në pikë të ditës, ose edhe më keq, në mbrëmje, kur e tërë familja janë bashkë.

Nga viti 2000 e kënde, në Kosovë janë shfaqur shumë rryma muzikash, shumë ‘kultura’ perëndimore, shumë ‘civilizime’ e bashkë me to edhe shumë sëmundje, të cilat, më parë, as që i ka dëgjuar e njohur populli i Kosovës.

Një rrymë e re muzikore, repi, ndonëse edhe para luftës ka pëshpëritur aty-këtu, tashmë thujse ka kapluar gjithë televizionet në Kosovë dhe ka ‘infektuar’ pjesën dërmuese të të rinjve.

Por, çfarë? Nuk mjafton me kaq. Si muzika popullore, argëtuese, xhezi, repi, e të tjera, ngërthejnë në vete një pasuri, ama çpasuri solli repi në Kosovë?

Cila është porosia, vlera e teksteve të tyre, gjuha, veshja dhe performimet?

Për këtë dhe hollësi të tjera do të analizojmë një tekst të një kënge të këngëtarit të quajtur me nofkën ‘Rebel’

Për hir të natyrës së revistës, tekstin e kësaj kënge është dashur ta censurojmë. Kërkojmë falje nga lexuesit!

*Oj femen, n'shpinë teme, po don me bo emen
Veç emrin që ta dho, ka me kon emen i nemun
Kejt kan me kesh me ty, o b... q...*

*Pse s'pi kallxon ktyne tjerve, disajnerat qysh ta shtin, huh
Thojshë “Ritmi i Rrugës jon ma t'fort se Rrebeli, athu?
Atehere qa k. e nanes, t'i po m'kopjon mu?*

Ki qef mu kon sikur un, po sta rrok o qun

POZICIONI: në fillim të këtyre vargjeve vërehet një shkallë e lartë krenarie, vetëbesimi dhe mbiçmimi të vlerave të veta. Këtu togfjalëshi “oj femen” ka kuptimin për mashkull që, sipas tekstit, dmth. mashkull i dobët (mashkull-femër). Pastaj bëhet një krahasim me një grup tjetër reperësh “Ritmi i Rrugës”, e që këngët e tyre nuk kanë asnjë të përbashkët me këto që po trajtojmë, e as që duhet krahasuar, siç nuk krahasohet vlerat dhe antivlerat.

GJUHA: Këtu nuk mund të flasim për gjuhë, as për dialekt, as për ndonjë të folme. Këtu ka një zhargon nga më arrogantët, nga më bastardët dhe më të çoroditurit. Ky zhargon nuk flitet as në vendlindjen, rrethin e familjen e tyre. Ky është një zhargon rrugaçësh, i bastarduar, i shtrembëruar dhe i fëlliqur me lloj-lloj fjalësh e shprehjesh ofenduese, sharëse,

për të cilat do të duhej ndoshta një studim i veçantë. Edhe në gjuhë të tjera si p.sh. në anglisht apo gjermanisht, ka kësi sharjesh, ama ato nuk e kanë efektin në raste të caktuara të ligjërimimit. Psh: *gjerm. 'leck mich am arsch'* që në shqip do të thotë ‘ma lëpifsh prapanicën’ nuk e ka kuptimin aq negativ në gjermanisht, e, ndërsa, po t'i thuash dikujt këtë, me siguri se do të konfrontohesh. Pra është kopjuar një variant idiomash të huaja që në shqip reflektojnë shumë negative.

Athu Viktori viktimë? Unë ta q... familinë.

Këtu kemi një dozë të madhe sharjeje, urrejtje dhe prekje në moralin familjar. Në mendësinë shqiptare kulminacioni i ofendimit është, sharja në familje, ngase familja edhe më tej mbetet e shenjtë.

*Ta q... nonen e keqe, qe sagllamë e ki shkinë
A noshta turk a arab, e shtin n'gojë ni qarapë*

RACIZMI: Në këto dy vargje shprehet një notë e lartë racizmi, dukuri që dënohet nga e gjithë bota e civilizuar.

Tulifar bali, katunari – qifti i tij don me knu

HIERARKI: Këtu bëhet një dallim dhe një nënçmim i katundarëve, duke i vënë ata në një pozicion shumë të ulët, madje edhe përqeshës e ironik ndaj atyre qytetarë.

Më poshtë po e japim tekstin e tërë me disa censurime:

Rrebel

*Oj femen, n'shpinë teme, po don me bo emen
Veç emrin që ta dho, ka me kon emen i nemun
Kejt kan me kesh me ty, o b... q...*

*Pse s'pi kallxon ktyne tjerve, disajnerat qysh ta shtin, huh
Thojshë “Ritmi i Rrugës jon ma t'fort se Rrebeli, athu?
Atehere qa k. e nanes, t'i po m'kopjon mu?*

*Ki qef mu kon sikur un, po sta rrok o qun
Se kjo karjera (karriera) e pshurravt, qe e ki pas, murr fund
Athu Viktori viktimë? Unë ta q... familinë.*

*Ta q... nonen e keqe, qe sagllamë (me siguri) e ki shkinë
A noshta turk a arab, e shtin n'gojë ni qarapë*

*Se kerkujt t'k....it s'pi pëlqen, kejt pe din që je bajat
E shaje kryqin sa t'dush, se unë prift nuk jom
Veç bone e shave shqiptarin, unë t'i q... kejt, t'boj llom
Ti je llaskuq, o tuc, ki veç fjalë, - e di*

*E ka bo një kompjuter e tash um shet trimni
Po ti m... n'b... s'ki*

*E n'kofsh t'i ardhmëria e repit, repi paska deshtu
Tulifar bali, katunari – qifti i tij don me knu
Tash hajt shko qitmi disa pordhë, veç ruju po dhihesh
A t'ka baba shkulan a jo, qup pse po zihesh
Do anonime, do cuca, qy qysh i nguca
Me mu mos u shtyni o tuca, ju s'keni as luca*

Morthi

Morthi është shfaqja e disa simptomave që vijnë si rezultat i të ftohtit. Nën efektin e temperaturës së ulët, enët e gjakut nuk e kanë atë "komoditetin" e elasticitetit që e kanë në temperaturat e ngrohta për t'u zgjeruar dhe ngushtuar, kështu që qarkullimi i gjakut dhe regjenerimi i shtresave të lëkurës është, po ashtu i zvogëluar në temperatura të ulëta.

**Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI**

Temperatura, si njëra nga parametrat vitalë të organizmit, ka një lëvizje ditore mesatare prej 36-37 gradë celsius. Çdo ndryshim i temperaturës trupore mbi 38 °C apo ulja nën 36 °C, konsiderohet si ngritje, gjegjësisht ulje, e temperaturës. Temperatura trupore ndryshon gjatë ditës, kështu që minimale është në mëngjes, ndërsa maksimale pasdite dhe në kohën e tretjes së ushqimit. Temperatura trupore rregullohet përmes qendrës që është e vendosur në pjesën e trurit që quhet Hipotalamus. Temperatura shfaqet kur ky "termostat" është i zhvendosur në vlera më të larta se normalja. Lëvizjet normale ditore të temperaturës trupore janë prej 0.5 - 1 °C. Kontrollimi i temperaturës trupore bëhet me ndihmën e termometrit medicinal i cili i ka shkallët prej 35-42 °C. Ajo matet në rrudhat lëkurore siç janë nënsqetulla, në zgavrën e gojës, zgavrën anale etj. Temperatura në zgavrën anale është më e madhe për rreth 0.5 °C prej temperaturës së matur nën sqetull.

Temperatura e pjesëve të ndryshme të trupit tregon ndryshime të caktuara. Kështu që temperatura e sipërfaqeve të lëkurës është më e ulët prej temperaturës së organeve të brendshme që është e kuptueshme për shkak se pjesët sipërfaqësore janë nën ndikimin direkt të ambientit të jashtëm dhe kur është nxehtë enët e gjakut zgjerohen dhe çlirojnë nxehtësi, ndërsa kur është ftohtë ato tkurren dhe e ruajnë këtë nxehtësi. Mu për këtë shkak ekstremitetet tona e diktojnë ndjenjën tonë të ngrohtit dhe të ftohtit. Kështu që

nëse duart dhe këmbët i kemi të ftohta edhe ne do ta kemi të ftohtë. Shumë nga senzoret tanë biologjikë gjenden pikërisht në lëkurë. Senzorë ndaj të ftohtit ka katër herë më shumë se ato për të ngrohtit, ndërsa gratë të ftohtit e ndiejnë më fort se meshkujt.

Studiuesi Njuton Gore, i universitetit të Portsmuthit thekson: "Gratë e kanë të rregulluar në mënyrë të rregullt shtresën e dhjavit nëpër trup dhe mund ta tërheqin gjakun në qendër të organeve. Prapë, ky sistem i ngrohjes i cili është karakteristik për gratë, nënkupton se në duart dhe këmbët e femrave arrin më pak gjak, dhe si pasojë vjen ndjenja e të ftohtit". Studimi, gjithashtu, ka treguar se ndjeshmëria ndaj të ftohtit dallon gjatë ciklit menstrual, sepse në këtë rast temperatura ndryshon përreth një shkallë. Ndjeshmëria ndaj të ftohtit varet nga moshja, marrja me sport, ushqimi, orët e gjumit, pesha trupore por edhe nga puna me të cilën merremi.

Njerëzit me peshë të tepërt kanë ekstremitete më të ftohta, sepse lëkura e tyre me shtresën e dhjavit është e izoluar nga trupi. Njerëzit që janë fizikisht aktivë shpesh kanë temperaturë më të lartë, sepse gjaku u qarkullon më shpesh nëpër trup dhe me këtë edhe arrin më shpejt deri tek ekstremitetet. Pirja e duhanit është edhe një arsye që e ul temperaturën në ekstremitete, sepse pirësit e duhanit kanë qarkullim më të dobët të gjakut. Në ndjenjën e të ftohtit ndikon edhe ajo se ku jemi mesuar të jetojmë. Ndryshimet e përnjëhershme të temperaturës i shkaktojnë trazime organizmit. Gjendja psikologjike, po ashtu, është një

Te fëmijët nën 5 vjet matni temperaturën nën sqetull.

faktor shumë i rëndësishëm i cili përcakton intensitetin e ngrohtësisë. Studimi tregon se edhe njerëzit që jetojnë vetëm a janë të izoluar nga shoqëria e ndiejnë të ftohtin shumë më tepër. Kështu që nëse dëshironi të ngrohni, shoqërojuuni më shumë, bëhuni

aktivë. Dihet që, në këtë periudhë dimri, stresi dhe mendimet negative janë më të përhapura dhe ekspozimi në rrezet e diellit ndikon në largimin e shenjave të lidhura me "depressionin stinor". Ulja e temperaturave të ambientit nxjerr në pah edhe sinjalet e morthit.

Acarimi i duarve apo edhe këmbëve ndryshe quhet edhe morth. Morthi është shfaqja e disa simptomave që vijnë si rezultat i të ftohtit. Nën efektin e temperaturës së ulët, enët e gjakut nuk e kanë atë "komoditetin" e elasticitetit që e kanë në temperaturat e ngrohta për t'u zgjeruar dhe ngushtuar, kështu që qarkullimi i gjakut dhe regjenerimi i shtresave të lëkurës është po ashtu i zvogëluar në temperatura të ulëta.

Ndër shenjat e para që shfaqen në të shumtën e rasteve janë fryrje dhe skuqe e gishtërinjve si të këmbës, ashtu

Temperaturat e ftohta nuk janë momenti i përshtatshëm për të filluar regjime ushtrimore fizike në natyrë, prandaj më shumë këshillohen ushtrime në ambiente të mbyllura.





Morthi i gishtërinjve

dhe të dorës sidomos, në njejt e poshtme të këtyre gjymtyrëve. Kështu në sipërfaqe të lëkurës rreth njejtve të gishtave dalin disa njolla si në ngjyrë të kuqërremtë të ngritura mbi nivelin e lëkurës dhe bëhen të

ë bezdisshme për personin. Pas acarimit të kësaj skuqjeje kjo kalon në një lloj mavisjeje me një edem të lehtë me dhimbje. Kurse në fazat më të avancuara mund të shfaqet edhe me erozione ose e thënë ndryshe me dëmtime të lëkurës apo

me plagë të vogla. Nëse nuk mjekohen këto plagë mund të infektohen dhe të krijojnë probleme serioze.

Fillimisht, në gishta, shfaqen disa skuqje të vogla të cilat më pas bëhen si puçrra të vogla që krijojnë dhimbje dhe kruarje të herëpashershme. Kjo gjithmonë e shoqëruar me skuqje e cila sa vjen e shtohet.

Morthi mund të prekë të gjithë personat të cilët kanë ato problemet që thamë fillimisht me enët e gjakut. Ndërkohë që mund të themi se këto simptoma shfaqen në masë të moshat e reja dhe kryesisht ato shkollorë, si pasojë e ekspozimit në masë ndaj faktorëve rrishtues, gjegjësisht të ftohtit.

Po ashtu, nuk përjashtohen edhe moshat e tjera ku më të predispozuar për të pasur morth janë ata persona që kanë profesione të tilla, që duhet të qëndrojnë për një kohë të gjatë në natyrë.

Për evitimin e morthit rekomandohet mbajtja sa më ngrohtë e këtyre gjymtyrëve, për sh-

Këshillohet përdorimi i dorëzave për duar në ditë të ftohta.

embull duke veshur dorëza, apo duke mbathur mbathje të ngrohta.

Megjithatë, me kalimin dhe ndryshimin e kushteve të temperaturës ajo vetvetiu

vjen duke u larguar. Në këtë rast, duhet theksuar se personat që vuajnë nga këto simptoma të kenë kujdes që të mos përdorin detergjente, apo të mos qëndrojnë në kontakt me lëndët e ndryshme

kimike, pasi që mund të ndikojë në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore. Por nëse shfaqen plagë dhe nuk trajtohen japin infeksione të thella.














Duhet ta ndihmojmë organizmin që të mbajë temperaturën konstante dhe të ketë kaloritë e nevojshme duke u

ngrohur dhe ushqyer. Sugjerohet që të përdoren çaje të ngrohta, supa të ngrohta me bazë perimesh etj.

Mos harroni, përdorni sa më shumë perime dhe fruta të freskëta që përmbajnë vitaminat A dhe C, si portokall, mandarina, kivi, spinaq, kungull dhe karota. ■

Të evitohet qëndrimi në ambiente të ftohta.



Autor: ENDRITI	ZOG ME SQEP TË MADH E ME KËMBË TË SHKURTRA, TRUMÇAK	KRUM I NJË FILMI TË VIZATUAR (sh.pashq.)	LËNDË PLASESE QË PËRDORET PËR TË HED- HUR NË ERE A PËR TË CARË SHKËMBINJ		FILM I REGJISORIT BESIM SAHATCIU "Era dhe ..." SHKODRË, ARTANA	ZANORE	GËZIM I MADH	DJETAR FETAR MYSLIMAN		ZANORE	DRY	PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (turq.)	SHFEND ME I MADH SE ROSA, ME QAFË TË GJATË (sh.shq.)	AXHAMU, I MITURI
AKTORI YNË I MIRËNJOHUR NË FOTO										SKUADRA INTER				
AKTORJA JONË ISMAILI						SHKRIMTARI YNË ASLLANI LUMË NË KOSOVË (shq.)					BUJK SHKRONJA E 7-08			
MOSHË E RE						JO E VJETËR MJET UDHËTIMI					SHTETI (fr.) BISKOTA TË GATUARA ME ARRA			
GURRA					DROJA, FRIKA (bised.) TINGULLIMIT- IM						INTENSITET, TANTAL, URANISUM LLOJ QERREJE KUAJSH			
QË KA TË BËJË ME BIMËT										POROSIA E FUNDIT (pashq.) TONI ALVARES				MJET XHRIMI
I SHQUAR, I DALLUAR										TOKË E PUNUAR (sh.shq.)				BASHKËT- INGËLLORE LAPS
SHTET NË EVROPE										RRALLË (lat.) ALJARMIL, ZILJA			DEM, TER SHKRONJA E 9-08	
	SHTAGAT	NËNË (turq.)	JARAN, SHOK MJET PËR SITJE						SELENI, BORI SHEGA			FAMË, ZULMË CEREMONI FETARE		
MADHËSI A VLERË QË MERRËT PËR KRAHASIM (shq.)						I NJËSUAR, I BASHKUAR, AMERICAN VIDEO EQUIPMENT								LIVORNO, EMPOLJ BASHKË, TOK
KËNGËTARJA JONË BITRI										LLOJ PAPAGALLI DEGË E MJEKËSISË (pashq.)				EMËR YNI MASHKULLI BASHKËT- INGËLLORE
BANORË E NJË QYTETI TONË NË MAGEDONI											EMBLEMA FRIKACAKU, IKATARI			
ZANORË		GADISHULL NË EVROPE (shq.) AKTORJA E VJETËR SUEDEZE MARGRET												
PËRMËR VETOR			ELBASANI EMËR MASHKULLI MYSLIMAN (shq.)		ANTALYA NITON, SULFUR			ALBIN KURTI						
SKAJI, QOSHJA					NORVEGJIA, TAJLANDA, ZANORË			AKTORI I FAMSHËM ROBERT DE	ZANORË KOHË E CAKTUAR PËR PUNË					
TEPELENA		E MBUSH ME BETON, E DAFINË												
	NOTË MUZIKORE RUANDA, TANZANIA				RESA, ZILIA INDIUM									
PAJTUESHM- ËRI (krah.)								SHTET AZIATIK ZANORË						
DERA E VOGËLË THURUR ME THUPRA A ME DEGË								ONTARIO RUGBY UNION						

